

1 E mërkurë, 29 maj 2024

2 [Seancë e hapur]

3 [Të akuzuarit hyjnë në sallën e gjyqit]

4 [I akuzuari Krasniqi paraqitet përmes  
5 videolidhjes]

6 --- Seanca fillon në orën 09.02

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Znj.

8 Sekretare e Seancës, ju lutem paraqisni lëndën.

9 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Mirëmëngjes, të nderuar  
10 Gjykatës. Kjo është çështja KSC-BC-2020-06, Prokurori i  
11 Specializuar kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep  
12 Selimit dhe Jakup Krasniqit.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

14 Sot do të vazhdojmë me dëshminë e Dëshmitarit 02144.

15 Presim gjithashtu që të fillojmë me dëshminë e dëshmitarit të  
16 radhës që është Dëshmitari 01366 sot pasdite.

17 Z. Krasniqi e ndjek procesin nga qendra e paraburgimit.

18 Ndërkohë që z. Thaçi, z. Veseli dhe z. Selimi janë të tre të  
19 pranishëm në sallën e gjyqit sot.

20 A keni diçka për të thënë përpara sesa të fillojmë?

21 Z. ELLIS: [Përkthim] Jo. Thjesht po qëndroj në këmbë për  
22 të filluar me kundërpyetjet.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Pa problem.

24 Vetëm thjesht mendova se mos donit të thonit ndonjë gjë dhe  
25 nuk doja t'ju anash kaloja.

1 Znj. Asistente, ju lutem silleni dëshmitarin në sallë.

2 [Dëshmitari vijon dëshminë]

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mirëmëngjes,  
4 z. Kickert.

5 DËSHMITARI: [Përkthim] Mirëmëngjes, të nderuar Gjykatës.

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Kickert,  
7 do të vazhdojmë me dëshminë tuaj sot. Ju kujtoj që ju lutem  
8 përpiquni që t'i jepni pyetjeve përgjigje me fjali të  
9 shkurtra. Dhe në qoftë se nuk e kuptoni një pyetje të caktuar,  
10 mund t'i thoni avokatëve që nuk e kuptuat pyetjen apo që ta  
11 përsërisin dhe një herë atë çfarë thanë.

12 Po ashtu, ju lutem, kujtoni që të thoni se cila është  
13 baza e njohurive dhe fakteve të lidhura me pyetjet të cilave  
14 do ju përgjigjeni.

15 Ju kujtoj që jeni nën detyrimin që të thoni të vërtetën  
16 siç është deklaruar në betimin solemn prej jush.

17 Po ashtu, duhet të flisni përpara mikrofonit, duhet të  
18 prisni pesë sekonda përpara sesa t'i jepni përgjigje një  
19 pyetjeje dhe ju lutem flisni ngadalë, në mënyrë të tillë që  
20 t'i jepni kohë të mjaftueshme përkthyesve për t'ju ndjekur.

21 Nëse e keni të nevojshme të bëni pushime, na e thoni këtë  
22 gjë dhe ne do të bëjmë organizimet e nevojshme.

23 Tani do të vazhdojmë me z. Ellis, që është Mbrojtja e z.  
24 Krasniqi.

25 Ju lutem mund të vazhdoni, z. Ellis.

Dëshmitari: Jan Kickert (Vijon) (Seancë e hapur)  
Pyetje të palës tjetër nga z. Ellis

Faqe 3

1 DËSHMITARI: JAN KICKERT [Vijon]

2 [Dëshmitari përgjigjet përmes përkthyesit]

3 Pyetje të palës tjetër nga z. Ellis:

4 Z. ELLIS: [Përkthim]

5 PY. Mirëmëngjes, Dëshmitar. Unë quhem Aidan Ellis dhe jam  
6 Avokati i z. Krasniqi. Dua të filloj pyetjet e mia me verën e  
7 1998, me përpjekjet tuaja për të kontaktuar përfaqësuesit e  
8 UÇK-së aso kohe. Është e drejtë, apo jo, Dëshmitar, që kishte  
9 përpjekje në atë kohë që të formohej një platformë e  
10 shqiptarëve të Kosovës e unifikuar për të përfshirë negociata?  
11 PË. Po.

12 Z. ELLIS: [Përkthim] I kërkoj Sekretares që të shohim në  
13 ekran të gjithë së bashku provën materiale P01210, faqja 3 e  
14 këtij dokumenti. Atëherë për më shumë sqarime është dokumenti  
15 me ERN IT-03-66 P59A, data 31 korrik 1998. Faleminderit.

16 PY. Ky është pjesë e një dokumenti që e diskutuat dhe dje.  
17 Është një memo e një kabllogrami që mban datën e 31 korrikut  
18 të vitit 1998. Këtu diskutohet një diskutim ose pasqyrohet një  
19 diskutim lidhur me Veton Surroin dhe palë të tjera, Blerim  
20 Shalën, rreth përbërjes së kësaj platforme të unifikuar?

21 PË. Po.

22 PY. Dhe propozimi ishte që Mehmet Hajrizi e LDK-së të mund të  
23 drejtonte këtë platformë, apo jo?

24 PË. Po.

25 PY. Dhe anëtarët e LDK-së ishin identifikuar që më përpara në

1 një listë për anëtarë të mundshëm të kësaj platforme, apo jo?

2 PË. Po.

3 PY. Por ka pasur një hapësirë po ashtu sa i takon

4 përfaqësuesve të UÇK-së të cilët deri atëherë nuk ishin

5 identifikuar, apo jo?

6 PË. Jo, ato nuk ishin përcaktuar me emër. Nuk kishte

7 përfaqësues të përcaktuar konkretisht për UÇK-në.

8 PY. Ndërmjet gjërave që ne po shohim këtu janë që edhe

9 përfaqësuesi do të ishin pjesë e kësaj platforme, apo jo?

10 PË. Ishte një ndër çështjet që ne ngritëm në atë takim një

11 ditë më herët.

12 PY. Ju keni konfirmuar që në deklaratën tuaj të dëshmitarit

13 në paragrafin 6, që ishte e vështirë që të identifikoheshin

14 përfaqësuesit e UÇK-së që mund të përfshiheshin në këtë

15 proces, apo jo?

16 PË. Po.

17 PY. Një prej vështirësive kryesore në atë kohë ishte që LDK-

18 ja e mohonte UÇK-në, domethënë, mohonte edhe që ekzistonte

19 UÇK-ja. A është e vërtetë kjo?

20 PË. Disa nga anëtarët e LDK-së e mohonin ekzistencën e UÇK-

21 së. Kjo është e vërtetë.

22 PY. Kemi dëgjuar një dëshmitar kohët e fundit që i kujtohej

23 që Rugova është cituar të thoshte në media që UÇK-ja ishte një

24 lojë serbe. A ju kujtohet kjo lloj historie në verën e vitit

25 1998?

1 PË. Jo. Kjo s'më kujtohet.

2 PY. Ka pasur një deklaratë nga LDK-ja nga disa anëtarë të  
3 LDK-së që thonin që UÇK-ja nuk ekzistonte si pjesë ose ishte  
4 pjesë e ushtrisë serbe mbase?

5 PË. JO, që nuk ekzistonte. Nuk më kujtohet kjo, por siç jam  
6 përpjekur që të shpjegoj dhe dje, kishte një lloj loje  
7 politike, në qoftë se mund të thoja kështu dhe kishte një lloj  
8 qasjeje që në popullatën shqiptare që ekzistonte frika e  
9 humbjes së monopolit politik që e kishte LDK-ja dhe prandaj  
10 mund të qarkullonin fjalë të tjera.

11 PY. Në verën e 1998 ka pasur një incident ku Holbrooke është  
12 fotografuar me një individ nga UÇK-ja dhe ai persona doli që  
13 nuk ishte përfaqësues zyrtar, a është e saktë kjo?

14 PË. Po. Kështu e kam kuptuar dhe unë të paktën Holbrooke i ka  
15 thënë grupit të kontaktit që ky ka qenë rasti.

16 PY. Po është akoma -- keni qenë i përfshirë besoj që Jakup  
17 Krasniqi është deklaruar si zëdhënësi i UÇK-së, apo jo?

18 PË. Po, e kam marrë vesh këtë informacion nga mesi i 1998,  
19 domethënë, ndoshta disa javë përpara sesa të takohesha me të.

20 PY. Do t'ju tregoj Deklaratën Politike numër 3.

21 Z. ELLIS: [Përkthim] Që është prova materiale P00270-  
22 ET.15. Kjo është faqja e duhur në anglisht.

23 PY. A është ky një dokument që keni parë në atë kohë,  
24 Dëshmitar?

25 PË. Sikurse mund ta shikoni në të majtë, duket që ky është

1 një deklaratë ose është një dokument i cili është botuar në  
2 gazetë, është një komunikatë e botuar në gazetë. Unë nuk  
3 kuptoj dhe nuk flas shqip. Kështu që nuk besoj që mund ta kem  
4 parë atëherë.

5 PY. Në rregull. Besoj se e përmendët dje që ndonjëherë kishte  
6 ekzagjerim të faktit që sa e fortë ishte UÇK-ja dhe zakonisht,  
7 domethënë, ekzagjerohej sesa e fortë ishte UÇK-ja apo çfarë  
8 kompetencash kishte në mënyrë të tillë që të mund t'i mbushej  
9 mendja komunitetit ndërkombëtar që UÇK-ja ishte e fortë?

10 PË. Sikurse e thashë kishte një lloj loje politike dhe  
11 zakonisht kishte një lloj qëndrimi për ta përfaqësuar UÇK-në  
12 më të madhe sesa ç' ishte dhe më të fuqishme sesa ç' ishte. Dhe  
13 për të na dhënë neve një mesazh që "nuk mund të na injoroni".

14 PY. Në deklaratë fillohet duke thënë që:

15 "Ata që ofrojnë rezistencë të armatosur në Kosovë janë  
16 qytetarë të paorganizuar që e mbrojnë veten dhe pragjet e  
17 tyre".

18 Z. ELLIS: [Përkthim] Të kalojmë tani tek pjesa e fundit e  
19 kësaj deklarate.

20 PY. Përsëri në të njëjtën periudhë kohe, pra, në verën e  
21 vitit 1998 dhe bëhet fjalë për 11 qershor 1998. Kjo është në  
22 pajtim me atë çfarë dini dhe ju, domethënë, që kjo është koha  
23 kur z. Krasniqi është emëruar dhe është deklaruar si zëdhënës?

24 PË. Disa javë më përpara dhe ne po kërkonim një person dhe  
25 morëm vesh që ishte caktuar zëdhënës dhe jo domosdoshmërisht

1 donte të thoshte që ai ishte një bashkëbisedues politik a

2 bashkëbiseduesi politik që ne dëshironim të kontaktonim.

3 PY. Në rregull.

4 PË. Dhe Rohan mori një vendim, që ishte sekretar i

5 përgjithshëm i imi, më vonë u mor vendimi që ne lejoheshim që

6 të flisnim dhe të angazhoheshim apo të komunikonim me UÇK-në.

7 Ky është vendim i cili është marrë më vonë.

8 PY. Dhe kjo shpjegon takimin tuaj më vonë sesa kjo datë me

9 të, apo jo?

10 PË. Po.

11 PY. Përpara caktimit të z. Krasniqi, a ka pasur ndonjë

12 persona tjetër zëdhënës UÇK-ja?

13 PË. Ka qenë Bardhyl Mahmuti, ka qenë një person si zëdhënës

14 që banonte në Gjenevë, por gjithsesi nuk mendoj që ai ka

15 raportuar ndonjëherë përpara grupit të kontaktit ose në

16 kontekstin e grupit të kontaktit.

17 PY. Në këtë dokument jepet emri i vërtetë i z. Krasniqi,

18 domethënë, profesor Jakup Krasniqi, jepet dhe data e tij e

19 lindjes dhe identifikohet gjithashtu edhe fshati i tij, në

20 Drenicë, në Negroc të Drenicës. Kjo ka qenë e pazakontë për

21 UÇK-në në atë kohë, apo jo?

22 PË. Po, e vërtetë është kjo.

23 PY. Mendoj që i thatë z. Misetiç në një përgjigje të një

24 pyetjeje të bërë prej tij, që emri i vërtetë ishte kërcënimi

25 më i madh i sigurisë për veten dhe për familjen tënde. A ju

1 kujtohet që i keni thënë këtë gjë?

2 PË. Po. Në fakt mua më bëri shumë përshtypje fakti që ai e  
3 dha të plotë emrin e tij.

4 PY. Sepse duke bërë këtë gjë, ai do ta vendoste veten e vet  
5 në rrezik ashtu edhe familjen e tij, apo jo?

6 PË. Absolutisht po. Dhe jo vetëm kaq, por edhe fakti që  
7 shfaqeshin fotografi të tij ose lejonte bërjen e fotografive  
8 të tij dhe kjo ishte diçka tjetër.

9 PY. Tani do t'ju flasim për takimin me z. Krasniqi më datë 30  
10 korrik në vitin 1998 në Kleçkë. Ju keni qenë së bashkë me  
11 David Slim, që ka qenë homologu juaj në ambasadën britanike në  
12 këtë takim, apo jo?

13 PË. Po.

14 PY. Dhe nga ana e UÇK-së ishte Ramë Buja dhe Fatmir Limaj që  
15 ishin të pranishëm, apo jo?

16 PË. Po.

17 PY. A e dini ju që Ramë Buja ka qenë ish-zyrtar i LDK-së?

18 PË. Po, edhe Jakup Krasniqi ka qenë.

19 PY. Po, do kalojmë tek pjesa e Jakup Krasniqit. Në takim  
20 Jakup Krasniqi u prezantua me emër, apo jo?

21 PË. Besoj se po. Kështu i kam marrë dhe shënimet apo kështu e  
22 kam pasqyruar dhe në raportin tim. Nuk e dija emrin e Ramë  
23 Bujës sepse të paktën nuk është se e dija unë publikisht deri  
24 tani, deri në atë kohë, domethënë edhe Fatmir Limajn nuk e  
25 dija sesi e kishte emrin. Sepse përdorte emrin Çeliku.



1 PY. Po, Fatmir Limaj përdorte nofkën Çeliku. Por z. Krasniqi  
2 nuk kishte një nofkë, apo jo?

3 PË. Jo, nuk kishte nofkë dhe ne thjesht po mundoheshim të  
4 spekulonim dhe të gjenim se çfarë numri mund të ishte ai.

5 PY. Çfarë baze kishit ju për këtë spekulim? Do vij momenti  
6 kur të diskutojmë sepse ka disa dokumente ku ju i referoheni  
7 atij si Numri 11 apo Numri 12, në mos gabohem, nga i keni  
8 marrë këto referenca?

9 PË. Besoj se kështu e kam vendosur në raportin tim, po në  
10 qoftë se i kam përdorur këto numra, i kam marrë diku nga  
11 gazetatat, gazetarët e Kosovës.

12 PY. Organizimin e takimit e ka bërë një gazetar kosovar,  
13 Baton Haxhiu, apo jo?

14 PË. Po.

15 PY. Dhe ju e dini që ai fliste disi anglisht, apo jo?

16 PË. Po.

17 PY. Dhe ju nuk e kishit përkthyesin tuaj për takimin kështu  
18 që u mbështetët në atë çfarë ju ka përkthyer z. Haxhiu ju?

19 PË. Po. Besoj që nuk e kishim me vete përkthyesin atë që e  
20 patë në fragmentin e takimit të marsit me Shtabin e

21 Përgjithshëm. Përkthyesi ynë, z. Balaj, zakonisht, domethënë,  
22 përkthente për neve po gjithashtu edhe për britanikët.

23 PY. Por thoni që pavarësisht arsyes sepse nuk ishte  
24 përkthyesja aty e pranishme, ajo nuk ishte e disponueshme dhe  
25 nuk është se ishte e pranishme për të përkthyer gjatë takimit?

1 Po zotëria që bëri përkthimin gjatë takimit ishte

2 gazetar. Nuk ishte profesionist përkthyes, apo jo?

3 PË. Mund ta thuash këtë gjë.

4 PY. Por ndoshta po tregohesh pak më i mirë seç duhet me të?

5 PË. Jo. Jo. Unë po them që është gazetar.

6 PY. E kuptoj. Por ju e keni konfirmuar që në korrik të 1998

7 nuk e keni folur shqipen, apo jo?

8 PË. Jo, jo as atëherë dhe as sot.

9 PY. Por mund të ketë pasur dhe gabime në përkthim, apo jo,

10 për shkak të faktit që gazetari nuk ishte përkthyes

11 profesionist?

12 PË. Mendoj që është prezumim i drejtë.

13 PY. Dhe takimi nuk është se është regjistruar me audio, apo

14 jo?

15 PË. Jo.

16 PY. Po dhe përmbajtja e takimit, ju jeni mbështetur vetëm

17 thjesht në shënimet tuaja sepse kanë kaluar tanimë 26 vjet nga

18 ai takim dhe është e vështirë të konfirmohet se çdo fjalë që

19 është thënë aty është e raportuar prej jush apo mund të mbahet

20 mend prej jush edhe sot e kësaj dite?

21 PË. Po. Mund të thuhet.

22 PY. Në përgjithësi diskutimi është mbajtur në nivel politik

23 në atë takim, apo jo?

24 PË. Ai ka qenë qëllimi kryesor i takimit.

25 PY. Është pjesë e përpjekjeve që ne kemi përmendur dhe do të

1 përpigemi dhe ishte si pjesë e përpjekjeve të platformës së  
2 unifikuar në verën e vitit 1998.

3 Z. ELLIS: [Përkthim] Ju kërkoj ndjesë për nxitimin.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Ellis, ju  
5 lutem bëni një pauzë ndërmjet përgjigjes dhe pyetjes në mënyrë  
6 të tillë që të kapeni nga të gjitha palët në sallë.

7 Z. ELLIS: [Përkthim] Mund të vazhdoj tani?

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] A janë  
9 përkthyesit gati për të vazhduar?

10 Mund të vazhdoni, z. Ellis.

11 Z. ELLIS: [Përkthim]

12 PY. Atëherë pyetja e fundit që bëra unë ishte, që ky takim më  
13 31 korrik ishte pjesë e përpjekjeve për të formuar një  
14 platformë të unifikuar shqiptare, apo jo?

15 PË. Mendoj që ka qenë më 30 korrik.

16 PY. Po, ke të drejtë ka qenë më 30 korrik.

17 PË. Dhe përgjigja për këtë pyetje është po.

18 PY. Përfaqësuesit e UÇK-së me të cilët ju folët ishin të  
19 gatshëm që të merrnin pjesë në këtë platformë të unifikuar,  
20 apo jo, Dëshmitar?

21 PË. Po. Ne e morëm konfirmimin që ata ishin të gatshëm, por  
22 gjithashtu nuk është kishin vendosur, nuk e kishin vendosur  
23 100 për qind ende, ju duheshin ende që të bënin disa  
24 konsultime.

25 PY. Dhe për këtë arsye në memon tuaj u arrit në përfundimin

Dëshmitari: Jan Kickert (Vijon) (Seancë e hapur)  
Pyetje të palës tjetër nga z. Ellis

Faqe 12

1 që:

2 "... përshtypja e përgjithshme mbetej që UÇK-ja nuk  
3 kishte përfunduar akoma një mendim të brendshëm për sa i takon  
4 procesit të formimit".

5 Edhe këtë në fakt sapo e thatë edhe pak më herët,

6 Dëshmitar?

7 PË. Po.

8 PY. Domethënë, në qoftë se do ta themi me terma ose me fjalë  
9 të përgjithshme ju po dëshmoni që UÇK-së ju desh goxha kohë që  
10 të zgjidhte këto lloj çështjesh?

11 PË. Po. Ne patëm ndjesinë që ky ishte një proces konsensual i  
12 vendimmarrjes që përfshinte një grup më të madh për t'u  
13 konsultuar dhe për të koordinuar.

14 PY. Ju nuk po thoni që z. Krasniqi, zëdhënësi i UÇK-së mund  
15 të merrte vendime atje në atë takim, apo jo?

16 PË. Jo, jo. Nuk besoj se ai mund ta bënte një gjë të tillë.

17 Z. ELLIS: [Përkthim] I kërkoj Sekretares tani të paraqesë  
18 një tjetër dokument në ekran. Dokumenti është U008-1323-U008-  
19 1333. Më konkretisht paraqisni në ekran, ju lutem, faqen 1333.  
20 Ju kërkoj ndjesë mbase është faqja tjetër, domethënë, një faqe  
21 më pas.

22 PY. Besoj se këtë ju e keni përshkruar si një agjendë që ju e  
23 keni përgatitur përpara takimit, a është e vërtetë, apo jo,  
24 Dëshmitar?

25 PË. Këto janë mesazhe të cilat i kam hartuar së bashku me

Dëshmitari: Jan Kickert (Vijon) (Seancë e hapur)  
Pyetje të palës tjetër nga z. Ellis

Faqe 13

1 David Slinn të Ambasadës Britanike.

2 PY. Në fund fare të kësaj faqeje ka një shënim me shkrim ku  
3 thuhet:

4 "Robërit e luftës, Konventa e Gjenevës - jo civilët dhe  
5 përmendet gjithashtu edhe KNKK-ja".

6 Kjo është një prej çështjeve që keni diskutuar ju dhe z.  
7 Slinn në takim, apo jo, z. Dëshmitar  
8 PË. Po.

9 PY. Juve ju bë një pyetje lidhur me këtë pikë të agjendës,  
10 gjithashtu edhe ju bënë disa citime të deklaratat tuaja në  
11 çështjen Limaj në TPNJ. Atëherë citimi i parë ka të bëjë me  
12 një deklaratë Dëshmitar, që keni dhënë juve.

13 Z. ELLIS: [Përkthim] Në faqen 1327 të të njëjtit  
14 dokument.

15 PY. Në 2004 keni thënë si më poshtë.

16 "Kjo kishte të bënte me faktin që kishte pretendime në  
17 shtypin serb që UÇK-ja kishte marrë robër. Nuk më kujtohet që  
18 kjo të ketë qenë një çështje që të jetë diskutuar në takim dhe  
19 se çfarë përgjigje mori pyetja në qoftë se ka pasur një pyetje  
20 lidhur me të".

21 A ju kujtohet ta keni thënë këtë në deklaratën e vitit  
22 2004, dëshmitar

23 PË. Po.

24 PY. Më pas juve ju bë një pyetje lidhur me dëshminë e dhënë  
25 me gojë në çështjen Limaj përpara Trupit Gjykues.

Dëshmitari: Jan Kickert (Vijon) (Seancë e hapur)  
Pyetje të palës tjetër nga z. Ellis

Faqe 14

1 Z. ELLIS: [Përkthim] Është prova materiale P1209, faqja e  
2 transkriptit 682, duke filluar nga rreshti 25 dhe që vazhdon  
3 në të gjithë faqen.

4 PY. Pyetja që ju bë është kjo:

5 "A ju kujtohet nëse në të vërtetë çështja ka qenë  
6 diskutuar në takim?"

7 Dhe përgjigja që keni dhënë është:

8 "Jo, nuk më kujtohet fare".

9 A ju kujtohet ky shkëmbim, a ju kujtohet kjo pyetje dhe  
10 kjo përgjigje përpara TPNJ-së, Dëshmitar?

11 PË. Tani që e lexuat, po.

12 PY. Përderisa ju nuk ju kujtohen në qoftë se kjo pikë ose ky  
13 aspekt ishte diskutuar apo ishte trajtuar në takim në 2004,  
14 besoj, që nuk do ishte realiste që t'ju pyesim tani, 20 e ca  
15 vite më pas, në qoftë se ju kujtohet tani ndërkohë që s'ju  
16 është kujtuar në 2004, apo jo, Dëshmitar?

17 PË. Po, është e drejtë kjo.

18 Z. ELLIS: [Përkthim] A mund të kalojmë tek dokumenti  
19 U008-1332, që mendoj që është një faqe më përpara.

20 PY. Ju kërkojmë ndjesë për cilësinë e dokumentit të  
21 fotokopjuar, po këtë dokument kemi. A e shquani shkrimin tuaj  
22 të dorës, e keni shkruar ju këtë dokument me shkrim dore,  
23 Dëshmitar?

24 PË. Po.

25 PY. A mendoni që një pjesë e këtyre shënimeve janë mbajtur

1 gjatë takimit fizik vetë më 30 korrik 1998

2 PË. Po. Absolutisht, po.

3 PY. Mendoj që Prokuroria në deklaratën që keni dhënë për të  
4 ju ka bërë një pyetje lidhur me shënimin në fillim fare të  
5 faqes. A është e drejtë të themi që këtu në fillim fare të  
6 faqes thuhet:

7 "Asnjëherë mos pranoni listën e Melazim Krasniqit për të  
8 diskutuar".

9 A e shikoni këtë, apo jo, Dëshmitar?

10 PË. Po. UÇK-ja përmes bashkëbiseduesve tanë po e mohonin  
11 faktin që Melazim Krasniqi do ishte drejtues i kësaj platforme  
12 në Kosovë sepse ai konsiderohej si shumë i afërt me Rugovën.

13 PY. Atëherë do të bëj ca pyetje plotësuese në lidhje me këtë  
14 aspekt, së pari në shënimet tuaja nuk identifikohet  
15 ekzaktësisht se kush po fliste për këtë pikë, apo jo?

16 PË. Po. Po me sa kujtohet mua, për të folur ka folur Jakup  
17 Krasniqi.

18 PY. Ai ka qenë zëdhënësi?

19 PË. Po. Ai ka qenë zëdhënësi.

20 PY. Por nuk është se ka folur vetëm Jakup Krasniqi, kanë  
21 folur dhe të tjerët, apo jo?

22 PË. Nuk mund të them me përqindje se kush ka folur sa për  
23 qind të takimit, por Jakup Krasniqi ka një prej folësve në  
24 këtë takim.

25 PY. Po Jakup Krasniqi ka qenë një prej personave që ka folur

1 në atë takim dhe ju nuk është se e keni pasqyruar të plotë

2 këtë që sapo thamë në shënime tuaja?

3 PË. Kjo është natyra e shënimeve, ti shkruan pikat kryesore

4 në shënime. Nuk është e thënë që të shkruash çdo gjë që është

5 thënë.

6 PY. Por në shënime nuk thuhet asgjë që problemi qëndronte tek

7 fakti që Milazim Krasniqi ishte aleat i ngushtë i Rugovës, nuk

8 thuhet në shënime kjo gjë, apo jo, Dëshmitar?

9 PË. Jo. Nuk e shohim të shkruar në shënime.

10 PY. Sikurse e dini, z. Krasniqi ka qenë pjesë e LDK-së dhe ai

11 e njihte mirë udhëheqësit ose figurat udhëheqëse të LDK-së,

12 apo jo?

13 PË. Mendoj që në atë kohë ai ishte ish-anëtar i LDK-së,

14 domethënë, kishte qenë anëtar i LDK-së më përpara?

15 PY. Po, keni të drejtë.

16 PË. Po, sigurisht që ai i njihte personalitetet e LDK-së.

17 PY. A mund të ketë qenë arsye që kundërshtimi për të qenë

18 Milazim Krasniqi personi drejtues i platformës, ka qenë

19 njohuria e tij se e njihte mirë këtë person nga LDK-ja dhe nuk

20 mendonte që ishte i aftë ai person për të qenë udhëheqësi i

21 delegacionit?

22 PË. Unë nuk e njoh Milazim Krasniqin mjaftueshëm për të qenë

23 në gjendje për t'ju përgjigjes pyetjes tuaj.

24 Z. ELLIS: [Përkthim] Tani kalojmë te kabllogrami që është

25 prova material P01220. Shpresoj që numri i provën materiale të



1 jetë numri i saktë. Ju lutem paraqiteni në ekran këtë provë.

2 Ju lutem shkojmë në faqen 4 të dokumentit.

3 PY. Më duket sikur anglishtja dhe shqipja nuk janë tamam-  
4 tamam të përkthyer siç duhet, po këtu thuhet – besoj se ju  
5 lexoni tek anglishtja. Thotë:

6 "Reagimi fillestar përfaqësuesit e UÇK-së e refuzuan  
7 tërësisht Nekibe Klemendin nga LDK-ja dhe kërkuan pjesëmarrje  
8 nga LPK-ja ..."

9 Kjo është një memo që keni shkruar të nesërmen, apo jo,  
10 më 31 korrik, kështu?

11 PË. Kështu.

12 PY. Këtu s'përmendet të ketë pasur ndonjë problem me Melazim  
13 Krasniqin. Por këtu flitet për Nekibe Kelmendin që është një  
14 persona krejt tjetër në LDK.

15 PË. Po.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Ellis, do  
17 kërkon që të pranojmë ndonjë prej këtyre dokumenteve, apo jo?

18 Z. ELLIS: [Përkthim] Besoj që këto që po shohim tani janë  
19 pranuar tashmë.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] [Mikrofoni  
21 çaktivizuar]

22 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Z. Ellis, nuk mendoj që  
23 këto dy faqe të shtojcave që po përdorni me numër U008-1332-  
24 U008-133 janë pranuar. Megjithatë e lëmë në dorën tuaj si të  
25 vendosni.

1 Z. ELLIS: [Përkthim] Këto janë shënimet me shkrim para  
2 takimit dhe shënimet me shkrim gjatë takimit.

3 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Po, për këto bëhet fjalë.

4 Z. ELLIS: [Përkthim] E vlerësoj që më rikujtuat për këtë  
5 gjë. Atëherë kërkoj që të pranohen të dy dokumentet bëhet  
6 fjalë për materialet me numër U008-1332, 1323, 1333.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] [Mikrofoni  
8 çaktivizuar]

9 Z. CAPIN: [Përkthim] Nuk kemi kundërshtime.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Nuk shohim të  
11 këtë kundërshtime. Rrjedhimisht dokumenti me numër U008-1332,  
12 në faqet, 1333, 132 pranohen.

13 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,  
14 dje u pranuar disa faqe nga i njëjti dokument dhe morën numrin  
15 e provën materiale 1D00142, kështu që unë propozoj që këto dy  
16 faqe t'i bashkëngjisim tek e njëjta provë materiale.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka  
18 kundërshtime?

19 Z. ELLIS: [Përkthim] Nuk ka kundërshtime.

20 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Atëherë këto dy faqe i  
21 shtohen provën materiale 1D00142 dhe klasifikohen si  
22 konfidenciale.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

24 Z. ELLIS: [Përkthim]

25 PY. Pra, pamë që ka një dallim mes procesverbalit që keni

1 pasur e shkrim dhe atë që keni shtypur në kompjuter. Në një  
2 dokument flitet për Milazim Krasniqin dhe dokumenti tjetër  
3 flitet për Nekibe Kelmendin?

4 PË. A mund ta shoh të tërë dokumentin?

5 PY. Cilën faqe?

6 PË. Po faqen pararendëse të shoh çfarë.

7 PY. Në fakt dhe këtë do të thoja dhe unë, të shikojmë faqen  
8 pararendëse. Na thoni kur të keni përfunduar që të shikojmë më  
9 poshtë në faqe.

10 PË. Shikojmë më poshtë në faqe. Po unë këtu flas për një listë  
11 që nuk e kam diskutuar në detaje në takimin e 31 korrikut. Ka  
12 mundësi që këtë listë mund ta kem marrë nga Blerim Shala, një  
13 gazetar tjetër që punonte me amerikanët, kjo është një listë  
14 me emra.

15 PY. Shohim që ka edhe emra të tjerë të LDK-së në listë. Fadil  
16 Hysa, për shembull, Kol Berisha, kështu?

17 PË. Kështu.

18 PY. Dhe ju nuk keni thënë që UÇK-ja të kishte probleme me  
19 ndonjë prej këtyre emrave që sapo thashë?

20 PË. Kështu është. Po gjithashtu thuhet ka pas probleme dhe me  
21 Fehmi Aganin sepse Fehmi Agani kishte bërë disa deklarata  
22 negative për UÇK-në, kështu që as nuk e kanë vendosur në listë  
23 këtë për shkak se mendonin që UÇK-ja s'do ta pëlqente këtë  
24 gjë.

25 PY. Do flasim edhe për Fehmi Aganin pak më vonë. Besoj se ju

1 atë e njihni sepse ka qenë pjesë e delegacionit të Rambujesë  
2 nga ana e LDK-së? Por emri i tij nuk është diskutuar fare me  
3 z. Krasniqi në takimin e 30 korrikut sepse nuk ka qenë në  
4 listën që kishit parë ju?

5 PË. Po.

6 PY. Dhe informacionin për Fehmi Aganin e keni marrë nga  
7 Blerim Shala që ishte gazetar, nuk ishte anëtar i UÇK-së?

8 PË. Kështu, po. Ama ai përdorej edhe si këshilltar për  
9 faktorët ndërkombëtarë.

10 Z. ELLIS: [Përkthim] Dua t'ju tregoj dokumentin me numër  
11 U0015-8743, që është pranuar tashmë me numrin e provën  
12 materiale P00189. Dhe më intereson faqja U0015-8842. Mbase  
13 mund të jetë faqja 100 në PDF.

14 PY. Besoj se këtë dokument ua tregoi dhe Prokuroria  
15 fillimisht javën e kaluar por edhe dje. Është pjesë e një  
16 libri ku përmendet dhe ky takim. Dhe dje ju thatë se kryesisht  
17 përputhej me atë që ju kujtohej dhe ju nga ky takim. E mbani  
18 mend këtë?

19 PË. Po.

20 PY. Në faqen e parë shohim që është dhe data e takimit 31  
21 korrik 1998. Po kjo është gabim? Sepse ka qenë një ditë më  
22 përpara, data 30?

23 PË. Po. Sipas raportit tim po.

24 Z. ELLIS: [Përkthim] Shkojmë në faqen tjetër. Në krye të  
25 faqes.

1 PY. Këtu thuhet që:

2 "... kemi kërkuar që krahas organeve ligjore, LPK-ja ...  
3 dhe LKÇK-ja ... të marrin po ashtu pjesë në bisedime sepse dhe  
4 ata janë pjesë e përpjekjeve të luftës".

5 Pra, ky është i njëjti aspekt që po flisnim dhe bashkë,  
6 të bëhet identifikimi i pjesëmarrësve në këtë platformë, apo  
7 jo?

8 PË. Po. Kjo ishte kërkesë nga UÇK-ja. Po këto janë parti të  
9 majta nacionaliste. Dhe unë e kam shpjeguar që LPK-ja kishte  
10 dy degë, një të brendshme një të jashtme. Besoj se shumica  
11 ishin të jashtëm domethënë, sepse ishin jashtë Kosovës ishin  
12 pjesë e diasporës.

13 PY. Çështja e këtyre subjekteve ligjore është për faktin  
14 sepse partitë politike që njiheshin aso kohe ishin LDK-ja,  
15 LBD-ja, apo jo?

16 PË. Nuk e di nëse LBD-ja njihesh si subjekt ligjor. Këto  
17 partitë politike anti-LDK, formoheshin, reformoheshin,  
18 rigrupoheshin në mënyrë të vazhdueshme, të paktën në muajt që  
19 i kam trajtuar unë këtë aspekt.

20 PY. E kuptoj. Por të paktën LDK-ja ka qenë subjekt ligjor,  
21 apo jo, në atë kohë?

22 PË. Po nuk e di a ka qenë e regjistruar si parti politike në  
23 Serbi apo gjetkë.

24 PY. E kuptoj. Po këtu duket sikur kjo është një kërkesë që të  
25 marrin pjesë edhe LPK krahas subjekteve ligjore, kështu?

1 PË. Edhe LKÇK-ja.

2 PY. Ju kërkoj ndjesë. Po. LPK-ja edhe LKÇK-ja të marrin pjesë  
3 po ashtu përkrah subjekteve ligjore?

4 PË. Po.

5 Z. ELLIS: [Përkthim] Shohim një dokument tjetër në ekran,  
6 DJK00789.

7 PY. Dëshmitar, ky është një artikull i shkruar nga Milazim  
8 Krasniqi, ku shpreh opinionin e tij për arrestimin e Jakup  
9 Krasniqi në 2020. Dhe unë dua që të fokusohesh në pjesën ku  
10 Milazim Krasniqi ka thënë që ka punuar me Jakup Krasniqin në  
11 Lidhjen Demokratike të Kosovës kur ka qenë aktivist përpara se  
12 të shkonte në luftë.

13 E dinit ju që Milazim Krasniqi dhe Jakup Krasniqi kanë  
14 punuar bashkë në LDK?

15 PË. Jo.

16 PY. Dhe në këtë dokument nuk thuhet gjëkund që Milazim  
17 Krasniqi të ketë pasur ndonjë vështirësi me Jakup Krasniqin?

18 PË. Është hera e parë që e shoh këtë dokument.

19 PY. E kuptoj. Po, do flasim për Milazim Krasniqin prapë kur  
20 të jem në përfundim të kundërpjetjeve të mia.

21 Z. ELLIS: [Përkthim] Tani doja të shihnim një dokument  
22 tjetër, DJK00787.

23 Të nderuar Gjykatës, sapo më kujtuan që duhet të kërkoj  
24 të pranohet dokumenti me numër DJK00789.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka

Dëshmitari: Jan Kickert (Vijon) (Seancë e hapur)  
Pyetje të palës tjetër nga z. Ellis

Faqe 23

1 kundërshtime?

2 Z. CAPIN: [Përkthim] Nuk ka kundërshtime.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Pranohet  
4 dokumenti DJK00789.

5 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,  
6 dokumenti dhe përkthimi në gjuhën angleze do marrin numrin e  
7 provën materiale 4D00051 me klasifikimin publik.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] [Mikrofoni  
9 çaktivizuar]

10 Faleminderit, z. Ellis.

11 Z. ELLIS: [Përkthim]

12 PY. Dëshmitar, a patët mundësi ndërkohë ta shihnit dokumentin  
13 në ekran?

14 PË. Po.

15 PY. A e keni parë më përpara këtë dokument?

16 PË. Jo.

17 PY. Por në pamje të parë është një telegram ngushëllimi që ka  
18 shkruar Dr. Jakup Krasniqi për vdekjen e znj. Nekibe Kelmendi  
19 në 2015. Kështu duket sikur është, apo jo?

20 PË. Po, kështu duket sikur është.

21 PY. Dhe ai shpreh, faktin që znj. Kelmendi ka qenë një humbje  
22 e madhe për ju, familje e nderuar, për miqtë, për kuvendin e  
23 Kosovës. Znj. Kelmendi kontribuoi në mbrojtjen e të drejtave  
24 të qytetarëve tanë në kohën më të egër të pushtimit serb e  
25 demaskoi atë gjithandej në botën demokratike dhe mori pjesë

1 aktive në ndërtimin dhe në zhvillimin e institucioneve tona  
2 shtetërore.

3 "Vepra e saj do të kujtohet vazhdimisht me respekt të  
4 veçantë".

5 Dhe në këtë dokument nuk duket sikur të ketë pasur ndonjë  
6 armiqësi personale me z. Krasniqi dhe znj. Kelmendi.

7 Z. CAPIN: [Përkthim] Kundërshtoj. Dëshmitar, nuk e ka  
8 parë ndonjëherë këtë dokument dhe nuk ka asnjë bazë për t'ju  
9 përgjigjur pyetjes.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Rrëzohet.

11 Vazhdoni.

12 DËSHMITARI: [Përkthim] Ky është një dokument i 2015, jo i  
13 1998. Mesa mbaj mend unë, znj. Nekibe Kelmendi humbi burrin  
14 dhe dy djemtë gjatë luftës. Ne kemi punuar me të pas luftës.  
15 Ishte një personalitet shumë i fort dhe punonte për pajtimin,  
16 besoj se ka qenë pjesë e Këshillit të Përkohshëm Tranzicional  
17 të Kosovës. Dhe për dikë që ka humbur familjen dhe të kërkoj  
18 të ketë pajtim, do të thotë që ne këtë e konsideronim një  
19 aleate shumë të madhe edhe ajo i ka merituar fjalët që ka  
20 shprehur z. Krasniqi në telegramin e 2015.

21 Z. ELLIS: [Përkthim]

22 PY. Bashkëshorti i saj Bajram Kelmendi u vra prej serbëve,  
23 kështu?

24 PË. Po.

25 Z. ELLIS: [Përkthim] Kërkoj të pranohet ky dokument.



1 Z. CAPIN: [Mikrofoni çaktivizuar].

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dokument  
3 DJK00787pranohet.

4 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Merr numrin e 4D0052  
5 dhe nuk ka klasifikim në *Legal Workflow*.

6 Z. ELLIS: [Përkthim] Mund të jetë dokument publik.

7 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Ju faleminderit.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Atëherë  
9 klasifikoheni dokumentin si publik.

10 Z. ELLIS: [Përkthim] Mund të hiqet dokumenti nga ekrani.

11 PY. Të flasim sërish për takimin e 30 korrikut, ju keni  
12 shkruar se UÇK-ja ka përmendur se Serbia kishte përdorur armë  
13 kimike. Tani pas 26 vitesh nuk ju kujtohet konkretisht si doli  
14 kjo temë gjatë bisedimeve?

15 PË. Kjo ishte një akuzë e përgjithshme dhe ne u befasuam  
16 shumë. Sepse ishte hera e parë që e dëgjonim dhe nuk besoj se  
17 e kam dëgjuar më kurrë këtë pretendim.

18 PY. Po a mund të ketë lidhje kjo me ngjarje që kishin ndodhur  
19 më përpara si helmimi në shkollën në vitin 1990?

20 Z. CAPIN: [Mikrofoni çaktivizuar].

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Pranohet.

22 Z. ELLIS: [Përkthim]

23 PY. A mund të ketë pasur ndonjë çështje problematike që mund  
24 të ketë lindur nga përkthimi lidhur me këtë?

25 PË. Besoj se fjala dhe në anglisht dhe në shqip njësoj është

1 fjala "kimike".

2 PY. Në shënimin tuaj konfirmoni që UÇK-ja po thoshte se po  
3 largohej nga lufta në fron në atë kohë. Ju kujtohet kjo,  
4 zotëri?

5 PË. Po.

6 PY. Në atë kohë pra, UÇK-ja ishte duke u tërhequr, apo jo?

7 PË. Po.

8 PY. Ju tregoj një dokument z. Emmerson dje, besoj se është  
9 një dokument që është në listën e materialeve të Mbrojtja së  
10 Veselit, është dokumenti që ka numër SPOE00329166 dhe në atë  
11 dokument është një raport ditor nga Misioni i Vrojtuesve të  
12 BE-së në Kosovë, kur 23 korrik 1998, ku thuhet se:

13 "Rahoveci është braktisur nga populli i vet dhe rreth  
14 20.000 persona mendohet se kanë shkuar në Malishevë".

15 Ju kujtohet ky dokument që dje?

16 PË. E mbaj mend dokument që dje.

17 Z. ELLIS: [Përkthim] Nuk mendoj që është nevoja ta  
18 shfaqim dokumentin në ekran, po dje nuk është kërkuar që të  
19 pranohet si provë dhe do të doja unë që ta pranojë si provë  
20 për ne.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

22 Z. ELLIS: [Përkthim] Dokumenti SPOE00329166-0329167 është  
23 numri i dokumentit.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka  
25 kundërshtime?

1           Z. CAPIN: [Përkthim] Nuk e kam të qartë për cilin  
2 dokument bëhet fjalë.

3           KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Cili  
4 dokument?

5           Z. ELLIS: [Përkthim] E ka titullin "Raport ditor nga  
6 Misioni i Vrojtuesve të Behajdin-së në Kosovë, Data 23  
7 korrik". Është një dokument me dy faqe.

8           KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju lutem  
9 vendoseni në ekran, kam nevojë ta shoh në ekran.

10          Dhe dua të korrigjoj dhe pak procesverbalin, kur bëri  
11 kundërshtim z. Capin dhe unë e pranova, ai nuk e kishte  
12 mikrofonin të ndezur. Ai tha se e kundërshtoj në bazë të  
13 relevancës.

14          Z. CAPIN: [Përkthim] Faleminderit.

15          Z. ELLIS: [Përkthim] Po, ky dokument është.

16          KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Atëherë nuk  
17 ka kundërshtime për këtë dokument. Dhe dokumenti do të  
18 pranohet si provë gjyqësore.

19          SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Dokumenti me ERN  
20 SPOE00329166 deri në 00329167 pranohet dhe merr numrin e  
21 provën materiale 4D0053 me klasifikim konfidencial.

22          Z. ELLIS: [Përkthim] Faleminderit. Besoj se mund të jetë  
23 edhe publik.

24          KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka ndonjë  
25 kufizim për këtë dokument?

1 Z. CAPIN: [Përkthim] Jo, me sa kam dijeni.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund të jetë  
3 publik.

4 Z. ELLIS: [Përkthim]

5 PY. Dëshmitar, kjo ishte për kontekst, por biseda që keni  
6 bërë me z. Krasniqi, pra, që më 30 korrik, ishte që kishte  
7 filluar ofensiva serbe dhe UÇK-ja po tërhiqej në zonat në  
8 fshatrat malor, kështu?

9 PË. Kështu.

10 PY. Dhe gjatë bisedës z. Krasniqi dhe UÇK-ja deshën që të  
11 vazhdonin që të ishin pjesë e negociatave politike, apo jo?

12 PË. Po. Sigurisht, ne nuk po e refuzonim këtë në atë kohë.

13 PY. Absolutisht. Nuk po them që e keni bërë. Por gjatë kohës  
14 qepo bisedonin me ju, ata deshën të jepnin pamjen, deshën që  
15 të jepnin një paraqitje sikur ishin më të fortë seç ishin  
16 realisht në atë kohë, në rrethanat e asaj kohe duke marrë  
17 parasysh rrethanat e saj kohe?

18 PË. Besoj se për mua, gjatë bisedimeve, ata morën një goditje  
19 të rëndë. Patën më shumë vetëbesim seç duhet sepse kishin  
20 pasur në kontroll Malishevën. Dhe thanë që e konfirmuan që  
21 Rahoveci kishte rënë në duart serbe. Unë nuk mendoj se  
22 Rahoveci që fillimisht nuk ka qenë ndonjëherë në duart e UÇK-  
23 së. Po pati sulme në periferi edhe pati kundërsulme edhe UÇK-  
24 ja shkoi më tej, hyri më tej, përparoi më tej në Malishevë.

25 PY. Gjatë kohës që keni biseduar më 30 korrik, UÇK-ja deshët

1 të thoshit ishte jashtë Malishevës?

2 PË. Nuk mund t'ua them me saktësi datën.

3 PY. E kuptoj. Po ata deshën që të lironin të gjithë Kosovën  
4 jo të qëndronin në fshatrat malorë, kështu?

5 PË. Absolutisht.

6 PY. Dhe mesa keni ju dijeni, nuk ka pasur ndonjë sulm të UÇK-  
7 së në Prishtinë në atë kohë, apo jo?

8 PË. Ka pasur në periferi, më duket se në Bllacevac ka pasur  
9 një lloj sulmi, sepse kam rilexuar një dokument, ku thuhet që  
10 atje ishte vendosur ish-armata jugosllave për të bërë çlirimin  
11 prej tyre.

12 PY. në rregull.

13 Z. ELLIS: [Përkthim] shkojmë shkojmë dhe një herë memon  
14 tuaj që është prova materiale P1220. Në faqen e dytë. Shkojmë  
15 më poshtë.

16 PY. Është paragrafi i fundit ku thuhet se:

17 "Është bërë sugjerimi ..."

18 Është sugjerimi juaj apo i David Slinn ky?

19 PË. Unë kam thënë që këtu ka qenë sugjerimi im, po mund të  
20 themi që kishim pasur një dakordësi paraprake, kështu që mund  
21 të themi që ka ardh sugjerimi prej të dyve. Pra, sugjerimi  
22 ishte që UÇK-ja të merrte një vendim urgjent sepse kishin  
23 humbur shumë kohë?

24 PË. Po, po ua shpjegoja që kishim komunikime, jepnin e  
25 merrnim gjatë gjithë kohës dhe në momentin që mendonim që e

1 kishim nga ana jonë një aktor politik nga ana e Kosovës,  
2 largoheshin të tjerët nga ajo platformë e përbashkët siç e  
3 quanim ne. Pra, jepnim e merrnim gjatë gjithë kohës.

4 PY. Po në takimin e 30 korrikut, z. Krasniqi ka shprehur  
5 gatishmërinë që të ishte pjesë e platformës, apo jo?

6 PË. Po. Dhe tha që ne do t'ju japin edhe emra, nuk pati ende  
7 gjë konkrete.

8 PY. Prandaj ju propozuat që të bëhej një vizitë tjetër nga  
9 ambasada austriake dhe britanike më 3 ose 4 gusht, apo jo?

10 PY. Kështu,

11 PY. Takimi s'u mbajte ama?

12 PË. Po.

13 PY. Arsyeya për këtë është se filloi ofensiva serbe dhe  
14 humbët kontaktin me pikat tuaja të kontaktit, kështu?

15 PË. Kështu.

16 Z. ELLIS: [Përkthim] Të shohim një raport për atë kohë.  
17 Dokumenti i parë është me numër SPOE00304399. Shkojmë pak më  
18 poshtë.

19 PY. Keni parë disa dokumente të tilla të ngjashme por në  
20 korrik të 1999, ECMM-ja kishte monitorues në terren në Kosovë,  
21 apo jo, nga korriku e në vijim?

22 PË. Po. Në fakt filluam nga maji i 1998 kishim një ekip të  
23 lëvizshëm, që e sollëm nga Mali i Zi. Pastaj krijuam ekipet e  
24 ECMM-së. Dhe duke qenë se kishim edhe kryesinë e Këshillit të  
25 Evropës, që nga 1 korriku e në vijim kishte shumë forca të

1 armatosura austriake që ishin pjesë e këtyre misioneve të  
2 vrojtuesve.

3 PY. Domethënë edhe ata përgatisnin raporte javore aso kohe,  
4 apo jo?

5 PË. Javore dhe ditore.

6 PY. I merrnit ju dokumentet në atë kohë?

7 PË. I merrnim si kopje fizike me pak vonesë.

8 PY. Që nga 30 korriku 1998, pra, që nga dita e takimit tuaj,  
9 thuhet në paragrafin 1, që ka pasur një ofensivë serbe të  
10 planifikuar paraprakisht që të merrnin serish në kontroll  
11 territoret që po kontrollonte UÇK-ja që lidhte Drenicën me  
12 Malishevën?

13 PË. Kështu thuhet këtu.

14 Z. ELLIS: [Përkthim] Shkojmë në paragrafin e dytë.

15 PY. Këtu është zbardhur dhe thuhet se:

16 "Strategjia duket e qartë, ndarja e territoreve duke  
17 dominuar të gjitha rrugët, të pengohet lëvizshmëria e UÇK-së  
18 dhe të përgatiten pozicionet në mënyrë që të ketë një qasje më  
19 sistematike për të mbyllur të gjitha dyert e UÇK-së apo rrugët  
20 e UÇK-së".

21 A përputhet kjo me raportet që keni parë dhe ju në atë  
22 kohë?

23 PË. Po. Mund të shohim në fakt që nga mënyra sesi është  
24 formuluar që kanë qenë ushtarakë ata që e kanë shkruar  
25 raportin dhe jo diplomatët, diplomatët modestë.

1 PY. Pra, atë që kanë përshkruar ushtarakët këtu është, ata  
2 kanë përshkruar strategjinë që po përdorej për të ndarë  
3 territorin për të izoluar dhe për të ndarë UÇK-në, kështu?

4 PË. Ishte dëshira e tyre që të kontrolloinin rrugët kryesore  
5 të komunikacionit sepse ishin bllokuar këto rrugë përpara  
6 ofensivës?

7 PË. Por pas ofensivës, rrugët kryesore të komunikacionit  
8 kontrolloheshin nga forcat serbe, apo jo?

9 PË. Po.

10 Z. ELLIS: [Përkthim] I nderuar Gjykatës kërkoj që të  
11 pranohet ky dokument?

12 Z. CAPIN: [Përkthim] Nuk kam kundërshtime.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dokumenti me  
14 numër SPOE00304399 pranohet.

15 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Kam nevojë për një  
16 sqarim. I gjithë dokumenti apo vetëm një faqe?

17 Z. ELLIS: [Përkthim] Besoj se dokumenti tërë-tërë ka dy  
18 faqe. Besoj të dyja faqet është nevoja të pranohen.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar]  
20 [Përkthim]... atëherë na jepni numrat për të dyja faqet.

21 Z. ELLIS: [Përkthim] Është dokumenti SPOE00304399 deri në  
22 304 -- më falni, e kam gabim. Është numri tek faqja e parë,  
23 kështu që mund të vendosni faqen e parë.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Domethënë, ju  
25 doni thjesht të pranoni dokumentin që përfundon me 399?



Dëshmitari: Jan Kickert (Vijon) (Seancë e hapur)  
Pyetje të palës tjetër nga z. Ellis

Faqe 33

1 Z. ELLIS: [Përkthim] Po.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.  
3 Dokumenti që përfundon me këtë numër do të pranohet.

4 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,  
5 dokumenti do të marrë numrin e provën materiale 4D00054 dhe  
6 është i klasifikuar si konfidencial.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Keni arsye  
8 për ta mbajtur këtë dokument si konfidencial?

9 Z. CAPIN: [Përkthim] Jo.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Atëherë  
11 riklasifikohet si publik.

12 Z. ELLIS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, po shoh orën. A  
13 do bëjmë pushim në orën 10.00?

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po.

15 Dëshmitar, sikurse bëmë edhe dje do t'ju japim 10 minuta  
16 pushim. Do të rifillojmë në orën 10.10. Ju mund të dilni nga  
17 salla e gjyqit me Asistenten e Gjykatës.

18 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Bëjmë dhjetë  
20 minuta pushim.

21 --- Seanca ndërpritet në orën 10.01

22 --- Seanca rifillon në orën 10.12

23 [Dëshmitari vijon dëshminë]

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim]

25 Në rregull. Z. Ellis. Mund të vazhdoni.

1 Z. ELLIS: [Përkthim] Faleminderit.

2 A mund të shfaqim në ekran një dokument tjetër nga ekipi  
3 monitorues që është SPOE00304334 deri në 339. Jo.

4 PY. Tani kalojmë në datën 14 gusht 1999 -- 1998, pra pak më  
5 përpara, dy javë pas takimit në Kleçkë. Dhe besoj që

6 konfirmuat që në këtë kohë vëmendja e austriakëve, e juaja,  
7 përqendrohej tek çështjet humanitare, personat e zhvendosur?

8 PË. E saktë.

9 PY. Në qoftë se mund t'ju paragrafin e parë të këtij  
10 dokumenti të ekipit monitorues. I referohet katastrofës  
11 njerëzore ku thohet që:

12 "Janë zona të tëra janë shkatërruar ... deri në 200.000  
13 njerëz janë detyruar të largohen, dëbuar nga shtëpitë e tyre.  
14 Shumë janë zhvendosur në zonat e tjera duke krijuar një  
15 situatë ku më shumë se 800.000 në gjendje të rëndë dhe kanë  
16 nevojë të theksuar për ushqim dhe trajtim mjekësor."

17 PË. Po.

18 Z. ELLIS: [Përkthim] Mund të kalojmë tani te faqja  
19 30304338.

20 PY. Vlerësimi që bëhet këtu është që:

21 "UÇK-ja sipas vlerësimeve të shumë njerëzve tani po  
22 përballet me disfatë në terren. Struktura e tyre komanduese po  
23 fragmentohet gjithnjë e më shumë."

24 A është ky një mesazh që ju e keni marrë nga monitorët e  
25 -- vëzhguesit në terren të ekipit vëzhgues për atë kohë?

1 PË. Nuk më kujtohet dhe nuk do të pohoja një gjë të tillë.

2 Z. ELLIS: [Përkthim] Do të dorëzoja këtë dokument, të  
3 nderuar Gjykatës, si provë.

4 Z. CAPIN: [Përkthim] Nuk kemi kundërshtim, por u  
5 informova, ne po verifikojmë burimin e këtij dokumenti dhe dy  
6 -- si dhe dy dokumente të tjera që u dorëzuan më parë. Mund të  
7 jetë rasti që vartësisht nga ajo që marrim ne si informacion që  
8 do të kërkojmë që ky dokument të riklasifikohet si  
9 konfidencial. Por, ky duhet të mbesë konfidencial, të nderuar  
10 Gjykatës.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] A po kërkon  
12 të pranohet vetë kjo faqe?

13 Z. ELLIS: [Përkthim] Dy faqe të cilat i përdora por  
14 pajtohem që duhet të mbesin konfidenciale gjatë kohës që bëhen  
20 sigurt a ishin zëvendësit apo kujt i përkisnin, cilës parti i  
21 përkisnin?

22 PË. Nuk isha i sigurt a i kishin vërtet këto pozita.

23 PY. Po ju s'keni komunikuar me këta dy persona?

24 PË. A mund ta shohim edhe një herë dokumentin, ju lutem?

25 PY. Patjetër.

1 Z. ELLIS: [Përkthim] Është lista me emrat që keni

2 vendosur ju; është prova materiale P1244, ishte faqja që

3 mbaronte 950, me numrin 950.

4 DËSHMITARI: [Përkthim] Nuk më thonë asgjë këto emrat e

5 zëvendësve.

6 Z. ELLIS: [Përkthim]

7 PY. Po ju e keni parë në ç'kushte ka qenë Kosova pas

8 konfliktit.

9 Z. ELLIS: [Përkthim] Po do t'ju tregoj disa dokumente. I

10 pari është SPOE00305417.

11 PY. Ekipi Monitorues ishte akoma në terren dhe raportonte në

12 korrik të '99-s?

13 PË. Me sa duket.

14 PY. A mund të shohim paragrafin 6 së bashku. A ishit në

15 dijeni në atë kohë që bëheshin raporte lidhur me vendqëndrimet

16 që ishin dëmtuar?

17 PË. Po.

18 PY. Dhe kjo është raporti ku thuhet që 126 000 [Sipas

19 përkthimit] ishin dëmtuar, 77 000 shtëpi dëmtuar.

20 Dyzet për qind e fshatrave raportohet që kishin cilësinë

21 e ujit dhe sasinë e ujit të papërshtatshme.

22 Është -- përputhet kjo me atë që dëgjonit ju në atë kohë?

23 PË. Po, e kam fjalën që ne në Kombet e Bashkuara kishim katër

24 shtylla. Shtylla humanitare që ishte vullnetare, punonte me

25 UNHCR-në dhe, por Bashkimi Evropian, pjesa humanitare, pra,

Dëshmitari: Jan Kickert (Vijon) (Seancë e hapur)  
Pyetje të palës tjetër nga z. Ellis

Faqe 76

1 ishte e pranishme gjithashtu gjatë konfliktit në 1998 dhe  
2 bënin raporte mbi shkatërrimet që kishin ndodhur. Dhe kjo  
3 ishte një --, pra, duhej që të veprimej shumë shpejt me qëllim  
4 që njerëzit të ishin në gjendje të mbijetonin, të krijonin  
5 vendstrehime që njerëzit t'i mbijetonin dimrit që vinte. Pra,  
6 për të mbuluar shtëpitë, çatitë, ishin shumë shtëpi të  
7 djegura, çatitë e shkatërruara; kam parë këtë vetë kur kam  
8 shkuar në Kosovë; kam lëvizur nëpër Kosovë; kam shkuar dhe në  
9 shtëpi, në një shtëpi ku kam takuar Hashim Thaçin, e cila  
10 ishte e shkatërruar në Banjë dhe kemi patur mundësi, patëm  
11 mundësi që të sigurojmë një çati për këtë shtëpi.

12 PY. Ishte shqetësim i madh për të gjithë në atë kohë kjo,  
13 sepse siç thoni të gjithë kishin frikë se po afrohej dimri dhe  
14 njerëzit ishin pa strehim.

15 PË. Sigurisht.

16 Z. ELLIS: [Përkthim] Dorëzoj këtë dokument si provë, i  
17 nderuar Gjykatës.

18 Z. CAPIN: [Përkthim] Nuk ka kundërshtime.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Nuk është  
20 pranuar më parë ky dokument?

21 Z. ELLIS: [Përkthim] Nuk jam i sigurt. Bëhet fjalë për  
22 dokumentin SPOE00305417 deri 419.

23 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Mikrofoni çaktivizuar]

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka ndonjë  
25 kundërshtim?

1 Z. CAPIN: [Përkthim] Nuk ka kundërshtime.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ky dokument,  
3 siç u paraqit, pranohet.

4 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Dokumenti SPOE00305417  
5 deri në 00305419 pranohet si dokumenti 4D00061 me klasifikim  
6 konfidencial.

7 Z. ELLIS: [Përkthim] A mund të shfaqim në ekran  
8 dokumentin SPOE00305422 deri në 423.

9 Z. ELLIS: [Përkthim]  
10 PY. Siç e shihni ky dokument mban datën 26 korrik 1999 dhe  
11 këtu shihet ECMM, i raportit monitorues.

12 Z. ELLIS: [Përkthim] Shohim paragrafin për çështjet  
13 ekonomike; kalojmë në faqen 305423.

14 PY. Ajo që shoh unë këtu është një vlerësim mbi energjinë  
15 elektrike që duhej në Pejë. Flitet, pra, për 8 000 shtëpi nga  
16 11 000 të shkatërruara. Dhe qëllimi është që t'i siguroje  
17 rrymë, energji elektrike vendeve që kishin mbetur -- dhe për  
18 të rregulluar gjithë rrjetin elektrik, pra, dhe në qoftë se  
19 sigurohej ndihmë ndërkombëtare.

20 A kishit dijeni për shqetësimin në atë kohë që t'u  
21 siguroheshin, që shtëpitë të kishin vendstrehim dhe rrymë,  
22 energji elektrike?

23 PË. Sigurisht. E kam fjalën -- kishte ndërprerje të energjisë  
24 elektrike në gjithë Kosovën në mënyrë të vazhdueshme gjatë  
25 dimrit 1999, 2000. Më kujtohet që kam fjetur në zyrë në atë

1 kohë, sepse vendbanimi ku isha ishte i ftohtë.

2 Z. ELLIS: [Përkthim] E dorëzoj këtë dokument si provë.

3 Z. CAPIN: [Përkthim] Nuk ka kundërshtime.

4 Z. ELLIS: [Përkthim] Dy faqe.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] SPOE00305422

6 deri në 00305423 pranohen.

7 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Dokumenti do të marrë  
8 numrin 4D00062 dhe klasifikohet si konfidencial. Faleminderit.

9 Z. ELLIS: [Përkthim]

10 PY. Në realitet, në fakt në atë kohë kishte shumë punë për të  
11 bërë Ministria për Rindërtim dhe Zhvillim.

12 PË. Puna që bëhej nga bashkësia ndërkombëtare kryesisht siç e  
13 thashë ne kishim shtyllën, një prej shtyllave kryesore e  
14 Organizatës së Kombeve të Bashkuara, UNHCR-ja; kishte aktorë  
15 ndërkombëtarë në terren; nuk e di se në çfarë shkalle -- ishte  
16 Ministria e Rindërtimit e përfshirë.

17 PY. Ju ishit i përfshirë në këtë çështje vetë?

18 PË. Jo, fare.

19 PY. Kishit dijeni për ndonjë -- ishit në dijeni të një  
20 konference donatorësh për rindërtimin e Ballkanit, të mbajtur  
21 më 20 shtator 1999 në Uashington?

22 PË. Mund të ketë qenë, mund të ketë ndodhur. Siç ju thashë në  
23 moment ne kishim misionin më të madh se të Kombeve të  
24 Bashkuara. Ishte një departament i punës dhe unë nuk merresha  
25 me çështjet e sigurisë apo humanitare, apo administratën

Dëshmitari: Jan Kickert (Vijon) (Seancë e hapur)  
Pyetje të palës tjetër nga z. Ellis

Faqe 79

1 civile.

2 PY. Pra, mund të ndodhi që zoti -- të ketë qenë rasti që z.

3 Krasniqi të ketë qenë i përrshirë me këtë -- të ketë punuar me

4 Kombet e Bashkuara për këto çështje, ju nuk e dini?

5 PË. Nuk e di.

6 PY. Dua të përfundoj me një fotografi e cila ju tregua juve

7 nga Prokuroria në seancën përgatitore dhe përsëri gjatë

8 fillimit të dhënies së dëshmisë suaj.

9 Z. ELLIS: [Përkthim] Është dokumenti i pranuar me numrin  
10 P01228.

11 PY. Tani këtu Prokuroria thotë që është dokument që është

12 sekuestruar marrë nga shtëpia e z. Jakup Krasniqi. Ka një

13 debat kundërshtimi lidhur me këtë proces kërkimi dhe marrjeje

14 --

15 PË. Nuk më është treguar kjo fotografi. Nuk di, nuk kisha

16 dijeni se nga vinte.

17 PY. Ju nuk keni ide se kur dhe si ka përfunduar kjo fotografi

18 në shtëpinë e z. Krasniqi, nëse ka ndodhur kjo gjë?

19 PË. Jo, sepse e kam parë për herë të parë para dhjetë ditësh.

20 PY. Ju personalisht nuk keni qenë në shtëpinë e z. Krasniqi,

21 nuk e keni --

22 PË. Nuk mendoj. Kam qenë në shtëpitë e shumë prej

23 bashkëbiseduesve të mi në Kosovë, por nuk mendoj të kem takuar

24 z. Krasniqi në shtëpinë e tij.

25 PY. Pra, nuk e dini nëse ka patur shtëpi [Sipas përkthimit]

1 të z. Rugova apo jo në shtëpinë e z. Krasniqi?

2 PË. Jo.

3 PY. A është e saktë që kjo fotografi nuk përmban delegacionin  
4 e plotë shqiptar në Rambuje? Për shembull, aty mungon Tahiri?

5 PË. Sapo do e thoja që mungon Tahiri. Nuk e shoh këtu. Pra,  
6 mungon një pjesë e vogël, jo një pjesë e madhe.

7 PY. Dhe nuk do të thotë që ata nuk donin të fotografoheshin  
8 me delegacionin. Mund të -- në qoftë se s'do të kishin dashur,  
9 do të ishin larguar?

10 PË. Kjo është pyetje sugjестive. Kjo është fotografi që duket  
11 ku të gjithë kanë dashur, kanë vullnetarisht që të marrin  
12 pjesë aty, të paraqiten në fotografi.

13 PY. Dhe e njihni këtu Ramë Bujën nga UÇK-ja që është afër z.  
14 Rugova?

15 PË. E saktë.

16 PY. Dhe nëse mund të ndihmoni me pjesëtarët, anëtarët e LDK-  
17 së që janë këtu në fotografi, Fehmi Agani është në fotografi  
18 apo jo?

19 PË. Është aty. Nga pikëpamja jonë afër z. Rugova është  
20 Skënder Hyseni i cili ishte këshilltar i tij, këshilltar i  
21 afërt i z. Rugova; Fehmi Agani po ashtu dhe pastaj, pas z.  
22 Krasniqi një burrë më i moshuar, një prej përfaqësuesve të  
23 Partisë Demokristiane që ishte lidhur me LDK-në, e afërt me  
24 LDK-në.

25 PY. A mund t'ju them, unë mund t'ju them që mund të jetë ky



1 person mund të jetë Idriz Ajeti i cili ishte i afërt me LDK-në  
2 në atë kohë?

3 PË. Mund të jetë, por nuk kam patur këtë ndërveprim me të që  
4 të kujtoj, kaq ndërveprim.

5 PY. Po me sa mund të thoni ju, duke u bazuar në këtë  
6 fotografi, nuk ka ndonjë shenjë kundër z. -- nga Agani apo z.  
7 Ajeti, apo përfaqësuesit e tjerë të LDK-së?

8 PË. Me sa shohim, kështu është.

9 Z. ELLIS: [Përkthim] Tani dua t'ju tregoj në fund  
10 dokumentin DJK00798 që shoqërohet me dokumentin origjinal  
11 DJK00798 dhe përkthimi në anglisht që ka shtesën ET.

12 Në fillim të dëshmisë suaj biseduam për një person që  
13 quhet Milazim Krasniqi dhe ju ju kujtohet në deklaratën tuaj  
14 si dëshmitar e keni identifikuar atë si aleat i afërt i  
15 Rugovës?

16 PË. Në atë kohë.

17 PY. Ajo që shikoni këtu në ekran është Milazim -- reagimi i  
18 publikuar i Milazim Krasniqit lidhur me këtë fotografi, dje.  
19 Ka dy karakteristika për të cilat desha të flas me ju së pari.

20 Aty thuhet që z. Krasniqi ishte kryesues i degës së LDK-  
21 së në Drenas. Ju thatë që më parë kishte qenë pjesëtar, anëtar  
22 i LDK-së. E dini që ky ishte kryetar i degës së LDK-së në  
23 Drenas?

24 PË. Jo.

25 PY. Më tej, më poshtë thuhet:

1 "Ndërkohë në Rambuje Jakup Krasniqi u pranua si kandidat  
2 për kryeministër nga qeveria e bashkuar, nga vetë Rugova".

3 Kjo është, kjo përputhet me raportet që pamë më herët.  
4 Propozimet për qeverinë e përkohshme në Rambuje?

5 PË. Nuk mund ta konfirmoj që "vetë Rugova" e pranoi, por ai u  
6 pranua si kandidat, si kryeministër. Por delegacioni, siç e  
7 kemi parë në kabllogramin britanik, z. Rugova, në qoftë se ta  
8 them butë, ishte pasiv në Rambuje. Ai nuk ishte faktor  
9 ekzistues fare aty. Ne kemi biseduar për çështje thelbësore më  
10 shumë me pjesëtarët e tjetër të LDK-së dhe jo me të fare.

11 PY. Dhe vazhdon:

12 "Gjatë bombardimeve më 1 maj 1999, një delegacion i LDK-  
13 së u takua me Jakup Krasniqin në Tiranë tek Meriman -- në  
14 shtëpinë e apartamentin e Meriman Brahas me qëllim që të  
15 gjenin hapësirë për afrim dhe bashkëpunim mes LDK-së dhe UÇK-  
16 së në ato rrethana. Jakup Krasniqi ishte shumë konstruktiv  
17 gjatë takimit nuk tha asnjë fjalë të keqe për Rugovën gjatë  
18 atij takimi".

19 Ishit në dijeni që në maj të 1999-s në takim u bënë  
20 takime mes pjesëtarëve të LDK-së dhe UÇK-së me qëllim të  
21 bashkëpunimit?

22 PË. Jo. Edhe unë kam shkuar në Tiranë. Jam takuar me  
23 pjesëtarë të delegacionit, në këtë rast në Tiranë ka qenë më  
24 shumë Xhavit Haliti nga UÇK-ja si pjesë e delegacionit. Por  
25 nuk më kujtohen takime mes LDK-sh dhe UÇK-së në atë kohë.

1 PY. Ky pjesëtar, anëtar i LDK-së thotë që "Jakup Krasniqi  
2 ishte person me integritet të lartë". Kjo është, kjo në  
3 përputhje me atë që keni shënuar në memorandumimin tuaj dhe që  
4 kemi dëgjuar, që keni dëgjuar nga palët të tjera të  
5 delegacionit të UÇK-së?

6 PË. Është e saktë.

7 Z. ELLIS: [Përkthim] Dorëzoi këtë dokument si provë.

8 Z. CAPIN: [Përkthim] Kundërshtim, të nderuar. Nuk mendoj  
9 që kjo shërben qëllimin e Gjykatës që të ketë fakte, pra, që  
10 të jetë komentare të jashtme të që nuk janë të kohës, të  
11 kohës, pra, që janë të të njëjtës -- të periudhës kohore në  
12 fjalë që të shtohet në procesverbalin e kësaj procedure. Pra,  
13 thelbësisht bëhet fjalë për relevancën dhe bazën -- është  
14 kundërshtim mbi relevancën dhe bazën e paraqitjes dhe  
15 përdorimit të dokumentit.

16 Z. ELLIS: [Përkthim] A mund të përgjigjem?

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar]  
18 [Anëtarët e Trupit Gjykses këshillohen]

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po, z. Ellis.

20 Z. ELLIS: [Përkthim] Prokuroria përpiqet -- zgjodhi që të  
21 përdornin fotografitë e gjendur gjatë një bastisjeje pa  
22 paraqitur një bazë; e përdori përmes këtij dëshmitari dhe  
23 pastaj e kundërshton në mënyrë të drejtpërdrejtë përpjekjen e  
24 Mbrojtjes që t'i përgjigjet menjëherë kësaj gjëje.

25 Fotografia është pranuar. Përgjigja dhënë ndaj saj nga z.

1 Milazim Krasniqi duhet të pranohet edhe kjo, por sidoqoftë  
2 palët që mbi të cilët e pyeta dëshmitarin sot janë pjesë  
3 relevante të ngjarjes, për ngjarjet në vitin 1998, 1999 ku  
4 përfshihet klienti im, z. Krasniqi, dhe kontaktet e tij me  
5 LDK-në.

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po. Për sa më  
7 takon mua pjesët në fillim janë irelev -- nuk janë relevante  
8 dhe nuk duhet të -- dhe duken si të fabrikuara, por pjesa  
9 tjetër është relevante dhe ne do ta pranojmë si provë.

10 Z. ELLIS: [Përkthim] Faleminderit, i nderuar Gjykatës. Me  
11 kaq përfundoj pyetjet e mia.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Duhet t'i  
13 japim një numër dëshmie këtij dokumenti.

14 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Dokumenti DJK00798 dhe  
15 përkthimi në anglisht merr numrin 4D00063, klasifikohet si  
16 publik.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ndonjë pyetje  
18 nga ana e Prokurorisë?

19 Z. CAPIN: [Përkthim] Kam një pyetje.

20 Pyetje vijuese nga z. Capin:

21 Z. CAPIN: [Përkthim]

22 PY. Mirëdita, z. Dëshmitar.

23 Avokati i z. Thaçi dhe z. Veseli të dy ju bënë pyetje për  
24 kohën e dy takimeve në korrik të 1998-s, takime që keni bërë  
25 me udhëheqjen e UÇK-së, a ju kujtohen këto pyetje?

1 PË. Më kujtohen.

2 PY. Dhe mes pyetjeve që z. Emmerson ju bëri, lidhur me  
3 korrigjimet që ju keni bërë kur jemi takuar bashkë, korrigjime  
4 të bëra në dëshminë që keni dhënë në çështjen Limaj përpara  
5 TPNJ-së, ju kujtohen këto pyetje?

6 PË. Po.

7 PY. Do doja t'ju bëj disa pyetje që të jemi të qartë dhe  
8 mendoj që fillojmë me pjesën e asaj që ju doni të korrigjonit  
9 në çështjen Limaj.

10 Z. CAPIN: [Përkthim] Znj. Sekretare, në qoftë se mund të  
11 shfaqim në ekran dokumentin, dëshminë P01209.

12 PY. Ajo që do shihni është një pjesë e dëshmisë që keni dhënë  
13 në çështjen Limaj.

14 Z. CAPIN: [Përkthim] Kalojmë në faqen 669. Znj.  
15 Sekretare, në qoftë se mund të përqendrohemi tek faqet 16, 18.

16 PY. Kur thoni, z. Kickert "... kur mbaruam, përfunduam dje me  
17 takimin, lidhur me takimin, mbi çështjen e takimit të parë me  
18 UÇK-në, në fund të korrik, mendoj që ju thatë në 1998, kur  
19 ishte hera tjetër pastaj që u takuat me pjesëtarë të UCK-së?".

20 Dhe përgjigja juaj është:

21 "Besoj që po, të nesërmen".

22 Çfarë u përpoqët që të korrigjonit?

23 Z. MISETIC: [Përkthim] Kundërshtim. Është pyetje  
24 sugjestive. Duhet ta pyesni atë çfarë po përpiqej të  
25 korrigjonte.

1 Z. CAPIN: [Përkthim] Çfarë po përpiqeshit të korrigjonit?  
2 PË. Po përpiqesha të korrigjoja datat e takimeve që më ishin  
3 treguar përmes dokumenteve në të cilët thuhej qartësisht se  
4 takimi të cilin gabimisht kisha menduar se kishte ndodhur po  
5 të nesërmen e takimit të Sekretarit të Përgjithshëm dhe  
6 numrin, mes Sekretarit të Përgjithshëm dhe Numrit 7, në fakt  
7 kishte ndodhur më vonë. Pra, mendoj që ajo që doja të thoja në  
8 dëshminë time bazuar në dokumente duhet të jetë që kam thënë  
9 në dokumente është më e besueshme sesa dëshmia e bazuar vetëm  
10 në kujtesën time.

11 Z. CAPIN: [Përkthim] Në qoftë se mund të shohim  
12 dokumentin, të njëjtën provë. Znj. Sekretare, faqe 749. Të  
13 shohim në krye të faqes, rreshti 17 ju lutem.

14 PY. Dhe ju shihni aty që ju jeni pyetur për tre takimet, atë  
15 të datës 22, 23, 30 dhe më vonë në rreshtin 13 pyetja është:

16 "Takimi i dytë është bërë më datën 23 që është të  
17 nesërmen, pas takimit, të nesërmen e takimit me z. Thaçi dhe  
18 z. Veseli".

19 A kishte diçka aty që donit të korrigjonit?

20 PË. Po. Më është treguar në atë kohë bashkë me raportet dhe  
21 ishte e qartë për duke u bazuar në raportin tim që isha takuar  
22 me Numrin 3 dhe Numrin 7 me datën 23. Dhe u përpoqa të  
23 rivërtetoj atë, sepse isha memor -- kujtesën e ngatërruar  
24 lidhur me se takimi -- që cili takim ishte pra. Takimi me 3  
25 dhe 7 kishte ndodhur pas takimit të Sekretarit të Përgjithshëm

1 me Numrin 7. Por në vend të takimit -- takimi ishte ndodhur,  
2 pra, pas takimit të Sekretarit të Përgjithshëm Rohan ishte me  
3 datën 30 takimi me z. Krasniqi dhe ishte ky takimi që kisha  
4 patur, që kisha në mendje. Kjo ka ndodhur me datën 29 kur kemi  
5 bërë trojkën, kishim trojkën aty, drejtorët politikë të  
6 Kombeve -- të Mbretërisë së Bashkuar, Gjermanisë dhe  
7 Sekretarin e Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme  
8 të Austrisë i cili nuk pati mundësi të takohej me  
9 përfaqësuesit e UÇK-së.

10 PY. Që të jem i qartë, takimi i dytë me udhëheqjen e UÇK-së,  
11 ai me Numrin 3 dhe Numrin 7 nuk është bërë menjëherë të  
12 nesërmen e takimit të parë, a është kështu?

13 PË. Saktë.

14 PY. Dhe a u përpoqët që të bënit të njëjtin korrigjim, në  
15 fakt të bënit të njëjtin korrigjim në deklaratën e ZPS-së dhe  
16 përpara se të përgjigjeni --

17 Z. CAPIN: [Përkthim] Do t'ju tregoj juve me ndihmën e  
18 znj. Sekretare provën P01210 në paragrafin 20. ERN është faqja  
19 075998. Në qoftë se mund të shohim më poshtë dhe të  
20 përqendrohemi tek paragrafi 20.

21 PY. E shikoni paragrafin 20 të deklaratës suaj dhënë ZPS-së?

22 PË. Po. Kjo është ajo që po përpiqesha që të sqaroj. Kur m'u  
23 tregua raporti i Ekipit Monitorues kuptova se kisha gabuar se  
24 takimi mes Sekretarit të Përgjithshëm Rohan dhe Numrit 7 nuk  
25 kishte ndodhur më 27 korrik, por me ose përpara datës 10

1 korrik sipas, bazuar në raportin e Ekipit Monitorues.  
2 PY. Në rreshtin e dytë të paragrafit 20 ju thoni që pas,  
3 mendoni që keni gabuar dhe që, "Pasi ju është treguar raporti  
4 i datës 10 korrik të Ekipit Monitorues ku përshkruhet ky  
5 takim, mendoni që ky takim në fakt ka ndodhur rreth datës 10  
6 korrik 1998".

7 A është kjo që po i referoheshit dje kur përmendët këtë?  
8 PË. Po.

9 PY. Pra, a është korrigjimi i vetëm që deshe t'i bënit; ishte  
10 data, takimi me z. Kadri Veseli dhe Gani Veseli [Sipas  
11 përkthimit]. Data, pra, e takimit të parë me -- data e takimit  
12 të parë që patët ju në korrik me UÇK-në?

13 PË. Po.

14 Z. CAPIN: [Përkthim] Në qoftë se mund të shohim tani  
15 dëshminë P01222 që është e redaktuar në Shënimin Përgatitor 1,  
16 paragrafi 5. Paragrafi 5, ju lutem. Faleminderit.

17 PY. E shihni që kur lexojmë tekstin thotë:

18 "...takimi me Hashim Thaçin dhe Kadri Veselin të cilit i  
19 referohemi ka ndodhur me ose rreth datës 9, 10 korrik dhe jo  
20 më 22".

21 Në qoftë se e heqim Hashim Thaçin nga ky tekst, a do të  
22 ishte e saktë përmbajtja, pjesa tjetër e përmbajtjes?

23 PË. Po.

24 PY. Dhe a është ky korrigjimi që kishit në mend të bënit?

25 PË. Po.



1 PY. Kur trajtuam këtë temë dje, z. Emmerson ju pyeti dhe kjo  
2 është në transkript në faqen 16210, fillon në rreshtin 17.

3 Pyetja ishte:

4 "... çfarë ju kujtohet juve?".

5 Dhe ju u përpoqët të shpjegonit atë që thatë lidhur me  
6 atë që keni thënë në çështjen Limaj dhe ju thatë që e keni  
7 marrë, kuptuar këtë përmes dokumenteve që kjo ishte zgjidhur.  
8 A i referohet kështu këtu në këtë rast raportit të Ekipit  
9 Vëzhgues me të datës 10 korrik dhe raportit tuaj që ishte bërë  
10 më vonë po në atë muaj?

11 PË. Po. Kemi dy raporte: Njëri është i datës 10 korrik nga  
12 Ekipi Monitorues dhe raporti im. Mendoj që ka qenë i datës 23  
13 korrik. Pra, 24 korrik, faleminderit. Rreth -- takimit të  
14 datës, lidhur me takimin e datës 23 korrik, por i shkruar me  
15 datën 24.

16 Mendova që kjo ishte e zgjidhur tani sepse kishim dy  
17 dokumente, dy raporte të cilët qartësisht, në të cilët  
18 qartësisht thuhet se këto dy takime janë zhvilluar.

19 PY. Që të sigurohemi që procesverbali është absolutisht i  
20 qartë do të shohim edhe një çast dy këto, edhe një herë këto  
21 dy dokumente.

22 Z. CAPIN: [Përkthim] Në qoftë se mund ta shfaqim tani në  
23 ekran dëshminë P0126. Kërkoj ndjesë, ndoshta kam dhënë  
24 referencën e gabuar. Ky është raport i Ekipit Monitorues të  
25 BE-së me ERN -- Kërkoj ndjesë, të nderuar Gjykatës.

1 Znj. Sekretare a ishte, ndoshta e thashë gabim. Është

2 P01216, më duket që harrova një l-sh. Ky është, ky është.

3 PY. Nuk do lexojmë gjithë dokumentin, por dokumenti është

4 raport i Ekipit Monitorues i datës 10 korrik?

5 PË. Po.

6 PY. Shoq që përmendet Sekretari i Përgjithshëm Albert Rohan.

7 A është ky dokument për takimin ku ju ishit bashkë me

8 Sekretarin e Përgjithshëm Rohan për t'u takuar me Numrin 7?

9 PË. Po.

10 PY. Dhe ky ishte takimi juaj i parë me UÇK-në në korrik të

11 '98-s?

12 PË. Po.

13 PY. Dje z. Emmerson ju pyeti juve, dhe kjo është në

14 transkript 16211, fillon në rreshtin 15, ai thotë:

15 "Ndodh ndonjëherë që ka gabime shtypi apo të datave që

16 futen ngelin në dokumente".

17 Vetëm kam nja dy pyetje përfundimtare lidhur me raportin

18 e Ekipit Monitorues të BE-së dhe raportin tjetër për të parë

19 nëse ka ndonjë tregues që gabime të tilla mund të kenë

20 ndodhur.

21 Pra, në qoftë se nuk e kam gabim ky është i datës 10

22 korrik 1998; raporti ditor i aktivitetit -- raporti ditor nga

23 organi, pra, ekipi, entiteti që u identifikua në titull.

24 PË. Po.

25 Z. CAPIN: [Përkthim] Në qoftë se mund të kalojmë në faqen

1 3 tani, në mes të faqes.

2 PY. Është një dokument trefaqësh, gjysma e së cilit përmban  
3 raporte të mediave që fillojnë në faqen 2 dhe deri në fund të  
4 dokumentit. Në qoftë se mund të shohim secilin prej tyre. Në  
5 qoftë se s'ka kundërshtim do të them që secili prej këtyre  
6 raporteve të mediave i referohet ose 10 korrikut ose 9  
7 korrikut.

8 Z. EMMERSON: [Përkthim] Kemi një kundërshtim. Nuk ka  
9 kundërshtim sa i takon takimit të parë që është mbajtur më 10  
10 korrik. Kjo nuk është -- kjo nuk kundërshtohet.

11 Z. CAPIN: [Përkthim]

12 PY. Pra, pyetja është, zotëri, duke vërejtur se secili,  
13 secila prej këtyre referencave të medias, i referohet ose  
14 takimit të datës 10 ose datës 10 ose datës 9 korrik, sipas  
15 përvojës tuaj me raporte të tilla ditore, a i referohen ato  
16 informacionit të mediave; a kanë tendencë t'i referohen  
17 mediave në lajmet apo për apo rreth ditës së raportit?

18 PË. Po, sepse këto janë raporte ditore.

19 PY. Dhe në fakt këto raporte, aludimi, pra, referencat ndaj  
20 mediave është për datën 9 apo 10 korrik që është i datës 9 apo  
21 10 korrik, se le të mendoj se ka një gabim në datën e këtij  
22 raporti, apo jo?

23 PË. Kështu e mendoj.

24 PY. Dhe tani po shohim raportin tuaj, zotëri.

25 Z. CAPIN: [Përkthim] Znj. Sekretare, në qoftë se mund të

1 shfaqim në ekran P01217-ET.

2 PY. Pra, konstatoj që raporti është i datës 24 korrik 1998.

3 Dhe ju e keni shkruar këtë raport, saktë?

4 PË. Saktë.

5 PY. Dhe në qoftë se mund të shohim pak më poshtë nën titullin

6 "Qeveria e bashkimit kombëtar apo tavolina, tryeza e

7 rrumbullakët", thuhet:

8 "Ambasada raporton se është takuar me përfaqësues të

9 lartë të UÇK-së, Numrin 3 dhe 7..."

10 Dhe jep datën 23 korrik.

11 Ajo që ju raportoni -- a ishit ju që raportoni për

12 takimin me Numrin 7 dhe 3 që ndodhi një ditë më parë?

13 PË. Po. Raporti ka qenë siç e korigjoi -- ma korigjoi z.

14 Emmerson. Raporti ishte shkruar më datën 24 korrik dhe

15 paragrafi i parë ka të bëjë me takimin me Numrin 3 dhe 7 me

16 datën 23 në Malishevë.

17 PY. Dhe nuk ka dyshim në mendjen tuaj që data e këtij raporti

18 është e saktë.

19 PË. Padyshim.

20 PY. Paragrafi që fillon "Sipas Shalës..." thotë që:

21 "... është në Prishtinë sot..."

22 Dhe është me datë "24 korrik", apo jo?

23 Dhe aty thotë që e konfirmojmë që raporti është shkruar

24 atë ditë?

25 PË. Po, sepse jam takuar me z. Shala me datë 23 në mbrëmje,

1 dhe pastaj pasi u kthyem në Beograd më ka thënë që do të  
2 shkonte në terren ditën e nesërme. Kështu që data është 24.

3 Z. CAPIN: [Përkthim] Faleminderit. Nuk kam pyetje të  
4 tjera.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.  
6 Gjykatësi Barthe, fjala për ju.

7 Pyetje nga Trupi Gjykses:

8 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit, Gjykatësi  
9 Smith.

10 PY. Mirëdita, Dëshmitar. Shpresoj që të më dëgjoni mirë.

11 PË. Po, ju dëgjoj mirë.

12 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Trupi Gjykses ka disa pyetje  
13 të tjera shtesë që ne besojmë që janë të rëndësishme për ne  
14 për të kuptuar plotësisht se çfarë ka ndodhur në Kosovë në  
15 1998 dhe 1999. Për këtë arsye dëshirojmë që të kalojmë disa  
16 pjesë të intervistës që i keni dhënë ZPS-së në janar 2020.

17 Pyetjet e mia të para kanë të bëjnë me paragrafin 11 dhe  
18 12 ku keni folur për një takim me Adem Demaçin që sipas  
19 paragrafit 11 ka ndodhur më 6 korrik 1998. A ju kujtohet se e  
20 keni diskutuar këtë takim me ZPS-në në janar të vitit 2020,  
21 Dëshmitar?

22 PË. Po, ka edhe, kam edhe një raport timin, domethënë,  
23 ekziston një raport i imi që pasqyron këtë takim.

24 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit. Në paragrafin  
25 12 në deklaratën e ZPS-së thoni që z. Demaçi ka thënë

1 shprehimisht dhe këtu citoj që, "Ai nuk ishte përfaqësues  
2 politik i UÇK-së dhe për pasojë ishte e qartë që ai nuk ishte  
3 bashkëbiseduesi politik për të cilin ju po kërkonit ose që  
4 dëshironit të gjenit, sepse ai nuk ishte përfaqësues i UÇK-  
5 së".

6 Pyetja ime për ju, Dëshmitar, është kjo: Z. Demaçi, a jua  
7 tha, a ja u tregoi juve që kush ishte përfaqësuesi politik i  
8 UÇK-së në ato kohë dhe/ose me kë duhet të flisnit juve?  
9 PË. Jo, nuk na tha gjë lidhur me këtë.

10 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Pyetja e radhës ka të bëjë  
11 me takimin që keni pasur me z. Thaçi dhe z. Veseli në  
12 Malishevë në korrik të 1998 që trajtohet në paragrafin 22 dhe  
13 paragrafët pasues të intervistës që i keni thënë ZPS-së. Në  
14 veçanti jam i interesuar të di diçka lidhur me informacionin  
15 që keni dhënë në paragrafët 26 dhe 27 që shkruan si më poshtë,  
16 dhe këtu citoj në paragrafin 26:

17 "Gjatë takimit të parë përmenda Konventën e Gjenevës,  
18 detyrimet që rrjedhin nga Konventa e Gjenevës sepse kishte  
19 pasur disa pretendime, kryesisht nga shtypi serb për UÇK-në që  
20 kishte marrë të burgosur ose rob. Në fakt jam takuar me  
21 kolegët e Komitetit Ndërkombëtar të Kryqit të Kuq ('ICRC') në  
22 Malishevë, të cilët po përpiqeshin që të krijonin  
23 bashkëbisedime dhe të kishin homologë me të cilët të flisnin  
24 në UÇK për të ngritur çështje të drejtës humanitare  
25 ndërkombëtare dhe për të ngritur gjithashtu edhe çështje që

1 kishin të bënin me qasjen tek të ndaluarit”.

2 Ndërkohë në paragrafin 27 ju thoni si më poshtë:

3 “Nuk më kujtohet konkretisht se çfarë i kam thënë Thaçit,  
4 por do kem ngritur besoj pretendime konkrete lidhur me krime  
5 të veçanta se nuk kam pasur dëshmi dhe nuk e besoja  
6 propagandën nga asnjëherë nga anët ose palët. Megjithatë besoj  
7 që do të kem ngritur çështje të tilla që qarkullonin sa i  
8 takon, për shembull, pretendimeve për ndalimeve dhe rrëmbimeve  
9 edhe qasjes së nga Kryqi i Kuq Ndërkombëtar të vendeve të  
10 tilla. Kur i ngrita këto çështje me UÇK-në ata e dinin se për  
11 çfarë e kisha fjalën unë dhe ata megjithatë nuk është se i  
12 kanë trajtuar asnjëherë këto pretendime vetë”.

13 Atëherë, së pari, a kam të drejtë të prezumoj unë që e  
14 keni fjalën për z. Thaçi dhe z. Veseli kur thua që “ata e  
15 dinin se për çfarë po flisnim ne”, pavarësisht se nuk i kishin  
16 trajtuar asnjëherë këto pretendime ose këto akuza vetë.

17 PË. Kjo është një koment më i përgjithshëm. Nuk e di se çfarë  
18 përgjigje më është dhënë konkretisht në këtë takim, por kjo ka  
19 qenë e përgjithshme ose në terma të përgjithshëm, në fjalë të  
20 përgjithshme kjo ka qenë përgjigja. Domethënë ne jemi ushtri  
21 dhe sigurisht ne respektojmë Konventat e Gjenevës.

22 Megjithatë, nuk më kujtohet që z. Thaçi apo dikush tjetër  
23 të më ketë thënë konkretisht apo të ketë përmendur këtë gjë  
24 konkretisht siç është reflektuar këtu në deklaratën e ZPS-së.

25 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Pse bërë këtë konstatim të

1 përgjithshëm; pse i bëtë këto komente të përgjithshme apo pse  
2 menduat që UÇK-ja ishte në dijeni ose që dinin lidhur me  
3 pretendimet e ndalimeve dhe rrëmbimeve nga UÇK-ja, për shkak  
4 të faktit që ishin të raportuara gjerësisht?

5 PË. Sikurse e thashë, kishte anëtarë të KNKK-së në terren dhe  
6 të njëjtën ditë në Malishevë ne u hasëm me ta. Kështu që ata u  
7 munduan që të krijonin kontakte më pas me UÇK-në në mënyrë të  
8 tillë që -- tani nuk mendoj, domethënë, që kjo do ishte habi  
9 ose do të ishte befasuese për ta, sepse kjo ishte çështje që  
10 ishte diskutuar nga ata më parë.

11 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Këta persona nga KNKK-ja, a  
12 të kanë treguar ty që janë përpjekur që të vendosin kontakte  
13 apo janë përpjek -- apo i kanë vënë këto kontakte?

14 PË. Jo, konkretisht më thanë që janë përpjekur të vënë  
15 kontakte me UÇK-në.

16 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Por ju konkretisht nuk e  
17 dini në qoftë se këto kontakte janë vënë apo jo?

18 PË. Jo, nuk jam në dijeni se ky nuk ishte interesi im  
19 kryesor. Jemi takuar në një restorant në një mbrëmje,  
20 megjithatë nuk e mbaj mend të jetë cekur apo të jetë trajtuar  
21 kjo pikë në mbrëmje.

22 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Në intervistën e ZPS-së ju  
23 thoni, në paragrafin 26 të raportit që kishte pretendime për  
24 robërit e luftës të marrë nga UÇK-ja. Megjithatë, këto ishin  
25 kryesisht pretendime të cilat ngriheshin nga shtypi serb, apo



1 jo?

2 PË. Po, por gjithashtu kam thënë që kishte shumë propaganda  
3 që qarkullonte, nga të dyja anët, me qenë i singertë dhe  
4 kishte ekzagjerime, sepse ishte e vështirë që të manovrohej  
5 dhe ishte e vështirë që të mbështeteshin pretendime me fakte.  
6 Dhe prandaj kjo ishte arsyeja kryesore se pse ne donim që  
7 monitoruesit të ishin të pranishëm në terren.

8 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] A e dini që ka pasur  
9 pretendime edhe nga media shqiptare sa i takon ndalimeve dhe  
10 rrëmbimeve nga UÇK-ja në atë kohë? Dikur nga vera e '98-s.

11 PË. Mbase më pak, në qoftë se ka pasur.

12 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Po në paragrafin 15 të  
13 Shënimit Përgatitor numër 2, ju përqendrohni tek Serbia, apo  
14 jo? Domethënë tek shtypi serb, apo jo?

15 PË. Portofoli im në ambasadën në Beograd ka qenë pak i  
16 çuditshëm, sepse unë merresha me median, kulturën dhe me  
17 aspektin politik në Kosovë.

18 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Por ju thatë që nuk flisnit  
19 shqip, apo jo?

20 PË. As nuk flas, as nuk kuptoj shqip, por flas pak serbisht.

21 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Po i takon që është e drejtë  
22 që të thuhet që ju nuk keni pas mundësi, nuk mund të lexonit  
23 dot artikuj gazetash a në shqip, apo jo?

24 PË. Jo. Por bëhej një përmbledhje e artikujve të gazetave që  
25 ju dërgohej ambasadave edhe prandaj kjo është një prej arsyeve

1 që thashë që kishte propagandë edhe nga ana ose nga pala  
2 shqiptare. Sepse ekzistonin pretendime që në Kosovën  
3 Perëndimore zona duket si Vukovari. Dhe për këtë e kam  
4 pasqyruar këtu edhe në raportin tim edhe domethënë që ne morëm  
5 pjesë në këtë vizitën diplomatike që të organizuar nga  
6 Beogradi dhe qëllimi kryesor ishte që t'i shikoje zhvillimet  
7 me sytë e mi. Dhe pavarësisht kësaj konstatimi ishte i njëjtë  
8 që gjërat ishin shumë të ekzagjeruara.

9 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Në paragrafin 27 të  
10 deklaratës së ZPS-së dhe kam përshtypjen që këtu e kishit  
11 fjalën për z. Thaçi dhe z. Veseli, sepse ata ishin dy  
12 bashkëbiseduesit tuaj. Që ata nuk i kanë trajtuar asnjëherë  
13 pretendimet vetë gjatë bisedave që keni pas me të. Këtë keni  
14 dash të thoni, apo jo?

15 PË. Nuk më kujtohet.

16 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] A të ka thënë ndonjëri prej  
17 tyre ose z. Thaçi ose z. Veseli e se së pari duhej që të  
18 merrnin informacion për të konstatuar në qoftë se këto  
19 pretendime ishin të vërteta apo jo?

20 PË. Nuk më kujtohet të më jetë thënë një gjë e tillë.

21 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Në paragrafin 40 të  
22 deklaratës për ZPS-në keni thënë se e keni shprehur në  
23 dëshminë e dhënë në gjykimin kundër Gjeorgjeviqit dhe këtu po  
24 citoj nga paragrafi 40 i intervistës që i keni dhënë ZPS-së  
25 apo raporte që keni shkruar që,

1            "... ekzistonte informacion i përgjithshëm sa i takon  
2 pretendimeve të rrëmbimeve të civilëve serbë; kishte  
3 gjithashtu edhe pretendime që lexoheshin rëndomtë në media për  
4 sa i takon kampeve të ndalimit që kishte UÇK-ja".

5            A e mbështetni këtë dëshmi prapë? A keni të njëjtin  
6 qëndrim edhe sot?

7 PË. Nuk është se kam dëshmi, nuk është se kam prova, por  
8 thjesht këto ishin informacione që vinin nga media. Për  
9 shembull, në deklaratën që i kam dhënë ZPS-së më janë bërë  
10 pyetje për gazetarë të cilët janë marrë nën ruajtje për një  
11 periudhë të caktuar, për një periudhë të shkurtër, pastaj  
12 liroheshin. Dhe këto janë ngjarje të cilat raportoheshin  
13 rëndomë se zakonisht në shtypin serb. Kishte gjithashtu edhe  
14 buletine në anglisht të shtypit serb që përfshinin pjesërisht  
15 edhe disa ngjarje në Kosovë.

16            GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] T'i kthehemi përsëri  
17 paragrafit 27.

18            Fjalja tjetër në paragrafin 27 ka këtë përmbajtje dhe  
19 këtu citoj:

20            "Në përgjigje z. Thaçi theksoi që UÇK-ja do ta respektojë  
21 Konventën e Gjenevës, sepse UÇK-ja ishte ushtri e rregullt".

22            Pyetje për ju është kjo: Gjatë kësaj bisedë apo edhe më  
23 vonë, a keni pasur në fakt ju ndonjë dyshim që UÇK-ja ishte në  
24 gjendje që të respektonte detyrimet e Konventave të Gjenevës  
25 siç kishte thënë z. Thaçi?

1 PË. Unë nuk isha i bindur vetë që UÇK-ja të kishte një  
2 strukturë të tillë që një person të mund të kontrollonte të  
3 gjithë strukturën ose gjithë UÇK-në, të gjithë organizatën.

4 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] A ia thatë këtë gjë z. Thaçi  
5 apo z. Veseli gjatë bisedës që patët me të në korrik të '98-s?

6 PË. Që kisha dyshime për qëndrimin e tyre? Jo, jo se nuk  
7 mund, nuk mund të cenoja dot pozicionin tim; nuk ua thoja dot  
8 këtë gjë.

9 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] E kuptoj.

10 Po z. Thaçi apo z. Veseli a të kanë thënë ty që UÇK-ja do  
11 të respektonte Konventat e Gjenevës në qoftë se do të lejohej  
12 një gjë e tillë nga rrethanat ose nga situata e luftës? A u bë  
13 ndonjë konstatim i tillë prej ndonjërit prej tyre gjatë  
14 bisedave të patët me të?

15 PË. Nuk më kujtohet ndonjë sqarim i tillë.

16 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Në fjalinë e fundit të  
17 paragrafit 27 thuhet që "...ju gjithashtu keni komunikuar  
18 ndjesinë e përgjithshme që UÇK-ja do t'i bënte nder kauzës së  
19 vet në qoftë se do merrte masa, sepse në të kundërtën në qoftë  
20 se do të bënte të njëjtat sjellje si Serbia nuk do të kishte  
21 ndonjë vlerë shumë të madhe".

22 A ka thënë ndonjë gjë z. Thaçi apo z. Veseli në përgjigje  
23 të kësaj gjëje?

24 PË. Nuk më kujtohet.

25 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Z. Kickert, pyetjet e mia të

1 radhës kanë të bëjnë me paragrafin 28, fjalia e parë. Në

2 fjalinë e parë thuhet:

3 "Në fund të këtij takimi ne besuam që kishim gjetur një  
4 bashkëbisedues të lartë të UÇK-së dhe ky person ishte z. Thaçi  
5 dhe se përmes tij ne mund të fillonim procesin e integritit të  
6 UÇK-së në procesin politik".

7 Në këtë kontekst dua t'ju pyes sa më poshtë: Z. Thaçi apo  
8 z. Veseli a të kanë thënë deri nga fundi i takimit ose gjatë  
9 takimit që ata duhet që të konsultoheshin me dikë përpara sesa  
10 të përfshiheshin në diskutime ose në negociata të mëtejshme me  
11 ju?

12 PË. Jo, por kishte një gatishmëri, një vullnet të  
13 përgjithshëm për të përfshirë në procesin politik. Nuk kishim  
14 mbërritur akoma në fazën që të krijojmë një platformë të të  
15 gjithë faktorëve shqiptarë të Kosovës.

16 Megjithatë kontakti i parë ishte për të parë nëse UÇK-ja  
17 dëshironte thjesht të luftonte apo nëse ajo ishte e gatshme që  
18 të përfshihej edhe në procese politike dhe ishte puna ime si  
19 dhe puna e diplomatëve të tjerë që të mund t'i përfshinim ata  
20 në procesin politik në mënyrë të tillë që konflikti të mos  
21 përkeqësohej akoma më tepër.

22 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] E kuptoj, por nuk është se  
23 të thanë asnjëri prej tyre që duhej të konsultoheshin me  
24 ndokënd lidhur me këtë qëndrim, apo jo?

25 PË. Jo. Ata më thanë që UÇK-ja ishte e gatshme që të

1 përfshihej në këtë proces politik, por formulimi ishte i  
2 përgjithshëm, me fjalë të përgjithshme. Pra, nuk është se ju  
3 tha që a duhet të shkojmë ose të jemi së bashkë në këtë proces  
4 me LDK-në apo me persona të tjerë, me këtë me atë? Jo. Këto  
5 janë diskutime të cilat kanë ndodhur më pas.

6 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Pyetja është: A të thanë ata  
7 që duhet të konsultoheshin me ndonjë strukturë tjetër përpara  
8 sesa të merrnin ndonjë vend, për shembull, në qoftë se do ju  
9 lejonin qasje KNKK-së në vendndalimet, a duhet të  
10 konsultoheshin me dikë tjetër, a ta kanë thënë diçka të tillë,  
11 Dëshmitar?

12 PË. Nuk më kujtohet diçka e tillë.

13 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Në paragrafin 30 të  
14 deklaratës së ZPS-së ju thoni:

15 "Si pjesë e procesit të negociatave, Shtetet e Bashkuara  
16 kanë qenë në kontakt me figura të tjera në UÇK-në përveç z.  
17 Thaçi. Në veçanti me Rustem Mustafën që njihej si komandant  
18 Remi, që ishte komandanti në zonën e Llapit ku ne nuk shkonim  
19 si diplomatë".

20 Pyetja që kam për ju, Dëshmitar, është si më poshtë: Pse  
21 nuk shkonit si diplomatë ju në zonën e Llapit? Çfarë ju  
22 ndalonte ju që të shkonit në zonën e Llapit?

23 PË. Si diplomatë ne ishim të interesuar për bashkëbisedues  
24 politikë, ndërkohë që Remi për neve nuk konsiderohej si i  
25 tillë. Pra, nuk ishte bashkëbisedues politik.

1 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Domethënë, në qoftë se ju  
2 donit, faktikisht ju mund të shkonit në zonën e Llapit. Nuk  
3 është se ju ndalonte njeri që të shkonit në zonën e Llapit,  
4 por thjesht mendonit se nuk kishte ndonjë vlerë për ju që të  
5 shkonit atje?

6 PË. Jo, nuk i shërbente kauzës sonë, sa i takon lirisë së  
7 lëvizjes, kjo varej nga dita. Megjithatë, unë vetë nuk jam  
8 përpjekur asnjëherë që të takohem me z. Remi, sepse nuk i  
9 shërbente qëllimit ose objektivave të mia të takimeve.

10 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] E kuptoj. Kam një pyetje  
11 tjetër që ka të bëjë me fjalinë e fundit të paragrafit të 30.  
12 Në të thuhet:

13 "Në vigjilje të përgatitjes së konferencës së paqes në  
14 Rambuje, amerikanët gjithashtu mbërritën në përfundimin e  
15 njohjes së z. Thaçi si bashkëbiseduesi politik i UÇK-së."

16 Pyetja ime është kjo: Pse e njohën amerikanët z. Thaçi si  
17 bashkëbiseduesin kryesor politik? Sepse ai ishte person i  
18 besuar apo dukej që kishte ndikim më të madhe sesa të tjerët  
19 apo sepse nuk mund të konsiderohej ose nuk mund të  
20 identifikohet një person tjetër më i lartë në një hierarki ose  
21 në procesin politik sesa z. Thaçi?

22 PË. Pse thashë unë që mbërritëm në përfundimin amerikanët që  
23 z. Thaçi ishte person që mund të konstatohej si përfaqësues  
24 politik. Këtë e thashë sepse në mes të verës kishte përpjekje  
25 nga amerikanët, siç e diskutuam edhe më herët, që të bëhej një

1 lloj marrëveshje me LDK-në që të lihej UÇK-ja mënjanë; kishte  
2 pak mosmarrëveshje me ne lidhur me këtë, në veçanti me mua  
3 personalisht, sepse ne nuk besonim që kjo ishte një qasje e  
4 qëndrueshme; nuk besonim që kjo mund të zgjaste në kohë.

5 Megjithatë, si pasojë e kësaj gjëje ose e kësaj  
6 përpjekje, u kontaktuan me bashkëbisedues të ndryshëm të UÇK-  
7 së të cilët më pas besoj që u pajtuan me faktin që personi që  
8 duhej që të përfshihej në procesin politik më pas ishte z.  
9 Thaçi.

10 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit.

11 Tani dëshiroj që të kalojmë te paragrafi 50 në paragrafët  
12 vijues të intervistës së ZPS-së ku ju flisni për takime të  
13 ndryshme që keni pasur me z. Thaçi në vjeshtë të 1999-s [Sipas  
14 përkthimit]. Ju thoni, dhe këtu i referohem fjalisë së fundit  
15 të paragrafit 51 në këto takime. Ju thoni:

16 "Në këto takime z. Thaçi dhe z. Limaj bënin kërkesa të  
17 zakonshme, si për shembull, ndalimi i sulmeve, heqja dorë nga  
18 pikat e kontrollit të serbëve dhe tërheqja e policisë serbe  
19 apo kthimi i personave të zhvendosur."

20 Pyetja që kam për ju është kjo: A ka ofruar ndonjë gjë z.  
21 Thaçi në emër të UÇK-së dhe në qoftë se po, çfarë ka ofruar?  
22 PË. Biseda jonë ishte që ne donim që të mbërrinim në një pikë  
23 ku do kishte armëpushim ku luftimet ndalohen, do të ndalonin,  
24 sepse ata që vuanin më tepër ishin popullata civile. Kjo ishte  
25 diçka që ishte në interes të UÇK-së. Dhe ata do ta çonin



1 përpara procesin politik. Megjithatë, nuk ishte kokë për kokë,  
2 domethënë në kuptimin që duhet të bëni këtë, ne duhet të bëjmë  
3 atë, por pak a shumë këto ishin, si me thënë, direktivat e  
4 përgjithshme. Për shembull, tani më kujtohet që në takimin me  
5 Jakup Krasniqin na u tha që ata ishin të gatshëm që të  
6 ndaloheshin veprimet e ofensivës në qoftë se do të  
7 përmbusheshin kushtet të caktuara. Megjithatë, mendoj që ishin  
8 në interes të përgjithshëm të UÇK-së, që forcat e sigurisë nga  
9 Beogradi si dhe ushtria jugosllave ashtu edhe policia speciale  
10 apo njësitet e policisë të ndërprisnin operacionet e tyre dhe  
11 ofensivën e tyre.

12 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Gjatë këtyre takimeve në  
13 vjeshtën e 1998-s me z. Thaçi dhe z. Limaj nuk është se është  
14 bërë ndonjë lloj oferte e tillë, në qoftë se ju kujtohet?

15 PË. Për çfarë oferte e keni fjalën?

16 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Për të ndaluar luftimet ose  
17 sulmet.

18 PË. Ky ishte arsyeja kryesore, domethënë që luftimet ndaluan  
19 dhe atëherë ne u përshimë në procesin politik. Një instrument  
20 i bashkësisë ndërkombëtare, sikurse e diskutuam edhe dje,  
21 ishte që të dërgohej në terren, në Kosovë një Mision  
22 Verifikimi i OSBE-së në mënyrë të tillë që të kishte një prani  
23 më të madhe të ndërkombëtarëve, në mënyrë të tillë që luftimet  
24 të ndalonin nga të dyja palët.

25 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit.

1 Në paragrafin 53 dhe në paragrafët pasues të intervistës  
2 që i keni dhënë ZPS-së, keni folur për pjesëmarrjen tuaj në  
3 negociatat e të ndaluarve. Dhe keni përmendur gjithashtu si  
4 pjesë e intervistës, që jeni takuar me z. Krasniqi dhe dy  
5 persona të tjerë të Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së, Sokol  
6 Bashotën dhe Ramë Bujën. Kjo jepet në paragrafin 54 në  
7 procesverbalin e deklaratës që i keni dhënë ZPS-së.

8 Pyetja ime e parë është kjo: Si e dinit ju, nga e dinit  
9 që z. Bashota dhe z. Buja ishin anëtarë të Shtabit të  
10 Përgjithshëm të UÇK-së? A jua thanë ju këtë gjë këta dy  
11 personat atëherë?

12 PË. Kjo ishte hamendësimi im.

13 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Ishte hamendësimi jot?

14 PË. Po.

15 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Po nga mbërritët në këtë  
16 hamendësim ose në këtë përfundim ju?

17 PË. Ndoshta nga kontaktet me gazetarët, sepse kishte shumë  
18 biseda; kishte shumë marrje informacioni në këtë mënyrë, pra,  
19 merrnim shumë informacion nga media.

20 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Megjithatë, a ishte e qartë  
21 për ju që këta dy persona që unë përmenda më përpara, përveç  
22 z. Krasniqi, ishin pjesë e Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së?

23 PË. Supozimi ose prezumimi ishte aty, sepse në qoftë se ti  
24 flisje për lirimin e të ndaluarve sigurisht, domethënë, që  
25 personat duhet të kishin një rol. Nuk mund të flisje dot me

1 dokëdo.

2 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] A e dini që në 1998 ose  
3 ndoshta në 1999 më vonë kush tjetër ka qenë anëtar i Shtabit  
4 të Përgjithshëm? Për shembull, a e dini nëse z. Thaçi ka qenë  
5 anëtar i Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së, z. Veseli, z.  
6 Selimi ose z. Krasniqi?

7 PË. Për mua baza kryesore sa i takon dhënies së informacionit  
8 për pyetjen tuaj është raporti që kam treguar sot, por në  
9 qoftë se e dija konstelacionin ose në qoftë se e dija  
10 përbërjen më herët, domethënë, në qoftë se këta persona ishin  
11 anëtarë të Shtabit të Përgjithshëm unë e vë në dyshim këtë,  
12 nuk mund t'jua them me siguri.

13 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Në rregull.

14 Tani kalojmë te paragrafi 68 i intervistës që i keni  
15 dhënë ZPS-së. I keni thënë ZPS-së që në fund të 1999 dhe në  
16 fillim të 2000-shit jeni takuar me z. Veseli, me Kadri  
17 Veselin. Megjithëse thatë që gjithmonë e më pak keni marrë apo  
18 keni pasur takime me z. Veseli, sepse ai ishte shef i  
19 shërbimit informativ.

20 Së pari, nga e dinit ju që z. Veseli kishte këtë post?

21 Z. EMMERSON: [Përkthim] Thjesht për korrigjim, domethënë  
22 bëhet fjalë për periudhën 1999 dhe 2000, jo në fund të 1998-s.

23 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Ju kërktoj falje. M'u duk mua  
24 sikur e dëgjova 1998, por në fakt transkripti thotë në 1999-n.  
25 Nuk ka problem fare.

1 Atëherë e kisha fjalën për 1999 dhe 2000-shin, për këto  
2 dy vite.

3 PË. Kisha kolegë evropianë që merreshin me këtë fushë, pra,  
4 me fushën e informimit dhe e kishin takuar z. Veseli në këtë  
5 kapacitet, në këtë post të tij. Dhe gjithashtu ishte edhe  
6 dikush tjetër nga bashkësia ndërkombëtare që po përpiquej që të  
7 mund të fitonte një lloj kontrolli mbi elementë të caktuar,  
8 dhe të cilët pas luftës kishin tendencë që të shkonin në  
9 drejtim të krimit të organizuar.

10 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] A e dini ju se si përfundoi  
11 në këtë post z. Veseli ose me fjalë të tjera kush e emëroi z.  
12 Veseli në këtë post?

13 PË. Jo.

14 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] A e dini se si është  
15 përzgjedhur ai për këtë pozicion, për këtë post ose me fjalë  
16 të tjera çfarë e ka bërë atë kandidat bindës për atë pozicion?

17 PË. Jo.

18 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] A e keni ditur atëherë apo a  
19 e dini tani se çfarë detyrash ka pasur z. Veseli gjatë luftës?

20 PË. Çfarë pozicioni ka pasur ai gjatë luftës?

21 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Po.

22 PË. Ai është prezantuar si Numri 7 në atë kohë, por është  
23 prezantuar gjithashtu edhe si bashkëbisedues ose si partner  
24 politik dhe sikurse e thashë dhe më përpara ne donim që të  
25 kishim sa më shumë bashkëbisedues politikë. Kështu që

1    prezumimi ynë ishte që ai luante dhe një rol politik në UÇK.  
2    Sikurse e thashë dhe më herët, si diplomatë ne nuk ishim të  
3    interesuar se çfarë pozicioni kishin a në kuptimin ushtarak  
4    ose në ushtri se nuk kishim fare lidhje me këtë çështje.

5           GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Besoj që e bëtë të qartë  
6    këtë gjë, megjithatë, pavarësisht kësaj dëshiroj t'jua bëj  
7    përsëri pyetjen: A ka ndonjë informacion që ju ka bërë juve të  
8    besoni që z. Veseli ka pas në një rol zbulim-kundërzbulim  
9    gjatë luftës?

10   PË. Jo, gjatë luftës, jo. Unë e kam takuar atë në një tjetër  
11   cilësi. E kam takuar atë vetëm pas luftës përmes kolegëve, siç  
12   jua shpjegova, dhe nuk di si t'i përgjigjem pyetjes tuaj.  
13   Vetëm se di që ai merrej me shërbime informimi për ish-UÇK-në.

14           GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] A jeni në dijeni në qoftë se  
15    UÇK-ja ka pasur një shërbim zbulim-kundërzbulimi ose shërbim  
16    inteligjence ushtarake gjatë luftës?

17   PË. Jo, nuk kam dijeni për këtë, por nuk do të çuditesha  
18   sikur të kenë pasur.

19           GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Ju kërktoj ndjesë që jua bëj  
20    edhe një herë këtë pyetje, por mund të jetë relevante. A e  
21    dini në qoftë se brenda UÇK-së ka pasur një dallim ose për  
22    shembull, a do ju befasonte juve fakti që në UÇK të kishte një  
23    dallim midis shërbimi të zbulim-kundërzbulimit brenda  
24    përbrenda vendit edhe një shërbim inteligjence për  
25    marrëdhëniet jashtë vendit? A do ju habiste një gjë e tillë?

1 PË. Nuk jam në dijeni të kësaj gjeje. Megjithatë, di që  
2 jashtë Kosovës po përpiqeshin që të mblidhnin fonde, por kjo  
3 nuk do të thotë domosdoshmërisht, domethënë, që bëhej fjalë për  
4 një shërbim informimi jashtë vendi. Megjithatë, kjo mund të  
5 ketë lidhje me një rrjet për krijimin e fondeve për të blerë  
6 armë të cilat ju nevojiteshin aq shumë për luftime.

7 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do bëjmë  
9 pushimin e drekës tani. Do bëjmë një pushim prej një ore e  
10 gjysmë; do të kthehemi në orën 14.30 e do të vazhdojmë me  
11 pjesën e mbetur të pyetjeve. Faleminderit, Dëshmitar. Ju  
12 faleminderit për ndihmën deri tani. Mund të dilni nga salla i  
13 shoqëruar nga Asistentja.

14 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do bëjmë  
16 pushim deri në 14.30.

17 --- Pauza e drekës fillon në orën 13.01

18 --- Seanca rifillon në orën 14.33

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Para se të  
20 fillojmë, në vijim të konferencës për ecurinë e çështjes së 27  
21 majit dhe parashtimeve të dobishme që morëm prej të gjitha  
22 palëve, dalim me urdhrat në vijim.

23 Së pari, Trupi Gjykses urdhëron ZPS-në që të njoftojë  
24 Trupin Gjykses, palët dhe pjesëmarrësit sa i takon njoftimit  
25 të mëtutjeshëm për racionalizimin e provave të veta jo më vonë

1 se 16 shtatori 2024. Dhe presim të na i japinë në mënyrë të  
2 hollësishme dhe të qartë të gjitha hapat dhe masat që do të  
3 ndërmarrë ZPS-ja për të shkurtuar më tej dhe përshpejtuar  
4 paraqitjen e provave të veta. Në këtë moment, pasi të marrim  
5 këto, pra, Trupi Gjykes do të organizojë një konferencë  
6 tjetër për ecurinë e çështjes gjyqësore për të diskutuar më  
7 tej këtë aspekt dhe për të dëgjuar parashtrimet e palëve sa i  
8 takon njoftimit prej ZPS-së.

9 Së dyti, ZPS-ja urdhërohet të shqyrtojë mundësinë për  
10 kryerjen e seancave përgatitore në distancë ose fizikisht në  
11 vendbanimin e dëshmitarëve kur është e mundur për të  
12 përshpejtuar procesin në kuadër të përgatitjes dhe nxjerrjes  
13 së shënimeve përgatitore. Trupi Gjykes e ka parasysh që një  
14 proces mund të jetë veçanërisht i përshtatshëm sa i takon  
15 dëshmitarëve të krimit, dëshmitarëve të cilët kanë deklarata  
16 dhe intervista të kufizuara, si dhe dëshmitarëve që kryesisht  
17 do të shërbejnë për të konfirmuar dëshmitë të tjera.

18 Së treti, sa i takon marrjes së njoftimeve, pas marrjes  
19 së njoftimeve përgatitore çdo ekip i Mbrojtjes brenda 24 orëve  
20 do të njoftojë Trupi Gjykes dhe ZPS-në nëse do të ketë  
21 ndryshime në kohën që do u nevojitet për kundërpyetjet.

22 Së katërti, ZPS-ja do të ndërmarrë hapat e nevojshëm për  
23 të garantuar me aq sa është e mundur që të mos çojmë dëm  
24 asnjë ditë në sallën e gjyqit të cilën e kemi planifikuar  
25 paraprakisht.

1 Së pesti, Mbrojtja duhet të japë parashikime kohore  
2 realiste sa i takon kundërpyetjeve brenda tri ditësh pune pasi  
3 marrin njoftim për bllokun e radhës së dëshmitarëve që do të  
4 thërrasë ZPS-ja.

5 Sa u takon dëshmitarëve që do të fillojnë të japin dëshmi  
6 më 24 qershor 2024, Mbrojtja duhet të na japë këtë  
7 përlllogaritje kohore jo më vonë se 12 qershori 2024. Trupi  
8 Gjykues do të rishikojë kohën që ka kërkuar Mbrojtja dhe kur  
9 të jetë e nevojshme do të bëjë dhe parashikimet e veta për  
10 kohë të përshtatshme për kundërpyetjet dhe mund të vendosë  
11 kufij nëse është e nevojshme kjo.

12 Në rastet kur Trupi Gjykues vlerëson se është e nevojshme  
13 të reduktohet koha e nevojshme për kundërpyetje të  
14 dëshmitarëve, do t'ua komunikojë këtë në kohë palëve dhe  
15 pjesëmarrësve. Ky kufi kohor që do të përcaktojë Trupi Gjykues  
16 do t'i shërbejë si bazë ZPS-së për të planifikuar dëshmitarët  
17 e radhës. Veç kësaj, Mbrojtja do të duhet të përgatisë  
18 kundërpyetjet në bazë të afateve kohore që do të përcaktojë  
19 Trupi Gjykues dhe mund të kërkojë kohë shtesë për  
20 kundërpyetjet dhe duhet të japin argumentim për këtë.

21 Së gjashti, në momentin që ZPS-ja do të dalë në  
22 përfundimin se nuk të thërrasë një dëshmitar të caktuar, do të  
23 njoftojë menjëherë Trupi Gjykues dhe Mbrojtjen.

24 Së shtati, sa u takon dëshmitarëve të krimit, ZPS-ja  
25 udhëzohet të ketë parasysh mundësinë për të dorëzuar dëshmitë



1 e tyre në bazë të rregullës 153. Trupi Gjykues vëren se kjo  
2 dispozitë është veçanërisht e dobishme në rastet kur, A,  
3 dëshmia e propozuar është kryesisht ose ekskluzivisht e natyrës  
4 konfirmuese ose, B, kur dëshmia në fjalë nuk është e  
5 kontestuar.

6 Përpara se të bëjnë kërkesat sipas rregullës 153, ZPS-ja  
7 duhet të konsultojë fillimisht Ekipet e Mbrojtjes për të parë  
8 nëse mund të ketë kundërshtime prej tyre.

9 Së fundi, në përputhje me sugjerimin që bëri Mbrojtja e  
10 Thaçit, Trupi Gjykues urdhëron ZPS-në të na japë një  
11 planifikim të hollësishëm sesi planifikojnë t'i paraqesin  
12 provat deri në 1 prill 2025. Ky plan duhet t'i jepet Trupit  
13 Gjykues në mënyrë *ex parte* jo më vonë se 21 qershori 2024. Në  
14 të duhet të ketë informacion të hollësishëm si në vijim: Një,  
15 dëshmitarët që planifikon të thërrasë ZPS-ja gjatë kësaj  
16 periudhe kohore dhe ti ketë dhe rendin përkatës; dy, orët që  
17 mendojnë që do ju nevojiten për pyetje vetë Prokurorisë; tre,  
18 cilët dëshmitarë do të jenë sipas rregullës 153 dhe cilët do  
19 të jenë sipas rregullës 154; pesë, cilët dëshmitarë të mbetur  
20 do të përdoren sipas rregullës 155 për periudhën e mbetur  
21 kohore; gjashtë, çdo mocion jогоjor apo mocione të tjera që do  
22 të dorëzohen në këtë periudhë; shtatë, cilët prej këtyre  
23 dëshmitarëve do të jenë me videolidhje; dhe, tetë, të  
24 artikulojnë çdo faktor që mund të ketë ndikim negativ në  
25 zbatimin e planifikimit të propozuar.

1 Pasi të marrim planifikimin nga ZPS-ja, Trupi Gjykses do  
2 të vendosë nëse mund t'ia japë pjesërisht apo tërësisht këtë  
3 Mbrojtjes dhe Mbrojtësit të Viktimave dhe për këtë do të  
4 konsultohet me ZPS-në dhe do të shoh mundësinë për organizimin  
5 e një konference për ecurinë e çështje gjyqësore në këtë pikë.  
6 Ky planifikim është i dobishëm në mënyrë që të gjitha palët të  
7 përgatiten në mënyrë efikase dhe të sigurohemi që kjo çështje  
8 gjyqësore të vijojë në mënyrë të shpejtë.

9 Sigurisht ZPS-ja, duhet që patjetër, sigurisht, duhet të  
10 themi që ZPS-ja nuk është e detyruar që të ndjekë  
11 domosdoshmërisht planifikimin që do të na japë fillimisht. Kjo  
12 do të jetë diçka fleksibël.

13 Me kaq mbyllim urdhrin me gojë të Trupit Gjykses.

14 Ju lutem tani të sillni dëshmitarin në sallë.

15 [Dëshmitari vijon dëshminë]

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëshmitar, do  
17 vazhdojmë me pyetjet e Gjykatësve.

18 Fjala është ende për Gjykatësin Barthe.

19 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Mirëdita, Dëshmitar dhe mirë  
20 se u kthyet.

21 PË. Mirë se ju gjeta.

22 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Uroj që të keni pasur një  
23 pushim të këndshëm.

24 PË. Çdo gjë relative është.

25 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Kam disa pyetje të tjera për

1 ju dhe do të filloj me këto pyetje.

2 Gjatë këtyre 14 muajve të fundit kemi dëgjuar shumë sa i  
3 takon marrëdhënies që ka pasur UÇK-ja me LDK-në, kemi dëgjuar,  
4 pra, në këtë sallë gjyqi. Nga sa keni parë ju në kohën në  
5 Kosovë thatë dhe e përshkruat marrëdhënien mes këtyre dy  
6 grupeve, dje si oponentë politik, "rivalë politik" dhe po  
7 ashtu thatë që UÇK-ja ka qenë një kërcënim për monopolin që  
8 gëzonte LDK-ja.

9 Për procesverbal, kjo është thënë në faqen 89 të  
10 transkriptit provizor.

11 Tani unë jam i interesuar të di dhe anën tjetër të  
12 medaljes, do të doja të dija çfarë qëndrimi ka pasur UÇK-ja  
13 kundrejt LDK-së anëtarëve të saj dhe përkrahësve të saj. Kemi  
14 dëgjuar nga disa dëshmitarë që, disa dëshmitarë që kishin qenë  
15 përkrahës të LDK-së përpara luftës, sikurse ka qenë shumica e  
16 popullsisë shqiptare në Kosovë dhe që më pas u kyçën në UÇK  
17 gjatë luftës. Kjo ka qenë situata.

18 Sipas jush a ka ndodhur vërtetë kjo, që persona që më  
19 parë kishin qenë përkrahës të LDK-së më vonë u bënë anëtarë të  
20 UÇK-së?

21 PË. Po, e kemi diskutuar sot edhe me z. Krasniqi, me z. Ramë  
22 Buja. Siç është rasti i z. Krasniqi dhe z. Ramë Buja që kishte  
23 persona nga radhët nga LDK-ja që u kyçën në radhët e UÇK-së.

24 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Unë po flisja për personat  
25 që përkrahnin LDK-në, megjithatë kjo vlente edhe për anëtarët

1 zyrtarë të LDK-së, siç ishte rasti i z. Krasniqi përpara  
2 luftës dhe z. Buja, sepse të dy këta kanë qenë ish anëtarë të  
3 LDK-së, apo jo  
4 PË. Po, kështu është.

5 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Po për anëtarë apo  
6 përfaqësues të LDK-së që nuk deshën të kyçeshin në UÇK dhe që  
7 folën publikisht kundër interesave dhe qëllimeve të UÇK-së? A  
8 do të ishte, a përballëshit me ndonjë problem këta persona?  
9 PË. Ndjesia që kisha unë atë kohë ishte që kishte frikësi,  
10 ndarje mes UÇK-së dhe LDK-së, e kam thënë edhe këtu,  
11 ndonjëherë edhe brenda qarqeve të LDK-së kishte deklarata të  
12 llojit që UÇK-ja nuk ekziston ose përpiqeshin ta minimizonin  
13 rolin e tyre. Unë ju thashë më përpara ata kanë qenë oponentë  
14 politik dhe LDK-ja e kishte problem faktin që po u cenohej  
15 monopoli politik, sepse ekzistonin parti të tjera politike në  
16 Prishtinë që gjithashtu ishin krijuar nga figura që ishin  
17 larguar nga LDK-ja sepse nuk ishin të kënaqur me qëndrimin  
18 tepër pasiv të LDK-së sipas tyre dhe për shkak të faktit që  
19 LDK-ja po përpiqej që t'i bënte një rezistencë paqësore  
20 pushtimit serb.

21 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Pra, a ishte problem për një  
22 person, që sikurse thashë më herët, për një person që fliste  
23 publikisht kundër interesave dhe objektivave të UÇK-së, a  
24 përballëj me ndonjë problem ky person, ky person mund të ishte  
25 qoftë përfaqësuese apo përkrahës i LDK-së dhe nuk donte të

1 kyçej në UÇK?

2 PË. Edhe mund të kishte qenë. Unë këtë nuk e di. Kishte disa  
3 raporte, ishin raportuar disa sulme kundër anëtarëve të LDK-së  
4 edhe në Prishtinë, por asnjëherë nuk u bë e qartë se kush  
5 fshihej pas këtyre ngjarjeve.

6 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Dje në një video që tregoi  
7 Mbrojtja e z. Thaçi pamë që z. Thaçi mbajti një fjalim ku bëri  
8 thirrje për paqe ndër të tjera, pajtim dhe përfshirje,  
9 gjithëpërfshirje të pakicave, po përdor fjalët e mia këtu.  
10 Besoj se ju kujtohet kjo video që dje?

11 PË. Po, më kujtohet videoja dhe e pashë dje për herë të parë.

12 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Trupi Gjykses dëshiron të  
13 dijë si i konsideronte këto ligjërrata, këto paraqitje në  
14 publik komuniteti ndërkombëtar në atë kohë? A vlerësoheshin?

15 PË. Absolutisht. Qëllimi ynë ishte që të ndalonim konfliktin  
16 dhe kishte ende problematika të mëdha sa i takon sigurisë dhe  
17 falë angazhimit të udhëheqësve politik nga pala e shqiptarëve  
18 të Kosovës, sidomos UÇK-ja sepse kishte një besueshmëri në  
19 rangjet e UÇK-së, incidente të tilla mund të kufizoheshin.

20 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Këto paraqitje në publik apo  
21 këto fjalime prej anëtarëve të qeverisë të sapoformuar të  
22 Kosovës, qeverisë së përkohshme, ishin të rëndësishme apo  
23 ishin thelbësore mund të themi për këtë situatë?

24 PË. Ne si komunitet ndërkombëtar ose OKB-ja nuk e njohëm  
25 qeverinë e përkohshme të Kosovës, por ne e konsideronim z.

1 Thaçi si një udhëheqës të rëndësishëm brenda UÇK-së që do të  
2 ishte një aleat me shumë vlerë për ne për të qetësuar situatën  
3 ndëretnike.

4 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Përveç, nuk po flasim këtu  
5 çështjen e njohjes së qeverisë së përkohshme të Kosovës,  
6 përveç kësaj, përpos kësaj, a ishte e qartë, sipas jush, pra,  
7 komuniteti ndërkombëtar a priste që të merrnin masa lojtarët e  
8 niveleve, të rangjeve të larta apo zyrtareve qeveritarë që të  
9 parandalonin apo të ndaloi dhunën kundër pakicave?

10 PË. Kjo ishte në fakt dhe thirrja e komunitetit ndërkombëtar.

11 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Përveç këtyre fjalimeve apo  
12 paraqitjeve në publik, keni dijeni për ndo një përpjekje  
13 tjetër nga z. Thaçi apo anëtarë të qeverisë së përkohshme të  
14 Kosovës për të parandaluar apo ndaluar dhunën kundër pakicave?

15 PË. Sikurse ua thashë dje, në atë kohë nuk isha pjesë e  
16 Kombeve të Bashkuara. Flas për periudhën kur janë incizuar  
17 këto video. Më kujtohet që Bernard Kouchner, ka qenë që merrej  
18 kryesisht për këtë dhe ka bërë dhe një fushatë ndërgjegjësimit  
19 në vjeshtën e 1999, ai ka shkuar kryesisht në zonat më të  
20 vështira, zona kryesisht të banuara nga shqiptarët këto dhe ai  
21 fliste atje ndonjëherë edhe në serbisht, i bënte disa herë  
22 fjalimet edhe në serbisht, ndonëse kjo në atë kohë krijonte  
23 situata të pakëndshme ose kjo nuk u pëlqente shqiptarëve të  
24 Kosovës kur shkoi ai atje.

25 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Ju po flisni për z.

1 Kouchner, por unë po ju pyesja nëse ju vetë keni dijeni për  
2 ndonjë përpjekje nga ana e Qeverisë së përkohshme që udhëhiqej  
3 nga z. Thaçi përveç fjalimeve dhe përveç paraqitjeve në  
4 publik?

5 PË. Nuk më kujtohet, sepse nuk ka qenë domosdoshmërisht as  
6 fokusi i punës time.

7 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Pyetja ime e fundit dhe do  
8 përpigem të jem i qartë: Keni dijeni të jetë marrë ndonjë masë  
9 konkrete nga z. Thaçi apo nga qeveria që bashkëpunonte me  
10 UNMIK-un, me KFOR-in, pra, të jetë marrë ndonjë masë e natyrës  
11 legjislative apo administrative për të dorëzuar personat e  
12 dyshuar që ishin kapur në flagrancë apo për të diskutuar apo  
13 ju kanë dhënë ndonjëherë identitetet e personave që  
14 pretendohet se janë rrëmbyer, apo civilët që janë mbajtur të  
15 ndaluar gjatë luftës apo pas luftës? A keni dijeni të jenë  
16 marrë masa të tilla nga ana e qeverisë?

17 PË. Nuk jam në dijeni. Këto janë aspekte të sigurisë. Ishte  
18 KFOR-i kryesisht që merrej me këtë aspekt dhe kontaktonte me  
19 UÇK-në, ata mbasi kanë kontaktuar dhe me përfaqësues të  
20 qeverisë së përkohshme, por unë nuk kam pasur këtë cilësi atë  
21 kohë.

22 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Atëherë do na duhet të  
23 pyesim KFOR-in apo ish-anëtarë të KFOR-it në lidhje me këtë.

24 Faleminderit, z. Kickert. Nuk kam më pyetje për ju.

25 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Mirëdita, Dëshmitar. Do të

1 doja të diskutonim nja dy aspekte që i keni përmendur në  
2 dëshminë tuaj.

3 Ju thatë se u është dhënë garanci e vazhdueshme në mënyrë  
4 të përsëritur nga ana e UÇK-së se do të respektonin Konventat  
5 e Gjenevës. A ju kujtohen pyetjet që ju bënë në lidhje me  
6 këtë?

7 PË. Po. Nuk më kujtohet specifikisht për kë e keni fjalën po  
8 është një nga temat që u diskutua dhe përgjigja që mund t'ju  
9 jap është: Po, thoshin ata do t'i respektojmë këto konventa  
10 sepse jemi një ushtri e rregullt.

11 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A pajtoheni me  
12 parashtrimin tim se ishte në interesin politik të udhëheqjes  
13 së UÇK-së që t'ju përgjigjej ju në këtë formë, t'ua jepnin  
14 këtë garanci, a pajtoheni me këtë?

15 PË. Natyrisht i shërbente qëllimit të tyre, e thonin që ishin  
16 një ushtri e rregullt, i ndjekim të gjitha rregullat  
17 ndërkombëtar, e portretizonin veten, pra, në këtë mënyrë dhe  
18 ata kështu deshën të dukeshin në sytë e diplomatëve.

19 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A është e drejtë që të  
20 them që mbështetja juaj, mbështetja e komunitetit  
21 ndërkombëtar, mund të kishte qenë më e paktë, do të kishte  
22 qenë më e paktë nëse nuk do të merrnit këto garanci nëse ata  
23 nuk do ju thonin që do të respektojmë Konventat e Gjenevës  
24 edhe standardet e të drejtave të njeriut?

25 PË. Mendoj se në shënimet apo procesverbalet që përgatisnim



1 në takimet në Kleçkë besoj se është përmendur atje, David  
2 Slinn, unë dhe David Slinn, u kemi thënë që është shumë i  
3 rëndësishëm bashkëpunimi në këtë fushë që të mos humbisni  
4 mbështetjen prej ndërkombëtarëve.

5 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Tani unë do t'ju pyes për  
6 zbatimin e këtyre garancive. Ju kam bërë disa pyetje po do të  
7 doja t'ju bëja disa pyetje të tjera plotësuese.

8 Kur i shprehët këto shqetësime dhe u garantuat prej tyre  
9 se do ta respektonin konventat, ndonjë prej anëtarëve të UÇK-  
10 së ju tha çfarë planifikonin të bënin konkretisht ata për të  
11 zbatuar këto garanci?

12 PË. Jo.

13 PY. Përveç asaj që ju thanë apo nuk ju thanë, ju vetë  
14 personalisht mësuat ndonjëherë çfarë hapsh morën ata  
15 konkretisht për të zbatuar këto garanci?

16 PË. Jo. Sikurse ju thashë më përpara, po përdor gjuhën tuaj,  
17 kjo doli kalimthi e sipër dhe nuk ka qenë tema kryesore e  
18 bisedës sonë.

19 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Unë e di përgjigjen po do  
20 ta bëj pyetjen sidoqoftë, ju tha Mbrojtja e z. Thaçi që u  
21 krijua një gjykatë ushtarake në një moment kohor nga UÇK-ja.  
22 Ju keni mësuar ndonjë rast kur ndonjë anëtar i UÇK-së të jetë  
23 ndjekur penalisht apo të jetë ndëshkuar apo të jetë dënuar për  
24 shkeljen e Konventave të Gjenevës gjatë kohës suaj në Kosovë?

25 PË. Jo, nuk kam dijeni për këtë.

1 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Tani doja të flasim për  
2 diçka që u ngrit nga Mbrojtja e Krasniqit.

3 Dhe për këtë do t'i lutesha Zyrës Administrative që të  
4 nxjerrë në ekran dokumentin me numër U008-1323. Kjo është  
5 deklarata për TPNJ-në dhe për këtë doja të shihnim faqen U008-  
6 1333. Për procesverbal, kjo tashmë është pjesë e provës  
7 materiale 1D142, por që ende nuk është hedhur në  
8 dokumentacionin gjyqësor.

9 Mesa kuptoj unë ky është procesverbali që keni përgatitur  
10 ju për takimin në fjalë. Dhe dua t'ju pyes për paragrafin  
11 drejt fundit të faqes kur thoni:

12 "Robërit e luftës, Konventa e Gjenevës - jo civilët e  
13 drejta e lidhjes me KNKK".

14 Dy fjalët që më interesojnë është ky togfjalësh "jo  
15 civilët". Pra, mesa kuptoj unë, ju keni dashur të thoni që nuk  
16 duhet të ketë të burgosur jo civil?

17 PË. Po.

18 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Po a ka qenë ndonjë  
19 problem ky që e keni trajtuar me udhëheqjen e UÇK-së kur e  
20 keni takuar, pra, ju keni thënë që nuk duhet të ndalonit  
21 civilët?

22 PË. Në vija të përgjithshme po. Por siç ju thashë nuk ka qenë  
23 tema kryesore e bisedimeve tona.

24 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A ju kujtohet nëse  
25 mundeni, nëse ju kanë dhënë ndonjë përgjigje lidhur me këtë

1 kërkesë?

2 PË. Nuk më kujtohet nëse ka dalë si temë kjo në atë takim  
3 konkret.

4 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Do t'ju bëj pyetje për  
5 diçka tjetër, për këto numrat, po ju pyes për numrat që  
6 përdorin disa nga anëtarët e UÇK-së, si pseudonime po them  
7 unë, pra dhe prezantoheshin përmes numrave. Mbase mund të  
8 vendosim dhe dokumentin në ekran, në qoftë se lind nevoja.

9 Është dokumenti me numër P1217. Shkojmë pa më poshtë në  
10 anglisht, faleminderit.

11 Këtë raport e vendosa këtu sepse këtu keni përmendur  
12 numrat dhe ua keni atribuar personave të caktuar. Siç e kam  
13 kuptuar unë, ju i keni interpretuar këto numra si një rend  
14 hierarkik ku do të thotë Numri 1 është epror i numër 2, i  
15 Numrit 3 e në vijim kështu?

16 PË. Po. Në këtë kohë kështu supozuam.

17 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] E mendoni se ekziston  
18 mundësia që këto numra mund t'i jenë referuar diçkaje tjetër,  
19 për shembull mund të ketë qenë sipas rendit sesi janë bërë  
20 ushtarë të UÇK-së, sipas radhës, pra, që janë bërë anëtarë të  
21 UÇK-së?

22 PË. Edhe mund të jetë.

23 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Shohim faqen tjetër të  
24 dokumentit, tek anglishtja. Është diku në mes. Është paragrafi  
25 që fillon me fjalën "Negociatat ..." në gjermanisht është

1 paragrafi i dytë po do bëj dhe unë si z. Misetiç, do përpiqem  
2 të flas gjuhë të huaj.

3 E shihni

4 PË. Po. E shoh.

5 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Keni bërë një koment këtu  
6 për Adem Demaçin. Në anglisht është përkthyer që ai ka qenë  
7 një figurë simbolike. E shihni?

8 PË. Po.

9 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Kështu e keni kuptuar  
10 vërtetë rolin dhe kompetencat e z. Demaçi aso kohe

11 PË. Po. Z. Demaçi ka qenë i burgosur lufte për një kohë shumë  
12 të gjatë, gëzonte një status të caktuar në shoqërinë e  
13 shqiptarëve të Kosovës sepse nuk hoqi kurrë dorë nga  
14 rezistenca e tij paqësore kundër pushtimit, shtypjes serbe.  
15 Ishte një personalitet i fortë shumë i respektuar, po  
16 sigurisht edhe shumë luftëtar energjik si natyrë.

17 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Tani nuk dua të diktoj unë  
18 fjalët, por unë besoj se kur thoni ju këtu simbolike, a keni  
19 dashur të thoni që ju s'e keni parë atë ndonjëherë të jepte  
20 urdhër ndokujt në UÇK apo të merrte vendime që duhet patjetër  
21 të zbatoheshin prej UÇK-së, a është ky një përshkrim i drejtë?

22 PË. Natyrisht. Ne e pamë dhe raportin tim ku po flisja për  
23 një takim me të në fillim të korrikut dhe është pikërisht ai  
24 që doli me idenë, ai tha që numrat përfaqësojnë rendin  
25 hierarkik, nuk është se e shpika unë këtë ide. Por ai ma tha

1 këtë sepse ai kishte takime me UÇK-në dhe besoj se UÇK-ja e  
2 respektonte në mënyrë të konsiderueshme. Dhe më pas, në fund  
3 të vitit, ai u bë një përfaqësues politik nëse mund ta themi  
4 kështu i UÇK-së në Prishtinë.

5 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Do të doja të vazhdoja me  
6 diçka tjetër për të cilën ju bëri pyetje Mbrojtja e Krasniqit  
7 dhe kjo është në provën P1220.

8 Tani, besoj se e njihni shumë mirë raportin tuaj të datës  
9 31 korrik 1998.

10 Dhe do t'i kërkoja Sekretares të kalojmë në faqen 4 të  
11 këtij dokumenti. Faleminderit.

12 Juve ju lexua paragrafi ku flitet për Nekibe Kelmendin. A  
13 arrini ta gjeni këtë paragraf? Në gjermanisht është paragrafi  
14 i dytë.

15 PË. Po.

16 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Ajo për të cilën dua t'ju  
17 pyes është, që në anglisht thuhet:

18 "Në një reagim të parë përfaqësues të UÇK-së e hodhën  
19 poshtë, e refuzuan në tërësi Nekibe Kelmendin nga LDK-ja dhe  
20 kërkuan pjesëmarrjen e LPK-së ..."

21 Ju na thatë që e dini kush është znj. Kelmendi dhe  
22 kuptova nga ju që ju e njihni shumë mirë dhe e keni takuar  
23 atë. Pyetja ime e parë është: A ju kujtohet cilët përfaqësues  
24 të UÇK-së e refuzuan tërësisht këtë zonjë si propozimi i  
25 sugjeruar për qeverinë?

1 PË. E keni fjalën kush nga tre bashkëbiseduesit?

2 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Po.

3 PË. Kjo nuk më kujtohet.

4 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Dhe kjo ishte pyetja ime e  
5 dytë. Pra, duhet të ketë qenë njëri prej këtyre tre, Buja,  
6 Krasniqi apo Limaj?

7 PË. Po. Dhe mesa më kujtohet z. Krasniqi ka qenë  
8 bashkëbiseduesi kryesor i cili ka folur kryesisht, por nuk më  
9 kujtohet saktësisht kush foli dhe sa foli gjatë atij takimi.

10 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A është e saktë të themi  
11 që kundërshtimi i shprehur nga këta tre përfaqësues ndaj znj.  
12 Kelmendi bazohet në faktin që ajo ishte anëtarë e LDK-së apo  
13 jeni në dijeni të ndonjë faktori tjetër që do të shpjegonte  
14 këtë kundërshtim?

15 PË. Nuk jam në dijeni të ndonjë faktori tjetër. E njihja znj.  
16 Nekibe Kelmendi po jo aq shumë në atë kohë. Kam punuar pastaj  
17 me të dhe e kam njohur më mirë pas luftës sepse kishim një  
18 sistem bashkëministri të drejtësisë.

19 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Në memorandumin tuaj këtu,  
20 shënimi që po shohim, është i datës 21 korrik 1998. A e dini  
21 çfarë i ndodhi pastaj znj. Nekibe Kelmendi pas disa javësh,  
22 pra, në muajin shtator? A ju ka treguar ajo ndonjëherë çfarë i  
23 ndodhi asaj apo pjesëtarëve të tjerë anëtarë të parlamentit të  
24 Kosovës?

25 PË. Jo.

1 PY. A keni dëgjuar që ajo është arrestuar dhe mbajtur e  
2 ndaluar për një kohë nga UÇK-ja, a dini gjë për këtë?

3 PË. Mund të ketë ndodhur që dikush të ketë treguar një raport  
4 apo një dokument këto dhjetë ditët e fundit, por në atë kohë  
5 mund të ketë qenë që e kam dëgjuar, por nuk më kujtohet  
6 gjithsesi.

7 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Pyetjet e fundit që kam  
8 kanë të bëjnë me pyetjet që ju bënë juve lidhur me dëshminë  
9 tuaj në çështjen Limaj.

10 Për këtë nevojë i kërkoj Sekretares që të shfaqë në ekran  
11 dokumentin DHT0017 deri në DHT00492.

12 Ky është aktgjykimi i Dhomës së Gjyqit të TPNJ-së, Dhoma  
13 numër 2, datës 30 nëntor 2005 në çështjen kundër z. Limaj dhe  
14 të tjerëve në të cilën keni dhënë dëshmi.

15 I kërkoj Sekretares të na çojë në faqen 48. Kjo duhet të  
16 jetë faqja 48 e aktgjykimit, pak më poshtë, katër faqe më  
17 tutje.

18 Që t'ju jap një kontekst, pra, është një pjesë e  
19 aktgjykimit ku dhoma e gjykit jep një përmbledhje të  
20 dëshmisë suaj. E kuptoni këtë?

21 PË. E kuptoj. Është hera e parë që e shoh.

22 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Dhe vazhdon një faqe e  
23 gjysëm ku i referohet dëshmisë suaj dhe dëshmitarëve të tjerë  
24 që kanë dëshmuar për të njëjtën çështje, tani do të doja të  
25 kalojmë në faqen 50, 54 formati PDF.

1 Në paragrafin 129, disa prej konstatimeve kryesore,  
2 gjetjeve kryesore të Trupit Gjykes, u mbështetën në veçanti  
3 po jo vetëm në dëshminë tuaj. Ajo që do t'ju kërkoja është që  
4 të na thoni nëse pajtoheni me konstatimet, përcaktimet që i  
5 janë bërë këtu apo që do t'i ricilësonit disa, ndonjë prej  
6 tyre. Këtu lexon:

7 "Siç konfirmohet nga këto prova, nga korriku 1998 UÇK-ja  
8 ishte bërë e pranuar nga përfaqësuesit ndërkombëtar dhe brenda  
9 në Kosovë si parti kyçe e përfshirë në negociatat në bisedimet  
10 politike për të zgjidhur, krizën e Kosovës. Kjo zbulon dhe  
11 pohon se në atë kohë UÇK-ja kishte arritur një nivel  
12 stabiliteti organizativ dhe efikasiteti. Në veçanti kjo i  
13 jepte asaj aftësinë e pranuar nga të tjerët që të fliste me  
14 një zë dhe me një nivel autoriteti bindës në emër të  
15 pjesëtarëve të saj. Nevoja e UÇK-së për të qëndruar në sekret  
16 dhe ekzistenca e një hierarkie të mirëvendosur në radhët e saj  
17 është e dukshme nga rrethanat se individët e përfshirë në  
18 negociata me misionet e huaja mbanin numra, identifikoheshin  
19 me numra që me sa duket korrespondonin me nivelin e tyre në  
20 hierarkinë e UÇK-së. Për më tepër nga zhvillimi i këtyre  
21 bisedimeve del se UÇK-ja ishte në gjendje të formulonte dhe të  
22 deklaronte ndryshim të taktikave ushtarake dhe gjithashtu  
23 kushteve për të mos ndërmarrë veprime ushtarake të mëtejshme.  
24 Ky është tregues se në atë kohë UÇK-ja kishte mundësinë për  
25 t'u koordinuar, për të koordinuar planifikim dhe aktivitete



1 ushtarake dhe për të përcaktuar një strategji ushtarake të  
2 unifikuar si dhe aftësia për të zhvilluar operacione ushtarake  
3 të në shkallë të gjerë”.

4 Tani, a pajtoheni, e kundërshtoni apo e cilësoni ndonjë  
5 nga këto konstatime apo janë këto në përputhej me atë që dinit  
6 ju dhe përvoja juaj?

7 PË. Po më pyesni që ndoshta dhe të kritikoj një aktgjykim?

8 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Jo, nuk po ju pyes, nuk ju  
9 kërkoj që të kritikoni. Por po ju pyes nëse ju keni parë, bërë  
10 konstatime të tjera nga ato që ka bërë dhoma e gjykimit?

11 PË. Po të mos kishte ardhur nga një gjykatës nuk do ta pohoja  
12 një paragraf të tillë. Nuk do të isha dakord.

13 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Ka ndonjë pikë të veçantë  
14 me të cilën nuk do të ishit dakord?

15 PË. Siç e thashë më parë, në atë kohë ne kemi menduar që  
16 numrat përfaqësonin hierarkinë. Nuk ishim të sigurt. Dhe  
17 pastaj, më vonë, kur numrat nuk u përdorën më dhe dolën  
18 personalitetet dhe emrat, këto nuk pasqyronin detyrimisht  
19 numrat apo hierarkinë e bazuar në numra që ne mendonim më  
20 parë. Sapo ju vetë, i nderuar Gjykatës, sugjeruat që sistemi i  
21 numrave mund të ketë qenë diçka krejt ndryshe, për shembull,  
22 koha apo momenti i hyrjes në ushtri. Dhe dëgjova tani që e  
23 përmendët që mund të ketë qenë dhe diçka më vonë.

24 Dhe gjithashtu nuk do të pajtohesha me faktin që UÇK-ja  
25 në atë kohë ishte kaq e organizuar siç thuhet në këtë

1 paragraf.

2 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Faleminderit për  
3 përgjigjet.

4 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Do t'i kthehesha pyetjes ku  
5 ju vlerësuat përgjegjësinë e hetimit të krimeve të luftës, se  
6 kujt i binte përgjegjësia për hetimin e krimeve të luftës  
7 gjatë kohës që ju ishit këshilltar i përfaqësuesit special të  
8 sekretarit të përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara.

9 Tani, z. Misetic ju pyeti dhe tha:

10 "Kush e kishte autoritetin të hetonte dhe të ndiqte  
11 penalisht krimet e luftës?"

12 Përgjigja juaj ishte:

13 "Duhet të kishin qenë struktura të krijuara nga UNMIK-u.

14 "PY. A ka ndonjë arsye që UNMIK-u nuk kishte këto  
15 struktura të vendosura?"

16 "PË. UNMIK-u nuk kishte kapacitete për të përballuar  
17 këtë. Kombet e Bashkuara nuk kishin administruar një territor  
18 të tillë dhe ishin të ngadaltë në krijimin e strukturave të  
19 tyre".

20 Tani, a ju kujtohet kjo pjesë e dëshmisë suaj?

21 PË. Po, më kujtohet.

22 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Dua që të pyes lidhur me  
23 disa aspekte të kësaj.

24 Gjatë shërbimit tuaj si diplomat dhe gjatë kohës që ishit  
25 në Kosovë, a keni marrë njohuri ose jeni njoftuar me nocionin

1 e përgjegjësisë së secilës palë në konflikt për të hetuar  
2 krimet e luftës të kryera nga pjesëtarët e forcave të  
3 armatosura të tyre?

4 PË. Jo.

5 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Po jeni në dijeni që  
6 ekziston një parimi i përgjithshëm i ligjit ndërkombëtar?

7 PË. Siç e thashë, nuk jam jurist

8 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Sigurisht. Por gjatë kohës  
9 që ishit në Kosovë, natyrisht ishit në dijeni që TPNJ-ja  
10 kishte juridiksion dhe kompetencë për të hetuar dhe për të  
11 ndjekur penalisht krimet e kryera nga palët në territorin e  
12 Kosovës?

13 PË. Po, kam qenë.

14 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] A menduat që juridiksioni i  
15 TPNJ-së ishte i pavend ose ishte hequr sepse UNMIK-u kishte  
16 përfshirë tani në hetimin e krimeve të luftës?

17 PË. Jo. Biles më kujtohet që jam takuar me personelin e TPNJ-  
18 së në terren në Kosovë. Më kujtohet shumë qartë kur u ktheva  
19 në qershor të 1999, më kujtohet në një pikë karburanti ku u  
20 takova me kolegë të TPNJ-së të cilët po dhe po hynin në  
21 Kosovë. Pra, kam qenë në dijeni që ata ishin në terren.

22 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Dhe ju nuk patë asnjë  
23 konflikt apo tension mes hetuesve të krimeve të luftës të  
24 UNMIK-ut në njërin anë dhe hetuesve të ZPNJ-së në anën tjetër?

25 PË. Mesa kuptova unë, TPNJ-ja kishte parimin e

1 subsidiaritetit, pra, nuk hetonin detyrimisht nëse sistemi  
2 gjyqsor vendor mund të merrej me këtë punë pra.

3 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Tani t'i kthehem detyrimeve  
4 të forcave të armatosura të Republikës së ish-Jugosllavisë, a  
5 vlerësuat ju nga perspektiva juaj gjatë kohës që keni punuar  
6 për UNMIK-un në veçanti. A keni vlerësuar se vendosja e UNMIK-  
7 ut në ndonjë mënyrë lironte nga përgjegjësia për të hetuar  
8 krime lufte qeverinë e Jugosllavisë në atë kohë për krimet e  
9 luftës të kryer nga forcat e tyre në territorin e Kosovës?  
10 PË. Jo.

11 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] A keni vlerësuar se vendosja  
12 e UNMIK-ut apo vendosja e TPNJ-së në ndonjë mënyrë lironte  
13 UÇK-në nga përgjegjësia e saj për të hetuar krime lufte të  
14 kryer nga forcat e tyre?

15 PË. Siç e thashë, nuk kam informacion. Nuk isha i informuar  
16 për parimin se forcat e armatosura kanë detyrim të hetojnë  
17 krimet e luftës që forcat e tyre mund të kishin kryer. Nuk  
18 isha i informuar për këtë.

19 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Ta themi kështu: Gjatë kohës  
20 që keni shërbyer në UNMIK a ka patur ndonjë vlerësim që UÇK-ja  
21 duhet të mos hetonte krimet e luftës të kryera nga forcat e  
22 tyre sepse UNMIK-u kishte vendosur edhe sepse TPNJ-ja ishte  
23 krijuar?

24 PË. E kam fjalë TPNJ-ja ekzistonte.

25 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Po.

1 PË. Shumë më parë. Sepse ishte ish-Jugosllavia, e cila kishte  
2 dhe kjo juridiksion, pra, kompetencë në Kosovë. Por, jo, nuk  
3 kam qenë i përfshirë, nuk më kujtohet ndonjë bisedim, kontakt  
4 me UÇK-në, ndonjë bisedim lidhur me hetimin e krimeve që  
5 pretendohet të ishin kryer nga forcat e UÇK-së.

6 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Në lidhje me këtë a është e  
7 saktë të themi se ju nuk keni patur informacion për hapat e  
8 ndërmarrë nga UÇK-ja për të hetuar krimet e kryera nga forcat  
9 e tyre?

10 PË. Nuk kam qenë i informuar për këtë.

11 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Tani do të doja të kalojmë  
12 në një çështje tjetër dhe ka të bëjë me marrëdhënien midis z.  
13 Thaçi dhe z. Fatmir Limaj.

14 Do t'i kërkoja Sekretares së Gjykatës të sjellë në ekran  
15 provën P01225.

16 Ju keni diskutuar deklaratën e ZPS-së në paragrafin 50  
17 dhe lidhur me këto takime ju na keni thënë, lidhur me ku jeni  
18 takuar me Thaçin dhe Limaj në vjeshtë të 1998. A ju kujtohet  
19 sa herë jeni takuar, sa takime keni marrë pjesë ku kanë qenë  
20 të pranishëm Thaçi dhe Limaj?

21 PË. Mesa më kujtohet besoj se ka qenë një takim, për të cilin  
22 jam i sigurt.

23 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Në deklaratën tuaj,  
24 deklarata juaj jep përshtypjen që keni marrë pjesë në më shumë  
25 se një takim?

1 PË. Nuk dua të them me siguri edhe ndonjë takim tjetër. Dhe  
2 meqenëse mu kujtua se njëri prej takimeve me Hashim Thaçin  
3 është zhvilluar në Vjenë, së bashku me Bardhyl Mahmutin nuk  
4 jam në gjendje t'ju them që ka ndodhur ndonjë takim tjetër ku  
5 të dy këta kanë qenë të pranishëm në Kosovë në Banjë.

6 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Dua t'ju referoj dokumentit  
7 që tani është shfaqur në ekran. Është dokumenti P1225. Është  
8 memorandum ndërzyrtar i cili është përpiluar dhe mban datën 25  
9 tetor 1999.

10 Siç shpjeguat ju, më 24 tetor 1999 u takuat me Fatmir  
11 Limaj dhe e përshkruat atë "si një zëvendësministër i  
12 mbrojtjes, 'i vetëshpallur' në të ashtuquajturën 'qeveri të  
13 përkohshme' të z. Thaçi (dhe një prej më të afërmeve,  
14 personave më të besuar të tij) ..."

15 E shihni këtë paragrafin?

16 PË. E shoh.

17 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Tani, a ishte ajo që ju  
18 patë, vërejtët apo ju tha dikush që ju bëri ta përshkruanit z.  
19 Limaj si personi më i afërt i z. Thaçi?

20 PË. Kjo, fakti që ai ka qenë i pranishëm në takimin që bëmë  
21 në Banjë, tani po përpiqem të rikujtoj, mund të ketë qenë dhe  
22 një takim tjetër sepse shtëpia ku u takuam nuk ishte -- nuk  
23 kam shkuar aty vetëm një herë, pra, nuk e di kë tjetër kam  
24 takuar aty, por nuk ka qenë vetëm një herë në Banjë, shtëpia  
25 pra, ku jemi takuar.

1 Në atë kohë mendova që nëse është ai aty me z. Thaçi, ai  
2 duhet të ketë besim të veçantë në të.

3 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Shumë mirë. Në qoftë se  
4 kalojmë në faqen vijuese, në fund fare të faqes në pjesën e  
5 komenteve aty thuhet:

6 "Çeliku (në bisedime private: 'Ajo që them është ligj  
7 këtu') do të thotë që qartë është ai që merr vendimet në zonën  
8 nga Kleçka në Banjë dhe Pagarushë (zona të cilat komandonte më  
9 herët ai)".

10 E shihni këtë pjesë?

11 PË. E shoh.

12 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Tani, ju bë një pyetje më  
13 herët lidhur me këtë. Z. Misetić jua bëri dhe ai tha:

14 "A e kuptuat ju arsyen se pse ai kishte autoritet?"

15 Përgjigja juaj ishte:

16 "Ndoshta për ndikimin e tij si ndoshta komandant rajonal  
17 i UÇK-së në atë kohë".

18 Dua të qartësoj, të kuptoj dëshminë tuaj lidhur me këtë.  
19 Nga njëra anë ju besoni që Thaçi dhe Limaj ishin të afërt,  
20 punonin afër, shumë të ngushtë me njëri-tjetrin dhe nga ana  
21 tjetër, Limaj na thoni juve, tha "Ajo që them unë është ligj  
22 këtu".

23 A mund të na thoni, dua të kuptoj, nëse ju mendoni që  
24 Limaj punonte në mënyrë të pavarur nga udhëheqja e UÇK-së apo  
25 ju e vlerësoni se Limaj punonte në mënyrë energjike por në

1 bashkëpunim dhe marrëveshje me urdhrat që merrte nga udhëheqja  
2 e UÇK-së?

3 PË. Lidhja mes funksionarëve të lartë të UÇK-së ishte  
4 dinamike. Kishte ndarje të partive nga PDK-ja, partia që ata  
5 krijuan, formuan. Mendoj që katër të akuzuarit kishin  
6 anëtarësi në tre parti politike të ndryshme. Pra, nuk ishte  
7 gjë e pazakontë dhe pas luftës kishte dallime, disa dallime  
8 midis disa ish-zyrtarëve të lart të UÇK-së.

9 Po ashtu kishte parti që u krijuan menjëherë pas luftës  
10 dhe që s'kishin të bënin fare me PDK-në, PDK-ja që udhëhiqej  
11 nga z. Thaçi. Për shembull, Ramush Haradinaj që krijoi partinë  
12 e vet menjëherë dhe u përpoq duke më kontaktuar edhe mua duke  
13 thënë "Jam edhe unë person ai rëndësishëm. Mos flisni  
14 gjithmonë me z. Thaçi".

15 Pra, ka patur gjithmonë këto lojëra politike midis  
16 fraksioneve politike. Dhe mbas luftës, kishte një farë  
17 rivaliteti mes ish-personalitetëve të UÇK-së për të dalë në  
18 pah se kush ishte më i rëndësishëm.

19 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Kthehemi tek periudha më  
20 herët, vjeshta e 1998, fillimi i 1999, a kishit ndonjë arsye  
21 për të menduar, besuar se Fatmir Limaj vepronte si element i  
22 pavarur, i pabindur apo jashtë udhëzimeve të udhëheqjes së  
23 UÇK-së?

24 PË. Jo, nuk kisha arsye të tilla.

25 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Faleminderit shumë. Nuk kam



1 më pyetje.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] faleminderit,  
3 Gjykatësi Gaynor.

4 Ka ndonjë pyetje tjetër nga ZPS-ja?

5 Z. CAPIN: [Mikrofoni çaktivizuar].

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Misetic.

7 Z. MISETIC: [Përkthim] Po. Shënoj diçka, faleminderit.

8 Faleminderit.

9 Pyetje vijuese të palës tjetër nga z. Misetic:

10 Z. MISETIC: [Përkthim]

11 PY. Dëshmitar, më lejoni t'ju bëj disa pyetje që buruan nga  
12 pyetjet paraprake dhe besoj që do të përfundojmë sot.

13 PË. Faleminderit shumë.

14 PY. Disa pyetje që burojnë nga pyetjet e bëra nga Gjykatësit.

15 Gjykatësi Barthe ju bëri disa pyetje lidhur me Adem  
16 Demaçin. Dhe në qoftë se, gjithashtu, Gjykatësi Mettraux ju  
17 bëri pyetje dhe ai lidhur me Adem Demaçin. Doja t'ju pyesja  
18 nëse keni parë një deklaratë që është publikuar në gusht,  
19 rreth një muaj pas takimit tuaj me z. Thaçi, z. Veseli, z.  
20 Demaçi, z. Krasniqi dhe të tjerë.

21 Z. MISETIC: [Përkthim] Në qoftë se mund të shfaqim në  
22 ekran, ju lutem, provën 50.

23 PY. Dëshmitar, kjo është diçka që mban titullin "Deklaratë  
24 Politike numër 7", është publikuar më 13 gusht 1998, nga, siç  
25 thuhet, Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së. Dhe në paragrafin 3

1 thuhet, rreshti i dytë, fillojmë me fjalinë e parë:

2 "Rrethanat e reja imponojnë krijimin e institucioneve të  
3 cilat spektri i gjerë politik i Kosovës do të përfaqësohet  
4 denjësisht. Me qëllim të ndërprerjes së manipulimeve lidhur me  
5 krijimin e institucioneve në fjalë, Shtabi i Përgjithshëm bën  
6 publik se Jakup Krasniqi, Xhavit Haliti, Bardhyl Mahmuti,  
7 Hashim Thaçi, Faton Mehmetaj dhe Sokol Bashota janë  
8 përfaqësuesit politik të UÇK-së. Dalja publike e përfaqësuesve  
9 politik të UÇK-së lehtëson bashkërenditjen e veprimtarisë  
10 politike në rrafshin kombëtar".

11 Në qoftë se kalojmë në paragrafin e fundit pastaj, thotë:

12 "Me qëllim të shpejtimit të procesit të krijimit të  
13 institucioneve të Kosovës Shtabi i Përgjithshëm i Ushtrisë  
14 Çlirimtare të Kosovës i jep besimin e plotë Adem Demaçit që të  
15 marrë rolin udhëheqës në këtë proces. I cili duke qenë jashtë  
16 çdo ombrelle partiake, Ushtria Çlirimtare e Kosovës kërkon nga  
17 Adem Demaçi të tërhiqet nga veprimtaria partiake."

18 Dëshmitar, a kishit dijeni për këtë deklaratë, ishit i  
19 njoftuar për këtë deklaratë që ishte publike më gusht të 1998?  
20 PË. Nuk më kujtohet. Por në termat e përgjithshëm siç është  
21 ndoshta paraqitur në media. Por ne e kuptuam që Adem Demaçi u  
22 ngarkua në atë kohë, sepse nuk kishte mundësi tjetër të  
23 kontaktoje njerëzit që ne kishim kontaktuar më përpara që ai -  
24 - sepse ai ishte në Prishtinë dhe ishte bashkëbisedues i jonë  
25 në emër të UÇK-së në Prishtinë.

1 PY. E keni dëshmuar për këtë më parë, por desha t'ju bëj një  
2 pyetje shtesë lidhur me këtë. Ju thatë në dëshminë tuaj të  
3 mëhershme se organizuat një takim për z. Thaçi që të takohej  
4 me z. Demaçi në Lubjana gjatë konferencës së Rambujesë. Jo për  
5 ju personalisht, por --

6 PË. Po.

7 PY. -- me bashkësia ndërkombëtare?

8 PË. Bashkësia ndërkombëtare, po. Sepse Adem Demaçi po fliste  
9 kundër marrëveshjes së Rambujesë dhe kishte në atë kohë, ishte  
10 bërë pengesë për bashkësinë ndërkombëtare në qëllimin e  
11 arritjes së marrëveshjes në Rambuje.

12 PY. A mund të na shpjegoni, t'i shpjegoni Trupit Gjykues  
13 çfarë lloj pengese, çfarë lloj autoriteti kishte Adem Demaçi  
14 që z. Thaçi duhej të shkonte me avion në Lubjanë të bisedonte  
15 me të për t'u pajtuar, për të pranuar marrëveshjen e  
16 Rambujesë?

17 PË. Siç e thamë më parë, ai ishte një figurë e lartë  
18 simbolike dhe nuk ishte vetëm ai, siç e thamë më herët, që  
19 ishte kundër arritjes së marrëveshjes. Ne u përpoqëm, bëmë  
20 gjithçka që mundëm dhe në veçanti Hashim Thaçi në Rambuje, që  
21 në mënyrë që Hashim Thaçi në Rambuje të ishte në gjendje të  
22 pranonte marrëveshjet.

23 Pra, ishin disa takime të organizuara nga bashkësia  
24 ndërkombëtare për t'i dhënë atij mundësinë që të bindë atë që  
25 kjo ishte një marrëveshje e mirë.

1 PY. Faleminderit. Dua të kaloj tani tek një pikë --

2 PË. Kërkoj ndjesë. Edhe në mënyrën që ai të ishte në gjendje  
3 të bindte njerëzit si Adem Demaçi që ai duhej të ishte në  
4 gjendje t'i vihej në pozicionin ku do të pranonte marrëveshjen  
5 e Rambujesë.

6 PY. A do të thoni që Adem Demaçi kishte autoritet në atë kohë  
7 me komandantët vendorë të UÇK-së? A ishte kjo përshtypja juaj  
8 në atë kohë?

9 PË. Nuk e di. Mund të ketë qenë në kontakt me disa prej tyre.  
10 Nga ajo që kemi marrë nga kabllogrami imi në fillim të  
11 korrikut, ai ka shkuar dhe në terren dhe është takuar me ta.  
12 Mendoj që e ka vazhduar këtë dhe gjatë kohës kur ne ishim duke  
13 biseduar në Rambuje.

14 PY. Tani dua të kaloj tek një çështje tjetër të ngritur nga  
15 Gjykatësi Barthe. Ju u përgjigjët një prej pyetjeve të tij  
16 duke thënë ne nuk e njohim qeverinë e përkohshme të Kosovës.  
17 Dhe Gjykatësi Barthe ju pyeti lidhur me atë që bashkësia  
18 ndërkombëtare donte që z. Thaçi të bënte më shumë dhe dua të  
19 shoh ndërlidhjen, pra, ndërveprimin mes këtyre dy pikave, pra,  
20 dua të kthehem për një çast tek ajo që ndodhi nga Rambujeti  
21 deri në momentin kur ju, e kam fjalën bashkësia ndërkombëtare,  
22 nuk e njohnit qeverinë e përkohshme.

23 Në Rambuje, u bënë bisedime dhe ishte e pranuar që do të  
24 krijohej një qeveri e përkohshme e Kosovës. Mendoj që u  
25 pajtuat me këtë më herët, apo jo?

1 PË. Po. Pyetja është ajo se çfarë ndodhi, ndodhi lufta,

2 Rezoluta e Këshillit të Sigurimit 1244.

3 PY. Po. Vazhdojmë hap pas hapi në mënyrë. Pastaj shkuat tek  
4 komandantët vendorë për të matur pëlqimin e tyre sepse ata e  
5 kundërshtonin këtë sepse nuk donin që të shpërbëhej UÇK-ja që  
6 ishte kërkesë thelbësore në marrëveshjen e Rambujes, e saktë,  
7 apo jo?

8 PË. E saktë.

9 PY. Dhe njëra prej mënyrave për të bindur ata ishte që t'u  
10 thoehj atyre që do të ktheheshin, do të konvertoheshin në  
11 institucione politike dhe që do të bëjë përfundimisht qeveria  
12 e përkohshme?

13 PË. Po.

14 PY. Pra, ju morët pëlqimin e tyre, "ju", kam fjalën z. Thaçi  
15 mori pëlqimin e komandantëve vendorë, apo jo?

16 PË. Po.

17 PY. Pastaj ndodhi lufta dhe siç e thoni. Dhe pastaj diçka  
18 tërësisht që nuk ishte marrë parasysh nga administratën e  
19 Kombeve të Bashkuara në Kosovë, që nuk ishte shqyrtuar në  
20 Rambuje, nuk ishte shqyrtuar në këto bisedime me dhe diskutuar  
21 me komandantët e zonave dhe se komandantët vendorë të UÇK-së  
22 ndërmori në dorë ngjarjet. Pajtoheni?

23 PË. Pajtohem.

24 PY. Në qershor ndodh -- pastaj vjen qershori dhe bashkësia  
25 ndërkombëtare këmbëngul me z. Thaçi dhe arritjen e shpërbërjes

1 së UÇK-së. A pajtoheni me këtë?

2 PË. Po.

3 PY. Pastaj por pa pjesën tjetër që ishte dhe: Këta persona të  
4 gjithë do të kalojnë pastaj në institucionet politike?

5 PË. E saktë.

6 Kërkoj ndjesë.

7 PY. Pavarësisht kësaj besoj që jeni dakord me mua që  
8 marrëveshja ndërkombëtare ishte që bashkësia ndërkombëtare  
9 vazhdonte të insistonte që z. Thaçi dhe UÇK-ja kishin nevojë  
10 që të shpërbëheshin, apo jo?

11 PË. Po. Në qoftë se ishte pjesë e Marrëveshjes së Kumanovës  
12 kjo ose Rezolutës 1244, nuk e di, megjithatë kjo ishte  
13 parakusht i pranisë së NATO-s, domethënë, në mënyrë të tillë  
14 që NATO të ishte e pranishme në Kosovë do të duhej që të  
15 përmbushej ky si parakusht.

16 PY. Në rregull. Do të mundohem të flas pak më ngadalë për  
17 përkthyesit.

18 A pranoni që kjo ka krijuar njësoj probleme për z. Thaçi,  
19 njësoj si problemi që kishin ndodhur dhe në shkurt, e kam  
20 fjalën lidhur me strukturat e brendshme ose ish-strukturat e  
21 brendshme të UÇK-së?

22 PË. Nuk e di. Pas luftës, ndjesia e përgjithshme midis UÇK-së  
23 ishte që UÇK-ja e fitoi luftën dhe ndjesia po ashtu ishte që  
24 ata kishin të drejtë që të drejtonin qeverinë e Kosovës. Ne u  
25 përpoqëm që t'i bindnim ata që nuk është kështu, në kuptonin

1 që ata duhej që të ishin drejtues të qeverisjes, megjithatë  
2 duhet të ishin në bashkëpunim të ngushtë me neve, pra, të  
3 punonin me neve në mënyrë të tillë që të mund të krijohesh një  
4 qeverisje që të ishte përfaqësuese dhe gjithashtu të ishte në  
5 pajtim me Rezolutën e Këshillit të Sigurimit 1244.

6 PY. Dhe në fund ka pasur gjëra të tilla si, për shembull,  
7 krijimi i institucioneve ose transformimi i UÇK-së në Forcën  
8 Mbrojtëse të Kosovës?

9 PË. Nuk e di. Nuk është se ka qenë një proces në të cilin unë  
10 kam qenë i përfshirë. Megjithatë jam përfshirë, siç e përmenda  
11 dhe dje, në krijimin e Strukturës së Përbashkëta të  
12 Administrimit, ku ne morëm kosovarë dhe kjo ishte një mënyrë  
13 për qeverinë dhe për z. Thaçi, për qeverinë e përkohshme në  
14 atë kohë që të gjente një kompromis edhe të thuhej që "Po. Ne  
15 jemi pjesë e strukturës së qeverisjes së përkohshme".

16 PY. Po kaloj në një temë tjetër të ndërlidhur, Gjykatësi  
17 Gaynor ju bëri një pyetje lidhur me detyrimet e UÇK-së për të  
18 hetuar krime.

19 A jeni në dijeni që nga fillimi i gushtit UNMIK-u ka  
20 emëruar gjykatës në mënyrë të tillë që të krijoheshin gjykatat  
21 dhe që ky procese është zhvilluar më tej gjatë verës?

22 PË. Nuk e di në qoftë se ka ndodhur ky si proces apo jo,  
23 sepse unë vetë nuk kam qenë i përfshirë në aspektin gjyqësor.  
24 Ne të dy diskutuam shkurtimisht Rregulloren 1 që është  
25 rregullorja mëmë për të gjitha rregulloret e tjera tonat

1 sepse, e para, ishte e rëndësishme që të identifikohesh se kush  
2 ishte ligji i zbatueshëm ose legjislacioni i zbatueshëm. Se  
3 është mirë të kesh gjykatës po nga ana tjetër është e  
4 rëndësishme që të dish bazën ose ligjin mbi të cilin ata e  
5 ushtrojnë kompetencat e tyre.

6 PY. A jeni në dijeni të faktit në qoftë se UNMIK-u ka hetuar  
7 dhe ka ndjekur apo ka gjykuar krime të luftës?

8 PË. Më duket se po.

9 PY. Deri kur keni qenë në Kosovë?

10 PË. Kam qenë në Kosovë deri në nëntor të vitit 2020,  
11 domethënë, pas zgjedhjeve vendore ishte momenti i përshtatshëm  
12 për mua që të largohesha. Domethënë, një prej arsyeve ka qenë  
13 ajo, po ka pasur edhe arsye të tjera se pse jam larguar.

14 PY. Gjykatësi Mettraux të pyeti në qoftë se ka qenë në  
15 interesin politik të UÇK-së apo jo që ta portretizonin veten  
16 që i respektonin detyrimet që rridhnin nga Konventat e  
17 Gjenevës?

18 PË. Po.

19 PY. A pajtoheni që ka qenë në interesat politik të UÇK-së që  
20 të lejonin qasje të KNKP-së?

21 PË. Po.

22 PY. A pajtoheni që ka qenë në interesat politik të UÇK-së që  
23 të lejonin qasje të OSBE-së tek të ndaluarit?

24 PË. Besoj se po.

25 PY. A pajtoheni me mua që ka qenë në interesat politik të



1 UÇK-së që të krijonin një gjykatë ushtarake dhe të caktonin  
2 dikënd që ishte jurist që të ishte drejtues i asaj gjykate?  
3 PË. Nuk e di. Një gjykatë ushtarake drejtuese -- nuk e di,  
4 domethënë, nuk di si t'i them. Mendoj që do kishte qenë në  
5 interesat politik të këtyre personave që të jepnin përshtypjen  
6 që ishin një ushtri e rregullt dhe si rezultat, domethënë,  
7 kishin strukturat e nevojshme.

8 PY. Për këtë e kisha fjalën dhe unë. Sepse kjo ishte një  
9 mënyrë që të tërhiqnin mbështetjen perëndimore UÇK-ja,  
10 domethënë, në qoftë se UÇK-ja do të thoshte që jemi të gatshëm  
11 që të zbatojmë parimet dhe detyrimet që rrjedhin nga Konventat  
12 e Gjenevës dhe ajo që kemi krijuar gjithashtu dhe institucione  
13 tjera brenda vendit në mënyrë që të respektojmë këto të  
14 drejta, besoj se kjo ka qenë në interes politik, apo jo?

15 PË. Besoj se po, megjithatë nuk e di se ju përgjigja më  
16 përpara pyetjes tuaj.

17 PY. Ju bënë pyetje në qoftë se udhëheqësit e UÇK-së të kanë  
18 thënë ty shprehimisht që kanë respektuar Konventat e Gjenevës  
19 dhe ju thatë jo. Pyetja ime është kjo: A i ke bërë ti pyetje  
20 konkrete përfaqësuesve të UÇK-së lidhur me këtë?

21 PË. Jo.

22 PY. Kam edhe disa pyetje tjera për t'ju bërë. Besoj se ishte  
23 gjykatësi Gaynor që jua bëri pyetjen --

24 Z. MISETIC: [Përkthim] Më lejoni vetëm një minutë ju  
25 lutem se dua ta sqaroj çfarë kam marrë në shënime dore në fund

1 të faqes.

2 PY. Të bëri pyetje Gjykatësi Gaynor:

3 "... a keni një arsye për të besuar që Fatmir Limaj ka  
4 vepruar si person i pabindur në një mënyrë ose në një tjetër  
5 jashtë udhëzimeve të udhëheqjes së UÇK-së, domethënë, ka  
6 vepruar me kokë të vet jo me udhëtime të UÇK-së?"

7 Përgjigja që ju dhatë është:

8 "Jo".

9 Pyetja ime e radhës është kjo: A ke ndonjë arsye për të  
10 besuar që gjatë gjithë kohës Fatmir Limaj ndiqte urdhrat e  
11 eprorëve të vet dhe, në qoftë se po, mbi çfarë baze e bazoni  
12 këtë?

13 PË. Nuk e di. Nuk e di. Unë thjesht e kam parë z. Thaçi, e  
14 kam parë atë me z. Thaçi në takim dhe e kam parë përsëri në  
15 takim në periudhën nga Rambujeja deri në Paris. Dukej sikur ai  
16 ishte pjesë e strukturës së UÇK-së.

17 PY. Sa i takon asaj çfarë ndodhte në zonën e vet, ju nuk  
18 është se kishit ndonjë informacion lidhur me atë se çfarë  
19 bënte ai në qoftë se ndiqte urdhrat e eprorëve, apo jo?  
20 Përgjigja që dhatë është që nuk e dinit, apo jo?

21 PË. Po, këtë thashë.

22 PY. Në fund ishte pak e paqartë në qoftë se po thonit që keni  
23 pasur disa takime, domethënë, keni pasur shumë takime ku ka  
24 qenë i pranishëm z. Thaçi dhe z. Limaj. Unë ju them që z.  
25 Thaçi është larguar në Kosovë në mes të nëntorit rreth kohës

1 që ka ndodhur takimi për të cilin folëm dhe nuk është kthyer  
2 më në Kosovë deri në momentin kur u bë marrëveshja e  
3 Rambujesë.

4 Kështu që në qoftë se z. Thaçi nuk ka qenë në Kosovë,  
5 atëherë i takon që ju nuk mund të jeni takuar me të?

6 PË. Po, është e vërtetë.

7 PY. Nuk kam pyetje të tjera.

8 PË. E kam fjalën për në Kosovë. Nuk jam takuar me të më në  
9 Kosovë.

10 PY. Po, sepse thatë që jeni takuar në Vjenë.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Emmerson.

12 Z. EMMERSON: [Përkthim] Na duhet rreth 15 minuta. Nuk e  
13 di keni ndonjë plan për të bërë pushim apo jo?

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] [Mikrofoni  
15 çaktivizuar]

16 Z. ROBERTS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, për arsye  
17 planifikimi, ne nuk kemi pyetje të tjera.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ellis?

19 Z. ELLIS: [Përkthim] Unë kam pyetje, po jo më shumë se 5  
20 minuta 10 minuta besoj.

21 Pyetje vijuese të palës tjetër nga z. Emmerson:

22 Z. EMMERSON: [Përkthim]

23 PY. Dua të filloj duke ju bërë disa pyetje plotësuese të  
24 lidhura me pyetjet e Gjykatësit Barthe lidhur me marrëdhënien  
25 apo takimet me Kadri Veselin në periudhën nga fundi i vitit

1 1999 dhe gjatë vitit 2000 deri në nëntor kohë kur ju u larguat  
2 nga Kosova.

3 Tani dua që t'ju pyes fillimisht: A na thoni dot  
4 saktësisht se kur jeni bërë këshilltari politik i Bernard  
5 Kouchner?

6 PË. Besoj që ka qenë fillimi i gushtit 1999.

7 PY. Në rregull. Pra, gjatë gjithë periudhës për të cilën ne  
8 po flasim, domethënë, gjatë 1999 dhe pjesën më të madhe të  
9 vitit 2000, ju keni punuar si këshilltar politik për UNMIK-un  
10 dhe keni qenë këshilltari politik i SRSG-së, apo jo?

11 Juve e keni dhënë deklaratën tuaj dhe gjithashtu thatë  
12 edhe këtu përpara Trupit Gjykues që keni bërë takime me z.  
13 Veseli si shef i inteligjencës, shërbimit informativ si pjesë  
14 e qeverisë së përkohshme?

15 PË. Jo. Unë nuk kam pas takime me të në atë cilësi.

16 PY. Sepse nuk e keni njohur atë si pjesë e qeverisë  
17 përkohshme, apo jo?

18 PË. Jo, vetëm për atë fakt, por ne thjesht jemi takuar si  
19 pjesë e një grupi. Mund të jemi takuar për darkë ose për  
20 ndonjë takim dhe kjo ishte pjesë e punës time të përditshme,  
21 në kuptimin që duhet të ishin miqësorë dhe të ishim në kontakt  
22 të vazhdueshëm me ata që kishin qenë ish-UÇK.

23 PY. Megjithatë në fakt a jeni i informuar që edhe SRSG-ja  
24 vetë e ka vizituar zyrën e z. Veseli për të diskutuar me të.  
25 Nuk e di sesi e keni shprehur ekzaktësisht, por a jeni në

1 dijeni që ai e ka takuar z. Veseli si pjesë e shërbimit  
2 informativ të qeverisë? A e dini me fjalë të tjera në qoftë se  
3 z. Kouchner ka pasur takime me z. Veseli vetë ndoshta dy apo  
4 tre takime të kësaj natyre?

5 PË. Mund të jetë kështu. Po megjithatë nuk mendoj që e ka  
6 vizituar z. Veseli si person që ka pas atë pozicion në qeveri  
7 përkohshme të Kosovës, po mendoj se një person me influencë në  
8 ish-UÇK.

9 PY. Në fakt ju i keni dhënë mesazhe atij, pra, në qoftë se  
10 kishit nevojë për ndihmë sa i takon strukturave së ndërmjetme?

11 PË. Sa i takon strukturave të ndërmjetme, personi me të cilin  
12 unë zakonisht flisja në mënyrë të tillë që të krijohej, le të  
13 krijoheshin strukturat përkatëse, në fakt, ka qenë z. Thaçi.

14 PY. Në fakt po shikoj këtë pjesën edhe në deklaratën tuaj që  
15 thoni që:

16 "Unë ndërlihdhesha me ta ose ndoshta haja drekë me të në  
17 qoftë se na duhej mbështetje me strukturat e ndërmjetme".

18 Ndërkohë që më tej u bënë pyetje të tjera, kam  
19 përshtypjen që ju përmendët diçka lidhur me krimin e  
20 organizuar.

21 PË. Nuk e di në qoftë se kjo lidhej me drekat me z. Veseli.

22 PY. Mirë. Në rregull. Do ju bëj një pyetje të hapur atëherë.

23 A keni diskutuar ju, Dëshmitar, çështje me z. Veseli duke  
24 përfshirë këtu metoda për të luftuar krimin e organizuar,  
25 krijimin e sistemeve për t'i rezistuar influksëve të

1 islamizmit, terrorizmit islamist, terrost e të tjerë?

2 PË. Jo. Personalisht nuk kam diskutuar për çështje të tilla.

3 PY. Po çfarë keni diskutuar në këtë, çfarë mesazhi i keni  
4 dhënë atij?

5 PË. Kemi takuar gjithashtu edhe personalitete të tjera dhe  
6 njësoj si me personalitete të tjera si, për shembull, Xhavit  
7 Haliti ishte që t'i bindim ata që të punonim në bashkëpunim  
8 me neve për të krijuar këtë strukturën përkatëse të  
9 administrimit të përkohshëm ose me fjalë të tjera të  
10 shpërbërjes së qeverisë së tyre të përkohshme.

11 PY. Po mendoj që ju jeni në dijeni të faktit që janë bërë  
12 disa përpjekje ndërlidhëse të agjencive të informacionit  
13 jashtë vendit për t'u ndërlidhur me Kosovën, apo jo, ose më  
14 konkretisht me z. Veseli?

15 PË. Absolutisht po.

16 PY. A keni ndonjë ide të qartë se për sa kohë keni pasur  
17 ndërlidhje me z. Veseli?

18 PË. Dua të them që nuk kam përmendur askënd këtu, por kemi  
19 pasur një mik të përbashkët, një shok të përbashkët dhe ky  
20 shok i përbashkët ka qenë gjithashtu në luftë edhe në Kosovë.

21 PY. Ka pasur fluks të përfaqësuesve të shërbimeve të  
22 inteligjencës kur mbaroi lufta, kur luftës i erdhi fundi. Dhe  
23 mendoj që juve ju bë një pyetje nga Gjykatësi Barthe: Ku ai  
24 bëri një përshkrim të z. Veseli dhe rolit të tij. A pajtoheni  
25 me mua se ai ka punuar me agjencitë e jashtme të informimit

1 gjatë luftës, nuk e di në qoftë se ju mbahet mend pyetja që ju  
2 bëri Gjykatësi Barthe në qoftë se dini se ka pas një dallim  
3 midis shërbimit informativ të brendshëm dhe të jashtëm?  
4 PË. Nuk e di se çfarë pune ka bërë ai gjatë luftës,  
5 domethënë, në kuptimin e shërbimit informativ me agjencitë  
6 perëndimore. Mund t'jua them këtë vetëm pas luftës.  
7 PY. Por a mendoni se në qoftë se nuk do ishte e lejuar nga  
8 perëndimi që z. Veseli të caktohej në atë rol me siguri nuk do  
9 kishit dhënë mbështetjen e tyre dhe do kishin gjetur dikënd  
10 tjetër për atë pozicion?  
11 PË. Nuk mendoj se do e ekzagjeroja në qoftë se do thosha në  
12 qoftë se bashkësia ndërkombëtare nuk do të mendonte që ai do  
13 të ishte i përshtatshëm për atë post, pra, për të pasur atë  
14 pozicion dhe në qoftë se do të mendonin se do të kishin një  
15 marrëdhënie të besueshme me të, nuk do të kishim pasur këtë  
16 persona në këtë pozicion, kështu që jam i sigurt që ka qenë  
17 mbështetja e bashkësisë ndërkombëtare.  
18 PY. Çfarë mund të thoni, pa përmendur asnjë person apo asnjë  
19 vend, a mund të thoni se ka pasur agjenci inteligjente ose  
20 informimi që kanë punuar në Kosovë gjatë luftës dhe që kanë  
21 pasur një domethënie shumë të madhe gjatë periudhës më pas?  
22 PË. Po. Ka pasur disa agjenci të tjera.  
23 PY. Një pjesë e madhe e shqetësimeve ishte që të sigurohej që  
24 Kosova nuk bëhej një vend atraktiv për islamistët. A pajtoheni  
25 ju me këtë?

1 PË. Po. Kemi pasur probleme sa i takon fluksit të parave nga  
2 shtetet e Gjirit dhe të shtëna dhe atentatet të menjëhershme  
3 ose të papritura në xhami po ashtu.

4 PY. Xhami dhe gjithashtu ka qenë edhe prania e disa imamëve  
5 të cilët predikonin për mënyrën sesi ndoshta nga mënyra ose  
6 për të vepruar në mënyra që nuk përbëjnë traditën evropiane?

7 PË. Po. Ka pasur diçka në këto fusha dhe ne kemi qenë të  
8 lumtur që të punojmë me z. Veseli në këtë aspekt?

9 PË. Besoj se po.

10 PY. Atëherë vazhdojmë më tej. Një prej pyetjeve që të bëri  
11 Gjykatësi Barthe ishte në qoftë se ka ndonjë lidhje ndërmjet  
12 informimit të gjatë brenda një vendi dhe marrëdhënieve  
13 ndërkombëtare ndërmjet agjencive të informimit ose të  
14 inteligjencës.

15 Juve ju bë pyetja, pikë së pari, në qoftë se UÇK-ja  
16 pretendohet që të kishte një shërbim zbulim kundërzbulimi ose  
17 inteligjence gjatë luftës. Dhe ju thatë që:

18 "Nuk do befasohesha, nuk do çuditesha nga kjo ..."

19 PË. Po.

20 PY. Ju e dini, apo jo, që në fillim të qershorit apo të  
21 korrikut të 1998, ishte një qëndrim i unifikuar shqiptar, në  
22 qoftë se e dini, që ka pasur një diskutim informimi dhe  
23 gjithashtu edhe diskutime ushtarake që janë zhvilluar në vende  
24 të tjera jashtë Kosovës?

25 PË. Nuk e di. Nuk di që ka pasur diskutime të tilla për



1 inteligjencën ose për shërbimet e zbulimit. Megjithatë kam  
2 përmendur në deklaratën time takimet e diplomatëve amerikanë  
3 me Bardhyl Mahmutin. Kështu që ka pasur agjenci tjera si  
4 motra, të cilat, besoj ose nuk do befasohesha, që të dija që  
5 ka pasur agjenci të tjera që bashkëpunonin me të.

6 PY. A do ju befasonte të mendoni, për shembull, që dikush që  
7 do ishte përgjegjës për një agjenci të tillë të kërkonte  
8 mbështetje ose, për shembull, të ndërlidhej me shërbimin  
9 informativ shqiptar?

10 PË. Nuk do më habiste kjo.

11 PY. Përfshirja perëndimore a është intensifikuar me agjenci  
12 të tjera të cilat lidheshin me dhe që ishin të pranishme me  
13 agjenci të tjera informimi, informacioni shqiptare, dua të  
14 them, domethënë, me organet përgjegjëse shqiptare.

15 PË. Shërbimet e inteligjencës e keni fjalën? Sigurisht.

16 PY. Domethënë, që shënjestronin informacion apo informacion  
17 territorial, lëvizje të popullatave, e gjëra të tilla.

18 Përfshirë këtu edhe nivelin e inteligjencës ushtarake, apo jo?

19 PË. Po.

20 PY. Tani, ju thatë që ishit në dijeni të anëtarëve të caktuar  
21 të udhëheqësve jashtë Kosovës që mblidhnin para, po thatë që  
22 nuk është se e dinit se për çfarë mblidheshin këto para?

23 PË. Nuk thashë që ishte "udhëheqja", por thamë që kishte një  
24 rrjet për mbledhjen e parave.

25 PY. Ju kërkoj ndjesë për formulimin. Pra, ju thatë që disa

1 njerëz në Evropë, domethënë, ose e dinin që kishte njerëz në  
2 Evropë që mblidhnin fonde, po thatë që nuk e dinit në qoftë se  
3 kjo kishte të bënte fare me funksione inteligjence, apo jo?  
4 PË. Do të doja të bëja dallimin në kuptimin që nuk kisha  
5 njohuri sa i takon ekzistencës së një strukture inteligjence  
6 jashtë Kosovës.

7 Megjithatë, ajo çfarë di unë është që ekzistonte një  
8 strukturë që shërbente për mbledhjen e fondeve që quhej  
9 "Atdheu Thërret", qëllimi kryesor i kësaj strukture ishte që  
10 të mblidheshin para në mënyrë të tillë që të pajiseshin me  
11 armë UÇK-ja ose ushtarët e UÇK-së në Kosovë.

12 PY. Përgjigja që dhatë është kjo:

13 "E di që ata jashtë Kosovës po përpiqeshin që të  
14 mblidhnin fonde, megjithatë kjo nuk do të thotë  
15 domosdoshmërisht që ato ishin shërbime inteligjence".

16 Në këtë çështje kemi parë një dokument, në fakt, është  
17 një faqe e një shënimi që ju bë një pyetje domethënë, është  
18 kjo faqja që ju thatë që ka gjashtë vrima, pra, është një faqe  
19 e këtij shënimi ku bëhet një koment që:

20 "Ti nuk menaxhon dot një agjenci inteligjence jashtë  
21 Kosove në qoftë se nuk je jashtë Kosove."

22 A jeni ju dakord ju me këtë parashtrim?

23 PË. Mendoj që është logjike. Domethënë, në qoftë se nuk je  
24 jashtë nuk mbledh dot informacion jashtë.

25 PY. Pra, në qoftë se kemi prova dhe në fakt ka prova të

1 mjaftueshme dhe në qoftë se vërtetohet, siç është vërtetuar,  
2 mendojmë ne, që z. Veseli ka qenë jashtë Kosove në periudhën  
3 nga nëntori deri në mars, a do ju ndihmonte juve që të arrinit  
4 në një përfundim që lidhjet e tij të inteligjencës pas luftës  
5 kanë filluar përpara ose gjatë kësaj kohe?

6 PË. Nuk e di. Nuk e di se ku ka qenë z. Veseli në atë  
7 periudhë.

8 PY. Nuk e dini ju, megjithatë ka prova që tregojnë se ku ka  
9 qenë z. Veseli në atë periudhë.

10 Ajo çfarë po mundohem t'ju pyes unë është kjo që a do të  
11 pajtoheshit në qoftë se unë do të thoja që ai nuk ka qenë në  
12 vend, pra dhe lidhur me pyetjen që ju bëri z. Barthe, a mund  
13 të ishte e mundur që ato agjenci, domethënë, që ai të ketë  
14 qenë duke punuar me këto agjenci dhe të njëjtat agjenci  
15 inteligjente të dinin se ai punonte me ta në 1998 dhe 1999?

16 PË. Mund të jetë kështu.

17 PY. Nuk do ta shtjelloj materialin që do lidhet me pyetjen  
18 time të radhës sepse bëhet fjalë për takimet dhe dokumente në  
19 lidhje me 10 dhe me 23. Megjithatë dua që t'ju pyes lidhur me  
20 një ose dy çështje ose aspekte.

21 Së pari, a ju kujtohet që në kohën kur jeni takuar  
22 bashkërisht me z. Veseli dhe me personin që përshkruat si 3 ose  
23 pas këtij momenti, a ju kujtohet në një periudhë gjatë kësaj  
24 periudhe që të jeni takuar me Blerim Shalën?

25 PË. Mendoj, sikurse e thashë sot, që jam takuar me të të

1 njëjtën mbrëmje, jemi takuar për darkë përpara sesa të  
2 kthehesha në Beograd për të shkruar kabllogramin të nesërmen.  
3 PY. Atëherë i takon që kabllogrami të jetë dërguar më 24,  
4 sepse ngjarjet që përshkruhen në këtë kabllogram kanë ndodhur  
5 rreth kësaj kohe, megjithatë dëshiroj t'ju pyes lidhur me një  
6 aspekt të kësaj.

7 Nuk ka të bëjë me datën e kabllogramit, nuk ë se jam  
8 shqetësuar për datën e kabllogramit por e kam fjalën për datën  
9 e takimit për të cilin flet kabllogrami. Ne kemi prova që më  
10 datë 23, Malisheva ishte rrethuar me luftime në Bllacë,  
11 Rahovec, në Kijev dhe Llapushnik, në të gjithë këtë periferi.  
12 A ju kujtohet që të keni udhëtuar në zona aktive luftimesh për  
13 të shkuar në Malishevë në atë takim?

14 PË. Jo, nuk ka pasur luftime kur unë kam udhëtuar për të  
15 shkuar në takim. Më kujtohet se në atë kohë kemi patur në  
16 dispozicion një makinë, pra, kemi pasur makinë të ish-  
17 ambasadorit të Austrisë në Ankara në dispozicionin tim që  
18 ishte një Chevy Caprice, ishte një lloj makine jo e zakonshme  
19 për të udhëtuar në atë kohë, po më kujtohet që atë makinë kemi  
20 përdorur gjatë periudhës.

21 Megjithatë nuk më kujtohet se ka pasur luftime rrugës për  
22 në Malishevë.

23 PY. A ju kujtohet që kur keni shkuar me makinë për të marrë  
24 pjesë në këtë takim duhet që të kalonit në një zonë konflikti  
25 për të shkuar në takim, a ju kujtohet? Sepse Malisheva ka qenë

1 në shënjestër të luftimeve dhe shkëmbimeve të ashpra të  
2 zjarrit?

3 PË. Mund ta shoh në hartë. Megjithatë nuk jam në gjendje për  
4 të thënë se çfarë rruge kemi përshkruar për të shkuar atje,  
5 por besoj që kemi përshkruar të njëjtën ose një rrugë të  
6 ngjashme së bashku me Rohan kur po ktheheshim nga Suhareka.  
7 Megjithatë, unë nuk isha në dijeni të asnjë luftimi që  
8 vazhdonte dhe qetësia e bashkëbiseduesve të mi, nuk më  
9 sugjeronte që kishte ndonjë luftim në vijim e sipër.

10 PY. Megjithatë e keni parë një dokument që thoshte që kishte  
11 20.000 refugjatë brenda Malishevës më datë 23. Po të gjitha  
12 këto të dhëna a ju bëjnë ju të keni ndonjë dyshim për të  
13 arritur në përfundimin që ndoshta keni shkruar gabim datën?

14 PË. Jo.

15 Z. CAPIN: [Përkthim] Ky është keqinterpretim, domethënë,  
16 "gabimi i datës" është keqinterpretim sipas procesverbalit.

17 Z. EMMERSON: [Përkthim] Po shikoj dhe një herë dokumentet  
18 e mia. Megjithatë do kërkoja që të paraqitet dokumenti në  
19 ekran. Për procesverbal është dokumenti 1D00145. E kemi në  
20 versionin gjermanisht dhe në anglisht.

21 PY. Ju janë bërë disa pyetje lidhur me përmbajtjen e  
22 dokumentit. Mua nuk më intereson përmbajtja e dokumentit por  
23 dua të flas, dua të them që ky është një raport që ia keni  
24 dërguar Ministrisë së Punëve të Jashtme ku keni përmbledhur  
25 pikat kryesore që janë diskutuar në Rambuje, pikërisht në

1 datën që përfundoi konferenca e Rambujesë. Dhe jo vetëm që  
2 keni shkruar viti 1998 këtu tek titulli, por madje shkojmë dhe  
3 tek faqja tjetër, do të shihni që e keni nënshkruar me datën  
4 25 shkurt 1998. Pra, që nga titulli që thotë 6 deri më 23  
5 shkurt 1998, e keni gabim. Dhe pastaj në fund keni shënuar 25  
6 shkurt 1998. Ne kaluam shkurtimisht këtë më përpara, po ju  
7 themi që keni edhe vitin gabim. Keni dy shifra gabim.  
8 PË. Po të shihni fillimin, thuhet që raporti është i 1999,  
9 është numri 1999 aty.

10 PY. Por e keni bërë dy herë datën gabim pra?

11 PË. Unë e kuptoj çfarë po përpiqeni të bëni ju. Më lejoni të  
12 flas, ju lutem.

13 Edhe dje e kuptoj që strategjia juaj është të cenoni  
14 besueshmërinë e deklaratave të mia apo të vini në dyshim  
15 deklaratat e mia. Po, është data gabim, u ndodhë të gjithëve  
16 kjo gjë. Unë s'e kuptoj çfarë dallimi ka kjo për ju.

17 PY. E kuptoj dhe me gjithë respektin, nuk po ju kritikoj as  
18 të vë në pikëpyetje besueshmërinë e dëshmive tuaja. Por është  
19 normale, siç thatë ju, që ndonjëherë datat janë gabim, po këtu  
20 nuk është një situatë kur e keni dhënë gabim vetëm një herë  
21 datën.

22 Ju e keni korrigjuar, keni bërë një referencë të  
23 dokumentit dhe kur ju thatë që nuk ju kujtohet kjo dhe më  
24 thatë edhe vetë që kujtesa juaj nuk është në përputhje me  
25 dokumentin dhe ju sidoqoftë zgjidhni dhe thoni që dokumenti

1 është dokumenti i duhur dhe para një jave, në seancën  
2 përgatitore, mund të ishte korigjuar kjo, kjo mund të ishte  
3 korigjuar nëse nuk do të kishit thënë që z. Thaçi ishte me z.  
4 Veseli kur e takuat në atë më 9 ose më 10.

5 Pra, e kuptoni ju sa e rëndësishme është kjo sepse keni  
6 dy gabime dhe nuk keni një gabim dhe keni vendosur një 3 në  
7 vend që të vendosnit -- keni 2, 3 dhe të vendosnit 1.

8 PË. Tani nëse shikoni raportin e 24 korrikut unë nuk shoh  
9 asnjë datë problematike atje. A pajtoheni me mua?

10 PY. Data që po them unë është për raportin e datës së takimit  
11 të 23?

12 PË. Pra, ju po vini në dyshim faktin a ka ndodhur takimi më  
13 23 korrik?

14 PY. Unë po them që ju në fakt ishit i saktë qysh në fillim  
15 dhe kujtesa juaj ishte e duhur. Dhe ju thoni që nuk ishte e  
16 duhur dhe thoni që mund të bazoheni në dokumentin që ka shifër  
17 në të.

18 PË. Pra, ju po thoni që takimi i parë me z. Veseli me numrin  
19 7 ka qenë më 22 korrik

20 PY. Jo, unë po them ka qenë në datë 10.

21 PË. Po, pra, pajtohem dhe unë me këtë.

22 PY. Dhe ju jeni betuar se ju kujtohet --

23 PË. Dhe thashë që do përgjigjem me aq sa më kujtohet do të  
24 përgjigjem për të gjitha këto dhe do të jem dëshmitar. Unë nuk  
25 kam dhënë deklaratë të rreme qëllimisht.

1 PY. Po, sigurisht që jo. Po them që mund ta kesh bërë datën  
2 gabim?

3 PË. Po kam bërë këtë gabimin për 1999, duhet të kisha vendosë  
4 199.

5 PY. Po vetë thatë që këto gjëra ndodhin?

6 PË. Po. Pajtoheni me mua që s'e kam bërë këtë për  
7 procesverbalin e takimit të 24 korrikut 1998.

8 Z. CAPIN: [Përkthim] E kundërshtoj. Sepse kjo tani është  
9 krejt argumentative.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] tani keni  
11 kaluar më tej se fushëveprimi i pyetjeve, z. Emmerson.

12 Z. Ellis, fjala është për ju.

13 Pyetje vijuese të palës tjetër nga z. Ellis:

14 Z. ELLIS: [Përkthim]

15 PY. Dëshiroj t'ju bëj disa pyetje që janë plotësuese të  
16 pyetjeve që ju bëra më herët dhe që i trajtoj Gjykatësi  
17 Mettraux me ju. Bëhet fjalë për takimin e 30 korrikut 1998 dhe  
18 bëhet fjalë për Nekibe Kelmendin.

19 Gjykatësi Mettraux ju bëri disa pyetje për përfaqësuesit  
20 e UÇK-së dhe për faktin që e kishin kundërshtuar Nekibe  
21 Kelmendin që është emri që shfaqet në kabllogramin që keni  
22 shkruar pas takimit.

23 PË. Po. Në rregull.

24 PY. A ju kujtohet që pamë bashkë procesverbalin me shkrim  
25 dore të takimit ku keni përmendur faktin që përfaqësuesit e



1 UÇK-së kundërshtonin Milazim Krasniqin, kështu?

2 PË. Kështu.

3 PY. Në shënimet që kishit marrë me shkrim dore s'e keni  
4 përmendur fare Nekibe Kelmendin, kështu?

5 PË. Po.

6 PY. Unë verifikova pak edhe deklaratën që i keni dhënë  
7 Prokurorisë dhe në paragrafin 43 të asaj deklarate ju keni  
8 përmendur Milazim Krasniqin dhe përsëri nuk përmendni Nekibe  
9 Kelmendin. E pranoni këtë?

10 PË. Edhe mundet. Nuk e kam përpara por nëse e thoni ju,  
11 kështu duhet të jetë.

12 PY. Pra, mund të ketë ndodhur një gabim? A mund të bëhej  
13 fjalë mbase për Milazim Krasniqin dhe jo për Nekibe Kelmendin  
14 në atë kohë?

15 PË. Në shënimin me shkrim kisha shënuar Milazim Krasniqi dhe  
16 jo Nekibe Kelmendin. Nuk e di pse kam dhënë emrin Nekibe  
17 Kelmendi në raport.

18 PY. Nuk ju kujtohet mund të mos e keni pasur ndonjë arsye  
19 tjetër për këtë?

20 PË. Mund ta shohim raportin nëse dëshironi. Po në fakt e kemi  
21 parë, më kujtohet. Nuk ka qenë vetëm informacion që është  
22 mbledhur te takimi në Kleçkë, por informacioni është marrë  
23 edhe nga takimi në Prishtinë, nga takimi në Prishtinë.

24 PY. Pra, kundërshtimi për Nekibe Kelmendin mund të ketë qenë  
25 nga një person tjetër, jo nga z. Krasniqi?

1 PË. Po, mund të ketë qenë në bazë të ndonjë informacioni  
2 tjetër që ma kishin përcjellë, nuk e di nëse është përmendur  
3 konkretisht në takimin në Kleçkë edhe kjo.

4 PY. Faleminderit. A e pranoni që nuk është e pazakontë në  
5 politikë që kur një parti të propozojë një kandidat për një  
6 pozitë të caktuar, partia tjetër ta kundërshtojë?

7 PË. Jo, nuk është e pazakontë.

8 PY. Dhe kjo nuk do të thotë që do kryhen krime ndaj këtij  
9 personi, ky person do të përndiqet?

10 PË. Jo.

11 PY. Pas konfliktit kur UNMIK-u ishte tërësisht funksional  
12 filloj të kryente gjykime kundër anëtarëve të UÇK-së, apo jo?

13 PË. Nuk më kujtohet ndonjë gjë e saktë në lidhje me këtë.

14 PY. A e dinit ju se Nekibe Kelmendi ka qenë avokatja e Latif  
15 Gashit në një prej gjykimeve kundër anëtarëve të UÇK-së?

16 PË. Jo, nuk e dija këtë.

17 Z. ELLIS: [Përkthim] Do t'ju tregoj një dokument lidhur  
18 me këtë pikë që është DJK0079-TR-ET. Do lutesha që të shfaqej  
19 në ekran.

20 PY. Ju lutem shihni paragrafin e tretë. Ku thuhet se:

21 "Nekibe Kelmendi, së bashku me" dy avokatë të tjerë,  
22 "kanë qenë avokatët mbrojtës të Latif Gashit".

23 E gjetët në tekst?

24 PË. Po, e gjeta.

25 PY. Dhe deklarata e saj është që:

1           “Nuk besoj ... se ka ndonjë provë që këta të pandehur  
2 apo se UÇK-ja në përgjithësi ka qenë një ndërmarrje kriminale  
3 apo se kanë pasur plan kriminal për të kryer krime lufte”.

4           E shihni në tekst?

5           PË. Po, e shoh.

6           Z. ELLIS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, kërkoj që të  
7 pranohet ky dokument. E kuptoj që ka pasur një problem me  
8 videon, po kërkoj të pranohet transkripti.

9           GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Po për çfarë doni ta  
10 pranojmë këtë dokument?

11          Z. ELLIS: [Përkthim] E them këtë se nuk mundësi që Nekibe  
12 Kelmendi të ketë menduar që ajo të ishte shënjestër e UÇK-së,  
13 kur vetë ajo ka qenë një nga avokatet mbrojtëse për një nga  
14 ish-anëtarët e UÇK-së.

15          KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] A ka  
16 kundërshtime?

17          Z. CAPIN: [Përkthim] Jo.

18          KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dokumenti me  
19 numër DJK00799-TR-ET pranohet.

20          SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Ky dokument merr numrin  
21 e provës materiale 4D00064. Klasifikimi nuk është i  
22 specifikuar.

23          Z. ELLIS: [Përkthim] Besoj se mund të jetë publik.

24          KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar]

25          Ka kundërshtime?

1 Kundërshtime për riklasifikimin.

2 Z. CAPIN: [Përkthim] Jo.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Atëherë e  
4 riklasifikojmë.

5 Vazhdoni.

6 Z. ELLIS: [Përkthim] Nuk më pyetje.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Kickert  
8 përfunduat.

9 DËSHMITARI: [Përkthim] Faleminderit.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Tani mund të  
11 largoheni. Faleminderit që ishit me ne këto dy ditë ishte  
12 interesante, e vlerësojmë që ndatë me ne informacionin që  
13 kishit. Ju urojmë gjithë të mirat. Dhe uroj se tani mund të  
14 dilni i gëzuar nga salla e gjyqit bashkë me Asistenten.

15 DËSHMITARI: Po, se mezi po prisja të kthehesha tek  
16 familja ime.

17 [Dëshmitari largohet]

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Me  
19 dëshmitarin e radhës do fillojmë nesër. Dhe shpresojmë që të  
20 mbarojmë nesër me atë dëshmitar. Ju lutem, kijeni këtë  
21 parasysh, kijeni këtë mundësi parasysh.

22 Faleminderit për pjesëmarrjen sot. Ka ndonjë gjë tjetër  
23 që doni të shtroni përpara Trupit Gjykses? Në rregull.

24 Seanca mbyllet sot dhe fillojmë nesër në orën 9.00

25 --- Seanca mbyllet në orën 16.11